

8SH-32
N 23

LLIKO
NANO

SI
NDODH
NGANJE
-HERE

Novelë e tregjime

8SH-32
423

LLIKO
NANO

SI NDODH NGANJËHERË

Novelë e tregime



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

PËRBALLË VETES

Mësues Viktor Bregu kishte rreth dy orë që po priste makinë për në Korçë, pranë urës së lumit Vjosa, që lidh qytetin e Përmetit me rrugën ndërqytetëse. Ishte i mërzhitur e i fyer njëkohësisht. Nga drejtoria e Institutit Bujqësor në Korçë i kishte ardhur një letër urgjente, që e kërkonte të ndodhej me ngut atje, pasi i biri nuk ishte sjellë mirë. Nga Gjirokastra deri në Përmet kishte ardhur me autobusin e linjës, kurse që këtej i kishin thënë se mund të shkonte shumë lehtë me skodat e druve. Ai mund të vinte edhe të nesërmen, ose të pasnesërmen, kur të gjente biletë, por, sa hapi letrën, u mpi nga shqetësimi dhe u nis. Kaluan dy makina të ngarkuara me dru, po vendet përpara qenë të zëna, kështu që atij iu desh të priste. Makina e tretë erdhi pas dy orësh, po nuk qe e druve. Ajo qe një makinë e madhe frigorifer, me tar-

gën e Tiranës, nga ato që zakonisht përdoren për transport jashtë vendit. Viktor Bregu ngrihti dorën pa shumë shpresë. Në fillim makina i kaloi para me vrull, po, pasi kishte bërë disa metra, shoferi nxori kokën nga kabina, e pa dhe frenoi në vend. Viktor Bregu priti disa sekonda, pastaj u nis me hapa të shpejtë. Shoferi, ende i ri në moshë, i veshur me një xhakavento të zezë meshini, i bëri shenjë të hipte.

— Falemnderit, or byrazer, se kam dy orë që po pres aty, — tha i lehtësuar mësuesi.

— Ku do të shkoni? — pyeti shoferi pa e kthyer kokën.

— Në Korçë.

— Atje shkoj dhe unë.

Viktor Bregu psherëtiu thellë.

S'ka rënë fare, mendoi shoferi duke e parë me bisht të syrit. Duket si 30-vjeçar, megjithëse s'duhet të jetë më pak se 50 vjeç.

— Kam një hall në Korçë, — tha mësuesi.

— Ashtu? — Shoferi përsëri nuk e ktheu kokën. Viktor Bregu e pa dhe vuri re se fytyra simpatike e djaloshit, me ballin e mbushur me krela të zeza flokësh, ishte e lodhur, indiferente dhe e menduar. Çudi, mendoi shoferi. Tani duket tjetër njeri, kurse atëherë ishte i ftohtë, kategorik dhe i frikshëm. S'guxonte kush t'i kundërshtonte, kurse unë bëra më shumë se kaq. M'u shkrep të shitja edhe ca trimëri me të... Qeshi me vete pa e çuar mendimin deri në fund.

— Nga të kemi? — pyeti mësuesi.

— Jam nga Tirana, — tha shoferi duke e parë fytyrën e tjetrit me kureshtje.

— S'dukesh si tiranas.

— Prindërit i kam nga Jugu, — tha shoferi ftohtë, me bezdinë e njeriut që s'do ta zgjatë muhabetin. Viktor Bregu u fye nga sjellja e tij. Kaluan rreth gjysmë ore pa folur. Rruga që e vështirë, me kthesa të forta e të shpeshta, e paasfaltuar ende. Kështu do të që deri në Leskovik.

... Atëherë ai që nëndrejtor i shkollës dhe iu vu pas zënkës sa s'i la kusur. E mbanin si mësuesin më të përgatitur. Dhe që në të vërtetë. Po sidoqoftë, sidoqoftë me mua duhej të arsyetonte më thellë. Po nejse. Vetëm çudi si s'kam fije dëshpërimi për të. Jo, zemërim s'kam, po diçka si peng, si ndrydhje, për një padrejtësi që i është bërë një tjetri vite e vite më parë, kjo më shqetëson disi. Dreqi i marrtë të tëra, tha pastaj dhe e pa tjetrin me pamjen e njeriut që kërkon ndjesë.

Mësuesi nuk e vuri re dhe shoferi e korrigjoi pamjen e fytyrës si diçka për të cilën në fund të fundit s'kishte ndonjë detyrim.

U futën në një fshat kufitar. Pranë rrugës që një bufe-restorant.

— Sikur të pinim ndonjë kafe, — tha mësuesi.

— Si të doni.

Shoferi mënjanoi makinën, ndaloi dhe zbriti i pari. Priti në heshtje sa zbriti dhe udhëtari, mbylli dyert dhe u nis drejt restorantit. E shoqëroi mësuesin pranë një tavoline, e ftoi të ulej me një lëvizje të lehtë të dorës dhe porositi

kafet. Erdhën edhe kafet, i pinë në heshtje dhe u ngritën. Shoferi u drejtua nga banaku, ndali me një zgjatje të krahut mësuesin, që donte të paguante, doli, shkoi te makina dhe u fut brenda. Pas pak u nisën.

— Dukesh shumë i mërzhitur, — vërejti mësuesi.

— Jo, pse?

— Atëherë e ke zakon të mos bisedosh me pasagjerët.

Tjetri nënqeshi lehtë.

— Varet, — tha.

I çuditshëm, mendoj mësuesi. Ndoshta është nga ata lloj tipash që nuk duan të krijojnë intimitet me udhëtarët, në mënyrë që ta kenë të lehtë në fund t'u marrin të hollat. Ku i dihet.

— Ç'hall ke në Korçë? — pyeti befas shoferi.

— Kam djalin në Institutin Bujqësor, — tha mësuesi. — Nuk di se ç'dreqin ka bërë dhe më kërkojnë me ngut.

— Hall paskeni, — tha shoferi, — mos jua përjashtojnë.

— Si ta përjashtojnë?

— Po ja, i teket ndonjë pedagogu, ngul këmbë dhe fishek nga shkolla.

Mësuesi qeshi.

— Nuk bëhen gjërat ashtu, — tha.

— Pse? — pyetja u bë me nervozizëm.

— Tani varet ç'ka bërë, — tha mësuesi, — po, teksa më kërkojnë, nuk do ta përjashtojnë. Pastaj, unë i kam aq njerëz, sa të mos e lë të ma hedhin djalin në rrugë.

Shoferi ktheu disa herë kokën drejt tij i pakënaqur.

— E pse thoni në rrugë? Po ta përjashtojnë, ai, ta zëmë, bën një kurs për shofer, merr patentën, gjen një makinë si kjo imja dhe bëhet njeri i nderuar, apo jo?

Mësuesi u ndodh ngushtë. Qeshi dhe i ra lehtë në shpatull djalit të ri, që kthente herë pas here kokën për të marrë përgjigje.

— Mbase nuk u shpreha mirë, — tha Viktor Bregu, — po ja që unë dua që djali ta mbarojë Institutin. Këtë desha të thosha.

Rruga ishte e përpjetë dhe makina ecte ngadalë. Anës tyre lëvizte një gjelbërim i dendur me pisha. Shoferi shikonte përpara i menduar.

— Po të ngulë këmbë ndonjë pedagog, edhe e përjashtojnë, mjafton që të ketë bërë diçka që lë shteg për një gjë të tillë.

— Jo, — tha Viktor Bregu, — unë jam mësues dhe e di mirë se një pedagog nuk e lë kush të bëjë si të dojë. Shkolla s'është pronë personale e mësuesve. Kupton?

Djaloshi e pa me vëmendje. Tani kishte pamjen e një njeriu kokëfortë.

— Nuk kuptoj, — tha.

— Po këtu s'ka ndonjë filozofi të madhe, — sqaroi mësuesi. — Te ne s'të lë kush të kënaqësh kapriçiot e tua në kurriz...

— Shikoni, — e ndërpreu shoferi me një revoltë që tjetrin e habiti. — Unë s'e kam fjalën për kapriçiot. Unë e kam fjalën për njeriun, si t'ju them, për atë masë të ndërgjegjes së tij që s'mund të kontrollohet dot nga të tjerët.

Mësuesi ngriti supet.

— Nuk po sqaronem dot, ë? — tha shoferi i druajtur. — Po ja, sikur ta nisja nga vetja ime. Unë jam snoter. Kjo makinë është e shtetit, dinet, po shteti ama ma ka besuar mua, dhe, ne njeфарë mënyre, unë bëj ç'dua me të.

— Jo, o...

— Pritni, s'kam mbaruar akoma. Pra makina është imja. Kush do të më pengojë mua këtë çast që ta ndaloj makinën dhe t'ju nxjerr ju përjashta!

— Këtë nuk duhet ta bëni, — tha mësuesi duke qeshur.

— Po ja që unë dua ta bëj se!

— E po nuk e bëni dot, sepse, në fund të fundit, s'keni arsye.

— Kurse mua, ta zëmë, më është mbushur mendja se kam edhe arsyen, edhe mundësinë për ta bërë.

— Ja që s'e bëni dot.

— E bëj, — tha shoferi, i vendosur.

Makina e uli shpejtësinë e pas pak ndali. Shoferi hoqi duart nga timoni, u drejtua i tëri nga Viktor Bregu, pastaj u zgjat dhe hapi derën e krahut të udhëtarit.

— Zbritni! — urdhëroi.

Mësuesi e shikonte dhe buzëqeshte.

— Zbritni, po ju them. Kjo makinë është imja dhe unë ju nxjerr jashtë. — Ai ishte i vrenjtur në fytyrë.

— Lërimi shakatë, — tha mësuesi.

— Nuk bëj shaka, — tha shoferi. — Zbritni nga makina!

— Ju e keni seriozisht?

— Po.

— S'është e mundur ta keni seriozisht, —
tha mësuesi, — ne po bënim muhabet

Viktor Bregu ishte bërë flakë i kuq në fytyrë. Po i vinte shumë rëndë që një diskutim i zakonshëm përfundoi në mënyrë kaq banale.

— Dilni jashtë, — tha shoferi përsëri me një këmbëngulje të çuditshme. — Unë do t'ju tregoj se deri ku shkojnë të drejtat e mia.

— E po unë nuk dal, — mësuesi buzëqeshi, duke bërë kështu përpjekjen e fundit për ta kthyer gjendjen e rëndë që qe krijuar në një shaka pa të keq.

— Ju do të dilni!

— Ashtu?! — Viktor Bregu lëvizi nga vendi i revoltuar, rrëmbeu xhaketën, duke parë me zemërim nga shoferi, zbriti dhe shkoi ndënjë të një gur kilometrik anës rrugës. Shoferi, gjithashtu, zbriti nga makina dhe shkoi pranë tij.

— Hë, si ju duket? — pyeti.

— Të lutem shumë, ik dhe më lër të qetë,
— tha mësuesi.

— Kush më ndaloi mua t'ju nxirrja jashtë nga makina?

— Askush. Ik tani.

Shoferi iu afrua edhe më. Tani në fytyrën e tij të re s'kishte mbetur asnjë shenjë nga zemërimi i mëparshëm. Buzëqeshi me një farë trishtimi të lehtë prej fajtori.

— Hipni, profesor, — tha pas pak me zë lutës, — hipni, të mos vonohemi.

— Ik, — tha mësuesi, — do të gjej një makinë tjetër, nuk më pëlqejnë karagjozllëqet!

Shoferi i hodhi dorën në sup i dëshpëruar.

— E jani të shkojmë dhe më falni për atë që ndodhi! Çohuni, profesor! Në makinë do t'ju them ca gjëra interesante, që do t'jua zbutin inatin.

— Falemnderit, — tha Viktor Bregu duke parë me vëmendje ndryshimin e menjëhershëm të pamjes së djaloshit. — Falemnderit shumë. Gjëja më interesante porsa ndodhi, kështu që s'ke ç'të më tregosh më.

— Kam dhe diçka. Ju lutem, çohuni!

Mësuesi u ngrit në këmbë.

— Po si mund të hipi unë në makinën tënde tani?!

— E po hipni. Unë ju kërkoj të falur. E gjithë kjo ndodhi në njëfarë mënyre edhe për fajin tuaj. Unë desha t'ju tregoja se jo në të gjitha rastet mund ta pengosh atë që bën keq, dhe jua ilustrova një gjë të tillë me një rast pak të rëndë, po për këtë ju kërkoj të falur njëqind herë. Hajde, falmëni tani!

— Shiko, — tha mësuesi duke lëvizur drejt makinës, — ti je një djalë shumë i çuditshëm, një tip që s'më ka rënë rasti ta ndesh ndonjëherë.

— Nuk është tamam kështu. — tha shoferi duke hapur derën e makinës dhe duke e ndihmuar tjetrin të ngjitej lart...

SI NDODH NGANJËHERË...

Porsa kisha shkarkuar makinën e fundit me dru dhe u nisa drejt barakës që ndodhej në qoshe të stacionit. Dielli përvëlonte si saç, aq sa të merrte frymën. Kisha mbetur krejt vetëm në fushën e druve. Punëtori tjetër kishte shkuar me leje, kurse unë duhej të përballoja 6-7 makina të parkut të Sarandës që ngarkonin dru në thellësi të qyllit dhe që vinin 3-4 herë në ditë për t'u shkarkuar, duhej të merresha gjithashtu edhe me stivosjen e druve. Në të vërtetë fitoja shumë lekë, po lodhja ishte e madhe; s'mund t'i lija makinat pa shkarkuar dhe drutë pa stivosur. Kisha mbaruar shkollën e mesme dhe doja të fitoja ca të holla për të shkuar në universitet. Ishim familje tepër e madhe për ta kërkuar çdo gjë nga prindërit.

Shkova te baraka dhe u ula nën strehën e saj. Qe pushimi i drekës dhe për dy orë rresht

nuk do të kishte makina. U ula përdhe, rehatova trupin mbi një krah kulprash, mbështela shpatullat pas dhogave të barakës dhe me sytë pothuajse të mbyllur, merrja frymë më nge, sikur kërkoja ta shijoja ngadalë gjithë kënaqësinë e prehjes dhe të hijes së iredkët që ma shkruftonte trupin. Pastaj dalëngadalë më mbërtheu një topitje e këndshme, një lentësim i mrekullueshëm, që bënë të më dukej vetja si një shpend që vozit nëpër hapësira të vakëta. Kori monoton i gjinkallave vinte valë-valë, si një nanurisje e ëmbël dhe unë në çast humba ndjesinë e realitetit. Pikërisht në një gjendje të tillë isha, kur ndjeva se dikush po më fliste. Në fillim s'doja ta besoja atë zë, s'doja të besoja në të as kur hapa kapakët e rëndë të syve dhe dallova disa metra larg një njollë të bardhë si vegim, po zëri i pamëshirshëm u dëgjua sërisht dhe unë u shkunda i tëri nga një dridhje e papritur, dhe e bezdisshme. Çfarë s'do të jepja për të më lënë të qetë.

— O shok, të lutem, kur shkojnë makinat për në qytet? — Ajo që fliste ishte një vajzë e re, e veshur me një fustan të bardhë basme. Më vështronte disi e trembur dhe e shqetësuar. Unë lëvizta pak nga vendi, shpiva krahët, mora frymë thellë dhe psherëtiva i lodhur.

— Më fal se të zgjova, — tha vajza, e përkulur disi, në pozicionin e njeriut që është gati t'ia krisë vrapit nga çasti në çast.

— Çfarë do? — pyeta duke e shtuar më shumë ndjenjën e bezdisë.

— Shkoj në qytet, — tha. — Desha të pyesja për makinat e druve.

— Ëhë, makinat e druvé.

— Në ç'orë nisen?

— Nuk shkon asnjë makinë para orës shtatë,
— thashë me ton kompetenti.

— Kaq vonë? — tha ajo e shqetësuar.

— Kaq.

Vazhdonte të rrinte në këmbë dhe ndjenja e druajtjes dhe e frikës bashkë nuk po i hiqeshin për asnjë çast nga pamja. Sytë e saj ishin tërë vigjilencë.

— S'ka njeri këtu? — pyeti pas pak.

— Unë, — thashë, — pse, nuk të dukem si njeri?

Ajo buzëqeshi lehtë e ftohtë.

— Jo, — u shfajësua, — desha të pyesja nëse ka njeri tjetër veç jush.

— Tani jeni dhe ju, — i shkova unë pas logjikës së humorit.

Si duket, një gjë e tillë asaj iu duk tepër e guximshme për rrethanat në të cilat ndodheshim dhe u tërhoq një hap më pas. Veç kësaj, unë vura re si ajo, në mënyrë të rrufeshme, mati disa herë me radhë distancën midis meje dhe asaj. Po rrija i qetë dhe i heshtur, me pamjen e njeriut të zhytur në hallet e veta, të çinteresuar për gjithçka tjetër. Megjithatë prania e saj më shqetësonte në mënyrë të çuditshme. Më dukej vetja si i rënë në një trill artistik, si një hero filmash. Vajza ishte shumë e bukur dhe e trembur. Flokët i kishte ngjyrë-gështenjë, të shndritshëm dhe të mbushur me flutura diellore. Ata ishin tepër të gjatë dhe ajo herë pas here i hidhte pas me bezdi.

— Do të presësh? — pyeta.

— Nuk e di, — tha vajza duke më parë me vëmendje.

— Si të duash, — thashë. — Unë tani do të ushqehem. — Zgjata dorën, mora çantën, shtrova një pece përpara dhe nxora bukën, ca feta sallam, domate e djathë.

— Po s'të vjen rëndë, urdhëro të hamë!

— Jo, falemnderit!

Fillova të haja. Ajo rrinte në këmbë e menduar.

— Po ti mos ki frikë, — thashë, — ulu. Unë s'jam ari.

— Jo, belbëzoi ajo, — përse të kem frikë.

Ndenji dhe disa çaste në mëdyshje, pastaj, me hap të ngadaltë u ul disa metra larg meje. Unë vazhdoja të haja i heshtur. Herë pas here ngrija kokën dhe hasja në vështrimin e saj kureshtar e të trembur, që ndiqte çdo lëvizje timen.

— Më ka marrë uria shumë, — thashë. — E kam filluar punën që në orën katër të mëngjesit. Jam vetëm.

— Po pse? — pyeti ajo pa interes.

— Shoku tjetër ka shkuar në një dasmë.

— Ëhë.

— Ç'ti bësh!

— Keni kohë që punoni si druvar?

Më erdhi për të qeshur nga pyetja e saj.

— Që kur kam lindur, — thashë pa e ngri-tur kokën.

— Si? — ajo qeshi lehtë, pastaj ndenji disa çaste në heshtje dhe befas shpërtheu në një të qeshur të fuqishme.

Unë vazhdoja të haja në heshtje. Vajza u qetësua.

— Më fal, — tha, — po, kur erdha radhën e parë, këtu ishin dy punëtorë të tjerë, ndaj pyeta.

Vajza tani ishte e lirshme. Qe vendosur mirëkuptimi.

— Nga jeni ju?

— Ne banojmë në Tiranë, — tha vajza, — po me origjinë jemi këtej.

— Kryeqytetase, — thashë me zili.

— Eh, kryeqytetase. Të mendosh që gjithë të afërmit i kam këtu, kurse unë s'njoh asnjërin, sikur jetoj në Hënë, — tha ajo e dëshpëruar. — S'e merr me mend sa rëndë më vjen. Po ç't'i bësh! Unë jam vajzë e vetme dhe prindërit s'durojnë dot një ditë të më kenë larg. O, është e vështirë të jesh fëmijë i vetëm. Mos jeni gjë dhe ju i tillë?

— Unë? Çne. Ne jemi aq shumë në shtëpi, saqë nëna orë e çast na ngatërron emrat.

— Ah, sa qejf është të të ngatërrojnë emrin, — tha vajza e menduar.

— S'është ndonjë qejf i madh, po të mendosh që ngandonjëherë mund të të lënë dhe pa pjesën tënde të ushqimit.

— Pse, dhe kjo ndodh?

— Po të mos jesh në shtëpi në orarin e caktuar, je gjithnjë i kërcënuar, — thashë.

— E megjithatë, prapë është gjë e bukur, — tha vajza me një pamje melankolike. — Në qytet banoni ju?

— Po!

— E po ju duhet t'i njihni kushërinjtë e mi. Qyteti juaj është i vogël.

— Kush janë këta?

— Lllazar Guri, — tha ajo, — e njihni? Është kushëriri i parë i nënës. Ai dhe e shoqja kanë ardhur në shtëpi te ne, kurse unë vij këtu për herë të parë.

Shtanga kur dëgjova emrin e tim eti.. Lashë bukën mbi pece dhe ia qepa vështrimin vajzës për një kohë të gjatë. Ajo rrinte me sytë për-dhe dhe buzëqeshte me vete.

— I njihni? — pyeti.

— Po!

— Ka një vajzë në universitet. Atë e njoh, kurse për të tjerët s'di gjë. Dëgjo, sikur të mos ishte ngulmimi i nënës, as që kisha për të shkuar. Nuk është ndonjë qejf i madh të shkojë tjetri te kushërinj që s'i njeh. Si thua ti?

— I zmadhon një çikë gjërat, — thashë. — Ja, pak më parë ne ishim krejt të panjohur për njëri-tjetrin, kurse tani po flasim sikur të kemi njëqind vjet që njihemi.

— E pse, ç'po themi ne që ngjakërkemi sikur kemi njëqind vjet që njihemi? — tha ajo me një pakënaqësi të lehtë. — E megjithatë gjërat nuk janë njësoj. Unë me ty, po të dua flas, po të dua nuk flas dhe s'kam asnjë detyrim.

— Po të duash, mos fol!

— O, po unë e mora si shembull, — tha vajza buzagaz. — Pastaj, dëgjo, për një vajzë është akoma më vështirë. Apo s'është kështu?

— Nuk e di, — thashë, — s'kam qenë ndonjëherë vajzë.

Ajo qeshi sërish dhe u afrua më pranë.

— Më vjen rëndë të vete vonë, — tha, — është hera e parë.

— S'ka gjë, — thashë, — të çoj unë. Do t'i lutem ndonjë shoferi të ikim më herët.

Pas hutimit të parë, tani po më vinte për të qeshur. Kush duhej të qe kjo kushërirë e panjohur?!

— Si e quajnë babanë tuaj?.

— Babanë tim? Pse?! — pyeti ajo e habitur.

— Kot.

— Mihal e quajnë.

U ngrita në këmbë, mbështolla bukën me pece dhe e vara në një nga gozhdët e barakës. Mihal. Kisha dëgjuar të flitej shpesh në shtëpi për të, për të shoqen dhe për vajzën e tij të vetme. Kufijtë e aventurës ku mendoja se kisha rënë, tani ishin zgjeruar në përmasa shumë të çuditshme dhe unë mendova ta luaja rolin tim sipas qejfit. E dija që vajzën e quanin Shpresa dhe që vazhdonte ose kishte mbaruar shkollën e mesme të gjuhëve të huaja.

— Kështu, — thashë duke qeshur, — do të të çoj unë te kushërinjtë. Tani do të zbres në fushë, të stivos dru që t'i mbaroj shpejt. Ti më prit këtu. Në rast se do të kesh uri, shike se diçka ka mbetur në çantë. Kë edhe një pagur, një pagur me ujë.

— Të vij edhe unë të të ndihmoj? — tha ajo me sinqeritet.

— Jo, Shpresa, jo, — thashë.

Vajza u ngrit në këmbë e mahnitur.

— Ku e di ti që më quajnë Shpresa?

— Ti vetë ma the.

— Jo, — tha ajo, — nuk ta kam thënë.

— Si s'ma the? Mos vallë unë shtiva fall?!

— Çudi, — tha ajo e nënshtruar. — Mua nuk më kujtohet fare një gjë e tillë.

— Ja që më kujtohet mua, — thashë duke zbritur poshtë për në fushën e druve.

Ajo vazhdonte të qëndronte në këmbë e hutuar.

— Dëgjo! Mos harro t'u thuash shoferëve të ikim shpejt.

— *All right!*

— Ej, ej! — klithi vajza. — Mos vallë të thashë edhe që jam nxënëse në shkollën e gjuhëve të huaja?

— Jo. Këtë e gjeta vetë, — thashë duke ikur.

Vajza bëri disa hapa përpara.

— Dëgjo, ti po më çmend!

Ndala në vend, u ktheva i tëri nga ajo, vura duart pranë fytyrës në formë hinke dhe fola me zë të lartë që të më dëgjonte:

— Nuk bën të çmendesh pa u njohur me kushërinjtë. ,

Ajo lëvizi disa herë dorën në ajër dhe shkoi u ul në strehën e barakës.

... Në qytet vajtëm vonë. Zbritëm nga makina në skaj të tij, kaluam shëtitoren në qendër dhe pastaj u futëm mes një rruge të rrethuar me pallate të reja.

— Këtu banojnë kushërinjtë e tu të dashur, — thashë, duke treguar njërën nga ndërtesat.

— Falemnderit, — tha ajo dhe më zgjati dorën.

— Jo, do të të çoj deri lart.

— Po s'ka gjë, — tha ajo disi e bezdisur,
— shkoj vetë.

— Jo, — ngula këmbë, — tani unë përgjigjem për ty.

U ngjitëm lart të heshtur. Përballë derës ajo lexoi emrin e të zotit të shtëpisë dhe fytyra i ndriti nga gëzimi. U kthye nga unë me dorë të zgjatur.

— Falemnderit shumë, — tha, — tani...

Edhe unë zgjata dorën. Ajo pa nga dera e mbyllur dhe mori frymë thellë.

— Sa rëndë më vjen, — tha.

— Po qe kështu, shkojmë nga shtëpia ime,
— thashë duke qeshur.

— Falemnderit, — tha ajo e vrenjtur dhe shkeli butonin e ziles.

Ndenji dy-tri sekonda përballë derës, pastaj u kthye nga unë, me pamje të rreptë e të revoltuar.

— S'është nevoja të rrini më, — tha, — unë ju falënderova për aq sa bëtë.

Në çast dera u hap dhe në prag të saj doli nëna. Ajo gati sa s'u përplas me fytyrën e vajzës. Nuk e njohu, ngaqë e kishte tepër pranë, apo ngaqë vajza e re duhej të kishte ndryshuar që nga koha kur ishin takuar për herë të fundit. Ndenjën kështu disa çaste, përballë njëra-tjetrës, pa folur nga hutimi. Vajza ktheu kokën nga unë e trembur. Kur vuri re praninë time të qetë, që asaj iu duk si një guxim i paturpshëm, u bë flakë e kuqe në fytyrë. Pikërisht në këtë çast më pa edhe nëna.

— Hë, mor bir erdhe? — tha.

Unë nuk di se ç'ndodhi me vajzën në ato çaste, veçse ajo u drodh aq fort dhe përshkoi një vështrim aq të trembur midis meje e nënës, saqë edhe një somnambul, që ngrihet nga shtrati e zgjohet në mes të natës buzë një greminë, do të qe ku e ku më i qetë.

— Si! — mërmëriti me zë të këputur.

Unë e kapa nga supet edhe i ngrysur edhe i turpëruar që shakaja ime i kushtoi disi shtrenjtë dhe e futa brenda.

CA DITË NGA PUSHIMET

Ishte dita e pestë në plazh dhe gjithçka më dukej e bukur dhe e këndshme. Ndieja një lehtësi të çuditshme në të gjithë qenien, aq sa më dukej vetja interesant. Pajtimi i plotë me detin dhe me rërën e nxehtë më mbushte me një gëzim të lehtë si pupël. Isha me dy shokët e mi të punës, po çadra jonë mbushej përplot me njerëz rastësorë dhe kështu krijohej vazhdimisht një humor i këndshëm e shpërthyes, që infektonte shpesh dhe periferitë e afërta. Pikërisht në një çast të tillë erdhi ai. Qe një burrë mbi të dyzetat, me pamje të qetë prej intelektualit dhe me supe të djegura nga dielli.

— Keni dëshirë të luani shah me mua? — tha duke buzëqeshur në mënyrë shumë të sjellshme.

— Pse jo, — thashë.

Ai tundi kokën i kënaqur nga gatishmëria.

— Shkojmë te çadra ime, — tha dhe zgjati dorën për të treguar vendin.

— Si të doni.

U ngrita dhe fillova të lëvizja pas burrit të panjohur. Kapërcyem 5-6 çadra dhe më në fund ai u ndal. Nën çadër rrinin një grua e re, me rroba banje ngjyrëblu dhe dy fëmijë të vegjël. Gruaja ndjeu që u afruam dhe u ngrit. Unë i zgjata dorën pa ditur si t'i prezantohesha dhe ajo, pa ndonjë lloj angazhimi, më zgjati të sajën.

— Do të luani shah?! — tha e bezdisur.

— Po, — thashë unë, i pakënaqur nga qëndrimi i saj, — shoku më ftoi, megjithëse, — iu drejtova burrit, — nuk jam ndonjë lojtar kushedi çfarë.

— S'ka gjë, — tha i panjohuri, — sikur do të luajmë për kampionat. — U ulëm. Ai mori shahun, shtroi një çarçaf të vogël përdhe, nxori gurët dhe filluam t'i vendosnim.

— Ku e dinit ju që unë luaj shah? — pyeta.

— Ju pashë dje, — tha burri. — Luajtët me një djalë të gjatë. Pastaj ne më duket se njihemi.

— Ashtu?!

Unë ngrita kokën i intriguar, e pashë partnerin tim të shahut me vëmendje, po në pamjen e tij nuk m'u duk asgjë e njohur. Ai kishte një fytyrë gati të rrumbullakët, dy sy të vegjël ngjyrë gri, disi të ftohtë e indiferentë dhe një shprehje të lehtë e të çuditshme pakënaqësie në tërë pamjen. Gjithmonë kam besuar se fytyra me pamje të tilla janë karakteristike në përgjithësi të njerëzve me karakter të rreptë e të rëndë, që i ka tërhequr pas vetes një shans prej

zyrtarësh që në rini. Megjithatë unë nuk e njihja.

— Ju jeni inxhinier gjeolog, apo jo?

— Jo, — thashë, — unë jam mekanik në parkun e makinave...

— Si?!

Tani ishte radha e atij të më shikonte me kujdes.

— E çuditshme. Ju ngjani si dy pika uji me një inxhinier gjeolog. Shih, Semi, — iu drejtua ai së shoqes, — a nuk ngjan ky me vëllanë e Hasimit, me atë gjeologun?

— E, pra, sa shumë që ngjakan!

Nuk e di pse m'u duk se ajo e bëri kot një pohim të tillë. Ndërkaq gurët i kishim vendosur dhe filluam lëvizjet. Dy fëmijët e vegjël, të dy djem, u ngritën në këmbë. I vogli, që duhej të ishte rreth katër vjeç, iu afrua të atit, hipi mbi të, u var mbi shpatullat e djegura nga dielli dhe gati sa s'ra në fushën e shahut.

— Dritan, të lutem, më lër të qetë, — tha burri i sjellshëm. Dritani nuk e la të qetë. Përkundrazi, u zgjat edhe më, lëshoi ca klithma të mpërhta triumfi e pas pak ra në fushën e shahut.

— Ah, sa djalë i prapë që po bëhesh ti, Dritan, — vërejti i qetë i ati dhe filloi të vendoste gurët e rrëzuar. — Ç'të bësh, — tha pas pak, — duhet ta nisim nga e para

— S'ka gjë. — thashë.

Sa filluam lojën, Dritani erdhi prapa meje, më qepi dy sy kureshtarë, zgjati krahët, mbushi pëllëmbët me veshët e mi dhe filloi të qeshte.

— Dritan, o i prapë, mos e shqetëso xhaxhin, — tha e ëma dhe e kapi të voglin nga këmba. Burrit i vetëtinë sytë nga zemërimi.

— Nuk është e nevojshme, Semi, nuk është e nevojshme, — tha ai me mirësjellje duke ia hequr dorën së shoqes nga këmba e të birit, — s'është e nevojshme. — Dritani e shfrytëzoi rastin e krijuar, qeshi, u përkul dhe më kafshoi njërin nga veshët.

— Ah, ç'dhëmbë të fortë paske, — thashë duke e kthyer dhembjen në një durim plot mirësjellje.

— Dritan! Sa herë të kam thënë që me të rriturit duhet të sillësh më mirë?!

Unë e shkëputa të voglin nga vetja dhe ia afrova gruas së re. Po tani e kishte radhën i madhi. Ai ishte një fëmijë me pamje të mrekullueshme. I shëndetshëm, me flokë të verdhë si mëndafsh dhe me sy të kaltër e vezullues. Të dukej sikur porsa kishte dalë nga tablot e Rafaelit. Po e vëreja i mahnitur, si një kryevepër të natyrës, ndërsa ai m'u afrova, më kapi dorën me forcë dhe më mori 3-4 gurët që kisha «ngrënë». Pastaj befas ngriti dorën lart dhe i përplasi ata mbi fushën e shahut.

— Ergys! Ah, sa djalë i keq që je! Shiko, babi po të thotë për të fundit herë: të lutem, të lutem, na lër të qetë të lozim me këtë xhaxhin, ndryshe babi do të zemërohet keq me ty.

Ergysi i ndjeshëm u tërhoq disa metra nga çadra, me kokën e varur mbi gjoks. I vumë gurët përsëri. S'kishim bërë veçse disa lëvizje, kur një grusht me rërë m'u përplas në fytyrë.

Kishte qëlluar Dritani. Befas gruaja filloi të qeshte me gjithë shpirt.

— Ç'fëmijë i jashtëzakonshëm që është, — tha mes kukurizmave, — e mbron të vëllanë si një bishë e vërtetë.

Unë fërkova sytë, pastrova fytyrën dhe buzëqesha përsëri me mirësjellje. U qetësuam dhe filluam të luanim.

— Ah, u hutova fare, — tha burri. — Po luajmë bashkë dhe nuk dimë cilët jemi. Mua më quajnë Skënder Shyti. Jam nga Berati, mjek. Semi, siç mund të dihet, është gruaja ime, mësuese e frëngjishtes. Kurse ju?...

— Më quajnë Ilir, — thashë, — jam teknik në parkun e makinave...

— Ah, shumë mirë, — më ndërpreu ai, — shah!

Bëra një lëvizje. Ndërkaq Ergysi ishte afëruar pranë meje me vështrim luftarak. Luaja dhe me bisht të syrit ndiqja lëvizjet e të voglit.

— Shiko çfarë inati serioz që ka Ergysi, — pëshpëriti Skënder Shyti, — tamam si burrë.

Unë e vështrova dhe u tremba kur pashë duart e tij të mbushura me rërë.

— Ergys, mos më qëllo me rërë, të lutem, — i thashë.

Ai më rrëshqiti një vështrim mospërfillës dhe iu drejtua të atit.

— Babi, je zemëruar me mua?

— Po, — tha Skënder Shyti me ton të rëndë.

— E po na atëherë...

Dy grushte me rërë na u përplasën në fy-

tyrë. Semi qeshte me klithma, unë shkundja rërën nga koka, kurse Skënder Shyti vështronte të birin i martirizuar. Prisja që më në fund zemërimi i tij të shpërthente dhe të merrej ndonjëfarë mase për të vegjlit, po nga të gjitha këto s'ngjau asgjë.

— Vazhdojmë, — tha Skënder Shyti duke e parë të birin disa herë me një vështrim që shprehte një pedagogji krejt të pakuptueshme për mua. Pas pak, si duket, ai kapi diçka nga çudia ime, u zgjat dhe më tha me zë të lartë:

— Nuk e merr me mend se ç'ndodh me Ergysin kur gabimet i qortohen me mospërfillje.

— E çuditshme, — thashë.

— Është tamam kështu, — tha ai, — mat!

... Nisëm lojën e dytë. S'kishim bërë veçse hapjen, kur në krahët e mi ra Dritani.

— Xhaxhi, bëj si gjel.

— Ah, po unë nuk di, — thashë duke mbrojtur fytyrën nga grushtet e tij të vogla.

— Di ti, di, — tha vogëlushi këmbëngulës.

— Dritani, mos e shqetëso xhaxhin, — tha Semi me mospërfillje.

— Xhaxhi! Bëj pra si gjel!

— Ki, ki, ki, — bëra unë.

— Prapë, prapë!

— Ki, ki, ki!

— Edhe një herë!

— Ki, ki, ki! — bëra unë i nervozuar në kulm.

Vogëlushi e quajti dëshirën e tij të plotësuar dhe u largua.

— Ka një këmbëngulje të çuditshme, — tha Skënder Shyti.

— Fëmijë interesant.

Skënder Shyti u ndie i detyruar të më hapte horizont për këtë temë dhe e la për një çast lojën.

— Është e habitshme me të, — tha. — Që dyvjeçar shihte në televizor dhe dallonte dhelprën, ujqit, macen, dhitë dhe gjelat. Kënga e një gjeli atë mund ta mrekullojë, siç na mrekullojon ne, ta zëmë, violina e Paganinit, apo pianoja e Shopenit. Keni dëgjuar për Paganinin dhe Shopenin?

— Po, — thashë unë.

— Kurse tek Ergysi ka më pak enigmë, — tha ai duke ulur kokën mbi tabelën e shahut, — por ai është racional si një matematikan.

— Sigurisht, — thashë.

— E keni mbaruar shkollën e lartë? — pyeti ai papritur.

— Jo.

— Ah, po... shah.

Gjatë gjithë kësaj kohe, me përjashtim të rasteve kur qeshte, Semi rrinte e shtrirë në rërë brinjas, si e izoluar nga një botë ëndrrash. Hidhte herë pas here sytë nga ne, më vështronte mua, buzëqeshte për mirësjellje aq mekanikisht, sa të dukej sikur të tallte dhe trazonte rërën me lëvizje të ngathëta e delikate. E kuptova se gjithë kujdesi pedagogjik për të vegjlit kishte rënë mbi burrin, autoriteti i diskutueshëm i të cilit e kishte bërë gruan të tërhiqej në një stepje admirimi.

Ditën e dytë Skënder Shyti më kërkoi përsëri për të luajtur shah dhe unë s'munda dot ta kundërshtoja. Ergysi dhe Dritani më pritën me vështrime ngazëllyese, kurse Semi, e bukur dhe indiferente, kishte marrë një libër të Viktor Hygoit në frëngjisht, dhe lexonte e përqëndruar. Më përshëndeti ftohtë dhe e bezdisur, vetëm me një rrudhje të shpejtë të buzëve. Në këto çaste do të doja t'i jepja një përgjigje të rreptë, me atë frëngjishten time të shkollës së mesme, sjelljes së saj fyese, po hoqa dorë kur mendova situatën që mund të krijohet.

— Sot do të marrësh hak për ditën e djeshme, — tha Skënder Shyti.

— Do të mundohem.

Filluam lojën. Skënder Shyti ishte shumë i përqëndruar, mendohej gjatë dhe pas çdo lëvizjeje ngrinte kokën dhe më vështronte me vëmendje e kureshtje zhbiruese. S'ishte e vështirë të kuptoja se ai ishte në shah një lojtar i zakonshëm, pa fantazi, por me një pasion të sëmurë. Njerëz të tillë mund të luajnë shah disa orë në ditë, të harrohen dhe të sakrifikohen për të si kumarxhinjtë. E kisha vënë në një pozicion të vështirë, dhe kjo gjë e acaronte. Dritani u afrua pranë të atit, iu ngjiti nëpër kurriz dhe i hipi në zverk. Gjesti i vëllait të vogël e ngacmoi edhe Ergysin, i cili u afrua pranë meje i entuziazmuar dhe më vuri duart

në shpatulla. Bobo, mendova. Hajde tani mbaj
20 kg Ergys në zverk.

— Ergys, të lutem, largohu!

— Babi! Dua dhe unë të hipi si Dritani.

— Jo, — i tha Skënder Shyti me zë të
qetë.

— Po unë dua të hipi, pra.

— Nuk bën të hipësh.

— Sa mirë bëka për Dritanin?!

I ati nuk i foli më dhe ndërkaq Ergysi
i bukur ndodhej mbi zverkun tim. Skënder
Shyti ngriti kokën, rrëshqiti një vështrim të
qetë mbi të birin, tha *ah çfarë koke ke ndonjë-
herë, ti, Ergys*, dhe ia qepi sytë fushës së sha-
hut. Të vegjlit qeshnin me zë të lartë dhe i
binin njëri-tjetrit me pëllëmbë. Skënder Shyti
ishte në një pozicion mati. Semin e kishte rrë-
mbyer Viktor Hygoi, kurse unë po pëlcitja nga
marazi. Për herë të parë po e urreja atë du-
rimin tim prej njeriu të sjellshëm. U mundova
disa herë ta rrëzoja të voglin nga qafa me ca
lëvizje gjoja të pakontrolluara, po nuk ia arrita.
Ergysi mbërthehej pas meje si tigër. Çfarë të
bëj me këta njerëz, thashë me vete. Përse duhet
të duroj tortura të tilla?

— Ergys, të lutem!

— E keni radhën ju të luani, — tha Skë-
nder Shyti i nervozuar.

— Ashtu! Po ju jeni mat, — thashë.

— Jo, pse?!

Skënder Shyti u bë flakë i kuq në fytyrë.

— Mat — thashë me zë të lartë duke vendosur
mbretëreshën përballë mbretit të partnerit
tim. Semi ngriti kokën, pa të shoqin dhe pyeti
e habitur:

— Skënder, të rrahu?

Ai nuk iu përgjigj. Vendosi me ngut gurët e vet dhe, gjithmonë i paduruar, më ndihmoi edhe mua të rregulloja gurët. Dy kalorësit e vegjël vazhdonin të qëlloheshin me njëri-tjetrin. Përqark njerëzit na shikonin të habitur, kurse ne luanim. Lojën e dytë e munda shumë shpejt. Ai kërkoi të kthehej edhe një herë pozicioni, por unë kundërshtova me kokëfortësi.

— Si, Skënder, përsëri të rrahu? — tha Semi e dëshpëruar.

— Lexo Hygonë ti, — u përgjigj Skënder Shyti i nervozuar.

— Këtë lojë e more fare kot, — m'u drejtua mua, i dëshpëruar, sikur t'i kishte ndodhur një fatkeqësi, — nuk e vura re filin tënd.

— Ndoshta të pengon Dritani që ke në qafë, — thashë.

— Jo. Nuk më pengon.

— Kurse mua Ergysi më pengon. Të lutem, hiqma këtë fëmijë, se plasa.

— Ergys, mos e pengo xhaxhin...

Edhe lojën e tretë e fitova unë, megjithëse mbaja në qafë një peshë më të rëndë se ajo e kundërshtarit. Mezi u largova...

*
* *

Dita e tretë dhe e njëjta gjë. Ai erdhi më kërkoi.

— E di si është puna, — i thashë, — sot s'mund të vij të loz, jam i zënë.

— Eja tani, — tha Skënder Shyti duke qeshur. — Apo fitove dje dhe...

— Nuk mundem.

— Edhe fëmijët janë mësuar me ty tani. Po të presin.

— Po kam një punë, mor shok, — i thashë i përmbajtur.

— Hajde tani, lëri nazet.

Ai më kapi nga shpatullat me intimitetin e një të njohuri të vjetër, më ngriti në këmbë dhe kishte një vështrim aq lutës dhe të përulur njëkohësisht, saqë unë më në fund u dorëzova. Ikja me ndjesinë e njeriut që e çojnë në tortura. Semi më përshëndeti përsëri ftohtë, bile, më shumë se kaq, edhe me njëfarë bezdie të shpallur. Të vegjlit më shihnin me kureshtje, kurse çadrat përçark më hidhnin vështrime plot keqardhje, si ato që i hedhin një fatkeqi që e pëson nga budallallëku i vet.

Filloi loja. Fëmijët vinin rrotull, të kapur nga mania për të imituar zhurmën e lokomotivës së trenit. Çuf, çuf, çuf, bënin me pasion aq të madh, saqë qenë bërë ujë në djersë. Skënder Shyti luante i zymtë dhe i trembur nga humbja e djeshme. Semi, si gjithnjë e bukur, me flokët mbledhur nga pas topuz, lexonte e përqendruar Viktor Hygonë. Fytyra e saj ngjyrëçekollatë tronditej herë pas here nga një kënaqësi e ankth elegant, që e bënin kështu më tepër të largët e të huaj. Ajo dukej midis nesh si një qenie krejt rastësore dhe e përkohshme, që s'kishte të bënte as me të shoqin, as me fëmijët dhe aq më tepër me mua.

Ato që ndodhnin aty me të vegjlit, ajo i

shoqëronte herë pas here me të qeshura shpërthyes dhe pastaj tërhiqej në botën e saj të patrazuar, duke na i lënë vuajtjet neve të tjerëve.

Luaja shah i kapur nga mania gati cinike për të fituar dhe për të parë pastaj se si kundërshtari im do të ngjishej e do të rrudhej nga një shqetësim i ri. Kisha tri ditë që po vuaja nga ky njeri dhe nga plogështia ime për ta kundërshtuar. Fëmijët nuk po e imitonin më zhurmën e lokomotivës së trenit. Ishin tërhequr në qoshë të çadrës dhe po shikonin përçark. Kushedi ç'trill i ri do t'i kapte. Pranë meje u afrua Dritani.

— Xhaxhi, ke gjuhë ti?

— Kam, — thashë i trembur.

— Nxirre gjuhën! — urdhëroi ai.

— Dritan! Mos u bëj çun i keq. Ndryshe do t'i ankohe babit për ty.

Skënder Shyti ngriti kokën, më vështroi një çast i pakënaqur, pastaj u zhyt përsëri në lojën e shahut. Edhe sot s'po i ecte.

— Nxirre gjuhën, — ngulmoi Dritani.

— Nuk mundem, — i thashë, — nuk mundem. Po pa shih, mbase ka dhe babi gjuhë.

I vogli pa disa çaste i menduar nga i ati, nënqeshi i lumtur, pastaj lëvizti drejt tij dhe i bëri të njëjtën kërkesë.

Skënder Shyti mënjanoi pak kokën dhe e nxori gjuhën pa ngurruar. I biri ia mbërtheu me të dyja duart.

— Jo me të dyja duart, — tha Skënder Shyti, pa i hequr sytë nga fusha e shahut, — ashtu s'e kap dot kurrë. Provo me njërin.

— Gjuha doli përsëri jashtë dhe Dritani, duke qeshur, i kënaqur manifestoi plot sukses aftësitë e veta për ta kapur gjuhën e të atit me një dorë. Pas pak i vogli m'u drejtua mua përsëri.

— Xhaxhi, nxirre dhe ti gjuhën!

— Jo, — thashë duke i lëmuar kokën.

— Nxirre, nxirre!

— Jo, — i thashë sërishmi dhe e mënjanova nga vetja. Ai ra në rërë duke përplasur këmbë e duar sa nga njëra anë në tjetrën. Para nesh u ngrit një re e dendur pluhuri, aq sa u detyruam ta ndërpritnim lojën dhe të kthenim kokat mënjanë.

— Ti, — tha Skënder Shyti, — je shumë i ashpër me fëmijët.

— E pse?

— Nxirre pak gjuhën dhe kaq! Matesh me një fëmijë, — tha i vrenjtur.

— Ti m'i thua seriozisht këto fjalë?

Si duket, kisha folur me zë të lartë se Semi e ndërpreu për një çast leximin dhe po më shikonte e habitur.

— Uf, ç'njerëz, — shfryu Skënder Shyti me pakënaqësi.

Unë mënjanova fushën e shahut, u ngrita në këmbë dhe po vëreja me tronditje burrin nga Berati, që po më shikonte me qortim të rëndë pse s'kisha plotësuar një tekë të të birit. E ndieja se kisha një pamje arrogante dhe fryma e rrëmbimit që ishte shfaqur tek unë, atij i dukej në të njëjtën kohë fyese dhe absurde.

— Dëgjo, — i thashë. — Unë do të iki dhe

s'do të pranoj kurrë të vij e të luaj shah me ju.

— S'kuptoj, ç'pate kështu? — tha Skënder Shyti duke u dridhur nga nervozizmi dhe nga fyerja publike që mendoj se po i bëhej. — I pasjellshëm!

— Pse, ç'kujtoni ju? Mos vallë mendoni se kam ndonjë detyrim që të sakrifikoj pushimet e mia, të vij e të bëj ç'duan këto dy egërsira të vogla dhe të dëgjoj edhe fyerjet tuaja?

— Skënder! Mos u merr me të, — tha Semi e revoltuar.

E ktheva për një çast inatin tim nga gruaja e re. Ajo ngriti deri pranë fytyrës, sikur do të mbrohej, librin e Hygoit. Unë nuk fola. M'u duk sikur do ta ngatërroja në sherr padrejtësisht dhe shkrimtarin e madh. Ula kokën, thashë një «lamtumirë» që m'u shpërblye me një «ik, ore...» dhe u nisa me hapa të shpejtë. Megjithëse për një çast më tronditi mendimi mos isha sjellë ashpër me ta, kur u afrova pranë çadrës sime, vetja m'u duk i lehtë dhe i lumtur si një njeri që ka fituar lirinë e humbur...

MIRMËNGJESI... I DASHUR!

Mëngjesi ishte i ftohtë, i mbështjellë i tëri me mjegull të kaltër dhe erë që ta shponte fytyrën si mijëra spica. Ai doli nga shtëpia, fërkoj duart me njëfarë drithërime lumturie, ngriti jakën e pardësysë dhe u nis për në zyrë. Rrugës kalimtarët e përshëndetnin me shkujdesjen gati të përgjumur që kanë njerëzit në orët e para të ditës dhe ai ndiente kënaqësi.

Hyri në zyrë, hapi dritaren që të nxirrte jashtë ajrin e ndenjor të natës, pa nëse ishte nxehur kaloriferi dhe u ul në karrige. Afroi pranë vetes një dosje të bardhë, e hapi ngadalë dhe, me një vëmendje të papërcaktuar e hutim bashkë, qëndroi në pritje me një buzëqeshje prej çapkëni. Ja tani, tha me vete, tani, dhe ndjeu se po turbullohej nga një ndjesi delikate që i shpërndahej nëpër trup si një parfum

i hollë. Tani, tha për së dyti dhe ia qepi sytë telefonit të bardhë në skajin e tavolinës, që heshtte në një pritje të paduruar. Kishte pothuajse një muaj që kjo gjendje shpirtërore ishte kthyer në një rit të të gjitha mëngjeseve të tij. Ra zilja e telefonit dhe ai ndjeu, si gjithnjë, kur dëgjonte tingëllimën e mprehtë e gërvishtëse, t'i shkëputej diçka me dhunë nga thellësia e gjoksit, diçka e rëndë dhe e tepërt, që e ngrinte befasisht lart si një balonë fëmijësh.

— Alo! — shqiptoi në përhumbe. Në skajin tjetër të telit pasoi një heshtje e shkurtër. Në vesh i erdhi një zhurmë e mbytur, e qetë, si një fëshfëritje gjethesh në vjeshtë.

— Mirëmëngjesi... — prapë heshtje e shkurtër, po tani boshllëku mbushej me frymën e asaj që fliste, si me një erë që fryn nga kurora e trëndafilave.

— Mirëmëngjesi... i dashur!

— Po kush jeni ju?

Në anën tjetër u bë një zhurmë e lehtë, si ajo e një xhami që thyhet, dhe në dhomë u dëgjua sinjali monoton i telefonit të mbyllur. Ai e la receptorin i mërzitur, u ngrit në këmbë, vendosi pardësynë në varëse, shpiu gjymtyrët, mbylli dritaren dhe filloi të shfletonte dosjen e mbushur me shkresa. E njëjta gjë, tha i ngrysur, pasi u distancau disi nga zëri misterioz dhe tronditës që i pëshpëriste çdo mëngjes vetëm ato dy fjalë. Gjithmonë po ai zë femre i kthjellët, i mbushur me lutje e pritje, që thoshte «mirëmëngjesi, i dashur» dhe që nuk pranonte të jepte asnjë sqarim të më-

tejshtëm. Dhe në çdo ditë ishte po në të njëjtën masë i trishtuar, ngacmues dhe ëndërror si në mëngjesin e parë. Tamam sikur të ishte incizuar në një shirit magnetofoni. Mirëmëngjesi, i dashur! Ora e parë e mëngjesit ishte gjithmonë e tensionuar nga përfytyrimi i së panjohurës, që kishte më shumë se një muaj që i fliste në telefon dhe nga ideja shqetësuese se ndofta diku po përgatiteshin ta bënëin qesharak. U ngrit, doli në korridor me hap të ngadaltë shkoi në një nga zyrat fqinje.

— Mirëmëngjesi, Irena!

— Mirëmëngjesi! — ia ktheu vajza.

Fytyra e saj ishte naive, e kthjellët, me sytë ende të pashkundur nga përgjumja. Me një pamje të tillë nuk mund të bësh asnjë çapkënllek, mendoi ai. E justifikoi ardhjen me një kërkesë të zakonshme pune dhe doli. Po kush ishte ajo? Mirëmëngjesi, i dashur! Ai ishte një tip i ekuilibruar dhe me njerëzit ndërtonte vazhdimisht marrëdhënie korrekte, veçanërisht me vajzat. Ishte njohur me shumë syresh kalimthi, por asnjëherë nuk i kishte lënë detyrimin për t'i thënë çdo mëngjes ato fjalë. Hyri në njërin nga zyrat e seksionit të bujqësisë.

— Mirëmëngjesi! S'qenka këtu Niku?

— Jo, — tha gruaja që rrinte në tavolinën përballë, — ka dy ditë që ka shkuar me shërbim.

— Ku kështu?

— Ou, — u bezdis gruaja duke përpëlitur sytë me padurim nën xhamin e bardhë të syzeve të mëdha, — merret vesh Niku!

— Ashtu? Mirupafshim!

Gruaja lëvizi kokën duke e përcjellë me një buzëqeshje të ftohtë. Me të ai njihej që para shtatë vjetësh, kur kishte filluar punën në komitet. Po ajo fytyrë e ftohtë dhe e bardhë si pllakat majolike, po ata flokë të dendur ngjyrë bakri, që dukeshin sikur ishin krehur dikur me një kujdes të përsosur dhe kishin ngrirë ashtu përjetësisht, po ata sy të vegjël, të shqetësuar e të pakënaqur, të kredhur në një ndriçim gati të lëngët që të largonin me ngut dhe, më në fund, po ajo sjellje e matur dhe e rreptë, që të shkaktonte një ndjenjë inferioriteti. Artani vinte vazhdimisht në zyrën e saj për të takuar Nikun dhe ndiente se as me praninë e tij dhe as me ato që thoshte, s'i kishte ngjallur ndonjëherë kureshtje. Gra të tilla, mendonte ai, janë kandidatet e para për plaka mistrece. Ajo, më pak se të gjitha femrat që njihte, mund t'i thoshte ato fjalë: «Mirëmëngjesi, i dashur!»

Shkoi në zyrë dhe hapi përsëri dosjen e bardhë. Nxori me radhë disa shkresa të lidhura me kapëse dhe u ndal qëllimisht, te njëra prej tyre. Ishte kërkesa për transferim që bënte një mësuese e re. Në skaj të letrës ishte shënimi i nxituar i nënkryetarit: «Të shihet me përparësi kërkesa e saj.» Lutja duhej t'i shkonte përgjegjësit, por ai ishte me një ekip kontrolli dhe Artani kishte mbetur i pari i seksionit. Vajza kërkonte të afrohej pranë shtëpisë, pasi kohët e fundit i qe paralizuar e ëma dhe shtëpia s'kishte asnjë grua veç saj. Sot do të vinte të merrte përgjigje. E la kërkesën, shkoi pranë raf-

tit të librave, hapi një sirtar të madh, nxori një regjistër po aq të madh dhe filloi të kërkonte emrin e vajzës. «Mirëmëngjesi, i dashur!» E la regjistrin për një çast dhe i hodhi sytë nga xhami i djersitur i dritares. Tej saj feksnin ca pamje të mjegullta si në diafilma. Pastaj dalëngadalë ra në një humbëtirë të vakët si në një lektisje dhe ndjeu se s'kishte forca të mendonte asgjë.

Dera trokiti tri herë me kërcitje të druajtura.

— Hyni! — tha ai i trembur dhe mori në dorë stilografin. Arriti t'i jepte fytyrës një pamje të qetë e të menduar prej nëpunësi të kredhur në punë. Dera u hap ngadalë dhe brenda u fut një vajzë e re me pardesy treçerekëshe ngjyrë blu, të mbërthyer deri në kopsën e fundit. Fytyra i qe përskuqur nga thellimi.

— Mirëdita, — tha vajza me druajtje, — desha shokun Reshit.

— Shoku Reshit është me shërbim, — tha Ariani duke afruar stilografin te buzët, gjest ky që imitonte gati pikë për pikë përgjegjësin e zhytur në mendime.

— Vërtet? — u dëshpërua vajza dhe shkopsiti ngadalë një kopsë të pardësyesë. — Po kush e zëvendëson?

— Mund të bisedoni me mua.

Vajza bëri disa hapa drejt tij dhe zgjati dorën.

— Të ulem? — buzëqeshi pas pak.

— Më falni, — tha ai dhe i zgjati një karrige.

Vajza u ul dhe fytyra e saj u skuq edhe më nga ngurrimi. Ai i njihte këto çaste, e hoqi vështrimin prej saj dhe filloi të shfletonte regjistrin që kishte në tavolinë aq, sa t'i linte kohë që të qetësohej.

— Kam bërë një kërkesë për transferim,
— tha vajza, — para disa kohësh nëna...

— Ju jeni Fatbardha Sina, — e ndërpreu ai duke qeshur.

— Po.

— Ja kërkesa juaj. Ka dhe një shënim nga shoku Andon për t'u parë me përparësi.

— Vërtet?! — tha vajza e ngazëllyer.

— Ja, shikojeni.

Ajo u zgjat pak, lexoi shënimin dhe u tërhoq në çast. Pas disa sekondash fytyra e saj qe ngrysur.

— Sikur të mos qe nëna, — nisi ajo të shpjegohej, — sikur të mos qe nëna...

Ai i ndiqte fjalët e saj me një pamje për të qenë sa më korrekt. «Mirëmëngjesi... i dashur!» Zëri i asaj që fliste tani qe ndryshe, i hollë, i kumbueshëm dhe i penguar nga drujtja. Krejt tjetër. Ajo u ngrit, e falënderoi dhe doli jashtë duke lënë nga pas një psherëtimë të lehtë. Edhe ai u ngrit nëpër dhomë dhe, siç kishte bërë gjatë këtyre vjetve, lëvizti ngadalë në rrugën e ngushtë midis tavolinës, raftit, dollapit të madh me dosje dhe dy komodinave të mëdha të ngarkuara me libra dhe gjithfarësoj buletinesh e revistash pedagogjike. E kërkonin në telefon. E ngriti receptorin me qetësi.

— Arian, ti je?

Njohu zërin e shokut Asim.

— Po.

— U kthye babi nga Tirana?

— Erdhi mbrëmë.

— Ashtu! Desha ta takoja për atë muhabetin. Dëgjo, Arian. Mos u shqetëso fare. Janë mendime të disa njerëzve ato. Më kupton? Fantazira.

Dera kërciti me zhurmë. Brenda u zgjat një fytyrë e madhe, e kuqe, me një ngrysje të shtirur. Ariani i hodhi një shikim pyetës dhe vuri pëllëmbën në receptor.

— Mos ka qenë këtej ai bullafiqi i kastrës?

— Jo, — tha Ariani.

— Ku fshihet ai kodosh, xhanëm, — tha burri dhe u largua duke përplasur derën me zhurmë.

— Ari? — Zëri matanë ishte pyetës.

— Hyri dikush në zyrë, — u shfajësua Ariani me bezdi.

— Ashtu? Nejse. Ja kështu. Ti s'ke pse shqetësohesh fare. Raportin e ke. Megjithatë do të bisedoj me babin. — Pip, pip, pip. Ai e la telefonin i nervozuar. — Ari, ti je, xhan? Ishte një padurim sfilites si vapa e gushtit. — Ari, do një omëletë? Shoku Reshit do që të të lëvizë. Ah, ç'guxim i rrezikshëm për të! Ari!...

Pjesën tjetër të kohës u mor me përgatitjen e një raporti për përfundimin e semestrit të parë. Në orën 15.00, fiks zbriti shkallët. Bri tij zbriste shkallët edhe gruaaja me syzet e bardha, që punonte me Nikun, dhe fill pas saj

rregullisht zbriste një burrë i ri, me kokë të madhe, pak të përkulur, që ngjante si një kone e lidhur me zinxhir. Ah. Tahir, s'të vura re fare, i thoshte gruaja dhe largohej shpejt, me ca lëvizje lozonjare, tepër të shkathëta për tridhjetë e gjashtë vjetët e saj. Tahiri rrinte një grimë në mes të shkallëve, bluante me nervozizëm nofullat e mëdha dhe pastaj largohej befasisht i lumtur, sikur t'i kishin dhënë një bakshish. Ariani ecte për në shtëpi dhe për një kohë të gjatë nuk ndahej dot nga pamja e atij burri të ri, që kujtonte se miqësia me Neta Çaçin, që punonte në zyrën e Nikut, e kishte bërë papritur interesant dhe çapkën. Tavolina e priste, si gjithmonë, e shtruar.

* *
* *

Të nesërmen u nis për në punë me të njëjtën ndjenjë turbullimi dhe kënaqësie, si gjatë gjithë këtij muaji të shqetësuar. Shkoi përballë telefonit dhe ndenji në pritje, me vështrimin e lëbyrur nga reflekset e kasetës së bardhë të tij. Kaluan pesë minuta dhe ra zilja me një tingëllimë alarmuese.

— Alo?!

— Mirëmëngjesi... i dashur!

— Po kush jeni ju? Kush? Ta dija, të paktën.

Heshtja matanë telave shushurinte sikur të binte një vrundull i madh shiu mbi gjethishtë.

— E çfarë, sikur ta dije?

Ishte një përjashtim nga riti i përhershëm dhe tani zëri u duk disi ndryshe, si i hedhur nëpër erëra.

— Sikur ta dija? — pyeti ai i hutuar dhe priste më kot nga vetja që të thoshte diçka të qartë e të arsyeshme, diçka që të tingëllonte sadopak më e pazakontë se të gjitha ato që kishte menduar deri më sot.

— Dëgjoni! — Tani zëri i doli më i vendosur, po ndërkaq sinjali qe prerë.

Ndenji për një kohë të gjatë i heshtur, me vështrimin e ngulur mbi telefonin e bardhë, që rrinte në skaj të tavolinës, i mënjanuar, i heshtur, tinëzar e djallëzor, si një komplot kundër tij. U ngrit, i shkoi pranë, e mbështolli me duar, e shtrëngoi fort, sa kërciti, dhe ndjeu se u mbërthye nga një nervozizëm kryeneç si fëmijë. Vetëm ti e di, pëshpëriti, dhe në çast i erdhi për të qeshur nga ky naivitet. Pastaj mendoi se qe qetësuar, nxori një makinë llogaritëse dhe filloi të punonte. U mor për një kohë të gjatë me nxjerrjen e përqindjeve të kalimit dhe notat mesatare të semestrit të parë. Ishte një punë që e bënte çdo vit.

Ra zilja e telefonit.

— Alo, Ari, ti je?

— Po, mama.

— Dëgjo, xhan. Ka ardhur tezja. Mundohu të vish shpejt.

— Nuk vij dot.

— Si? Po çfarë ke kështu? Dukesh i lodhur.

— Nuk kam gjë. Thashë nuk vij dot shpejt se jam i zënë me punë. Dëgjon?

— Eh, mirë, — tha zëri i nënshtruar, — thashë se mund të vije. Tezen e ka marrë malli.

— Edhe mua më ka marrë malli.

Ai e la receptorin dhe doli të pyeste nëse kishte ardhur Niku.

— S'ka ardhur, — tha Neta Çaçi duke e shtyrë vështrimin e vrenjtur nga ai drejt derës, sikur ta ndiqte. Ai ndenji te dera gjysmë e hapur i përkulur sikur do të rrëzohej dhe e pa fytyrën e saj të bardhë për një kohë të gjatë me inat e guxim. Në çast ndjeu se vështrimi iu rëndua, bile iu bë i keq, po prapë nuk kishte forcë ta hiqte prej andej. Ne të dy, mendoj ai, vetëm ne të dy. Të gjithë lëvizin, shkojnë te njerëzit, kurse ne të dy jemi ngulur nëpër karrige, sikur na ka gozhduar njeri. Kemi siguruar ca raporte, edhe pse s'kemi vuajtur kurrë nga ndonjë sëmundje, e shikojmë njëri-tjetrin me inat (këtë nuk e shpjegon asnjëri prej nesh) dhe çdo ditë presim me padurim që të vejë ora 15.00.

— Ç'bën aty? — pyeti befas e habitur Neta Çaçi. — Pa shih! — tha pastaj, duke mbajtur me zor një buzëqeshje triumfi. Ariani e mbylli derën me vrull dhe u largua. Dhe kjo më duhej, tha duke hapur derën e zyrës i mërzhitur. Ç'bën kështu, o i marrë, i pëshpëriti vetes me gortim. Shkoi te karrigia e tij, u ul, mbështolli kokën me pëllëmbë dhe ndenji gjatë duke u menduar për atë mungesë ekuilibri që shfaqte herë pas here këto kohët e fundit në marrëdhëniet me njerëzit dhe për atë që

kishte filluar të gjykonte për vetveten si për një njeri tjetër të bezdisshëm.

Në orën 15.00 fiks zbriti shkallët dhe u nis për në shtëpi. Gjatë rrugës u mundua ta mbushte fytyrën me mall për tezen. U fut brenda, përballoi me stoicizëm mallin e vrullshëm dhe pak teatral të saj, pastaj vështrimin përherë të merakosur të nënës.

— Ari, shpirt, po pse je zbehur kështu? — Fytyra e gjerë e tezes, me një rrjetë të hollë rrudhash, u zverdh si për të imituar pamjen e tij. Nëna, në skajin tjetër, të dhomës, gati sa s'klithte nga dëshpërimi. Që t'i qetësoje ato, duhej një shpërthim të qeshuri, një pamje prej çapkëni të lumtur dhe dy krahe të fuqishëm, që ta rroknin tezen e brengosur prej beli dhe ta rrotullonin si fugë disa çaste nëpër dhomë. Pas kësaj nëna dhe tezja do të shkëmbenin ca vështrime të fshehta, domethënien e të cilave e dinin vetëm ato, dhe Ari do të dilte hëpërhë jashtë kujdesit të tyre të shqetësuar.

Babai do të vinte pak më vonë, do të hapte derën e korridorit, do të bënte zhurmë duke u zhveshur për të lajmëruar ardhjen e tij, do të kuptonte që kishte ardhur tezja, nga pellushi i zi në portmanto dhe do të thoshte, si zakonisht, me një zë solemn prej aktori: «Përshëndetje tezes sonë të shtrenjtë, që na zbururon shtëpinë»...

U ul në divan me duar të mbledhura në gjoks dhe buzëqeshi, «Mirëmëngjesi, i dashur...» Zëri vinte me vrull drejt tij, pastaj shtangte për një çast, thërmohej dhe e mbushte ajrin

përqark me një kumbim të nollë, tamam sikur të luante diku një piano e padukshme. Arqileja, i ati, erdhi pas pak, tha fjalët që kërkonte rasti dhe shkoi përballë tij me një pamje të qetë e mospërfillëse.

— Ari, si shkon me atë Reshitin?

Zëri i të atit e kapi në befasi dhe ai në çast ndjeu të turbullohej.

— Me përgjegjësin, — përsëriti Arqileja, — si shkon?

— Mirë shkoj.

— Ashtu?!

Vështrimi i të atit ishte i kujdesshëm dhe ironik. Nëna dhe tezja dëgjonin si të ngrira. Ky përkushtim i grave e bënte Arqilenë të merrte një pamje misterioze dhe stoike, si ajo e një njeriu që kërkon t'i mbajë të gjitha mbi vete.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti e para nëna e merakosur.

— Asgjë, asgjë, — tha Arqileja, duke e shtuar edhe më dozën e vetësakrifikimit, pastaj bëri disa hapa nëpër qilimin e trashë, duke tundur kokën, dhe ndali përballë saj buzagaz.

— Asgjë s'ka ndodhur. Ti nuk ke pse të shqetësohesh. Lërmi mua hallet. — Zëri i tij ishte përkëdhelës e i ngrohtë sikur qetësonte një fëmijë.

— Kam frikë mos kurdiset gjë për Arin.

— O, o, o, — qeshi Arqileja me zë të lartë, — kush do të guxojë ta bëjë një gjë të tillë sa të jem unë!

Nëna dhe tezja shkëmbyen prapë ato vë-

shtrimet e tyre të fshehta dhe Ariani e ndjeu se ato ishin të qetësuara tani tërësisht.

— (Baba, përse më pyete për marrëdhëniet e mia me shokun Reshit? — tha Ariani.

— Kot, — buzëqeshi i ati, — ja që më shkrepni një pyetje e tillë. Krejt kot.

Tezja e ndiqte bisedën e tyre me sy xixëllues.

— Unë mendoj se tani për Arin duhet menduar më seriozisht. — tha befas ajo, duke i hedhur së motrës një buzëqeshje dinake, — apo jo, Meli?!

Tjetra uli mbi tavolinë pjatat, fërkoi duart, i kryqëzoi në gjoks dhe e pa të shoqin me një pamje të trembur nga lumturia.

— Patjetër që duhet menduar më seriozisht, — tha Arqileja, duke i kthyer së shpejt një vështrim që ngjallte siguri.

Mita psherëtiu dhe filloi t'i vendoste pjatat mbi sofrabezen e bardhë të tavolinës.

— Ah, unë e shkreta, — belbëzoi.

Arqileja u ra gjunjëve me pëllëmbë duke qeshur.

— Ari, mamaja trembet për ty, — tha. — O çudi, po pse duhet të trembet ajo vazhdimisht? Unë këtë nuk mundem ta kuptoj dot. Përse? A kam lënë unë rast për një gjë të tillë?

Tezja ishte zgjatur në kolltuk dhe shikonte në drejtim të tij e hutuar dhe e merakosur. Arqileja kishte reshtur buzëqeshjen dhe kishte pamjen e një njeriu që pret të qortohet. Nëna shtrëngonte pirunët dhe thikat në gjoks. Të gjithë pritnin të fliste ai. Ah, të dashurit

e mi të tmerrshëm, mendoj Ari në çast dhe qeshi me vrull, në mënyrë të pazakontë, sikur të shikonte një skenë komike, me njerëz që s'kishin të bënin fare me të. Vazhdoi të qeshte po me të njëjtin vrull edhe atëherë kur i ati rrëzoi mbi sy vetullat e trasha dhe u ngrys nga zemërimi, kur tezja, e shtangur, lëvizi kokën e rëndë disa herë sa nga njëra anë në tjetrën e alarmuar dhe kur nëna lëshoi me zhurmë mbi tavolinë pirunët e thikat dhe i shtrëngoi duart në gjoks sikur të ndodhej përballë një llahtari. Pas pak ai e ndjeu veten të lodhur e nervoz. Muskujt e fytyrës i digjnin nga dhembja.

— Ç'ishte kjo? — pyeti i pari i ati i revoltuar.

Gratë rrinin të stepura, të mbledhura, të trembura, sikur porsa të kishin parë një fantazmë.

— Kot, — u shfajësua Ariani, — sesi më erdhi.

Argjilesë i ishin errur sytë nga zemërimi.

— Dëgjo, — tha ai me ton të rreptë, duke tundur gishtin tregues, — dëgjo, Ari: Një gjë e tillë nuk duhet të përsëritet kurrë. Morë vesh, kurrë!

Nëna u ul në karrige dhe filloi të lotonte ngadalë, me ngashërime të mbytura e të thella, kurse tezja qëndronte ende si e ngrirë dhe e shikonte Arianin me sy të çapëlyer, sikur do ta përpinte.

— Teze, qetësohu, të lutem!

E ulën në divan, i hodhën në fytyrë një grusht me ujë të ftohtë, i vunë nën kokë një

grumbull me jastëkë të bardhë dhe i mblo-
dhën të gjithë mbi krye duke i derdhur secili
për hesap të vet një rrëke me lutje e përgjë-
rime që e thërritnin të vinte në vete.

— Ah, Ari, — tha ajo më në fund dhe
u ngrit në brinjë, — unë të vdes më mirë,
të më mbulojë dheu një sahat e më parë, mua
qyqaren. Ja kështu. Të dëgjoj unë për Arin.
U shofsha unë!

— Qetësohu, Mita. Ç'dreqin po dëgjon ti
për Arin që bën kështu? — Arqileja kishte
vënë duart në bel dhe, teksa mundohej të
qetësonte teze Mitën, i hodhi të birit vështri-
me të kujdesshme, të trazuara me një qortim
të lehtë e të përmbajtur.

— Ari! Ti e mundon veten kot, — tha
duke iu afrua atij me druajtje. — Unë kam
biseduar me doktor Harrillën për një raport
të përhershëm dhe askush s'mund të të lëvizë
që andej. Dëgjon, Ari?

— Gjithnjë me raporte, baba.

— Si?

— Plasa, — belbëzoi Ari duke fërkuar ba-
llin me gishtërinj, — plasa.

Nëna ishte tërhequr në skajin e kuzhinës
dhe e ndiqte skenën me një pamje të alarmuar
e të trembur.

— Ari! Në fund të fundit ti duhet ta kup-
tosh që ne kujdesemi për ty, — tha Arqileja
duke e vështruar të birin me pikëllim, — të
gjitha janë të tuat, edhe shtëpia, edhe komo-
diteti që kemi siguruar, edhe fryma që marrim
është jotja. Pa më thuaj, ç'bëjmë ne më pak se
dy prindër? Thuaje!

— Ju bëni shumë, shumë, deri këtu, — tha Ari duke vënë pëllëmbën midis buzëve, — deri këtu, baba, — psherëtiu i lodhur. «Mirëmëngjesi, i dashur!» Zëri ishte gjithë po ai, veçse këtë radhë kishte një lloj alarmi të fshehur, të shpërndarë në mënyrë të kujdesshme e të përmbajtur në rrokëzimet e zgjatura të fjalëve; ishte një përpjekje lutëse për ta shkundur nga plogështia që e kishte kapur papritur dhe ai buzëqeshi duke parë me ngulm përballë sikur të donte të shquante në zbrazësi truporen e së panjohurës.

— Ah!

Ishte nëna e trembur. Ai e ktheu buzëqeshjen në drejtim të saj dhe u ngrit. Hodhi përçark një vështrim shfajësues, hapi derën e kuzhinës dhe doli në korridor. U vesh me ngut, dëgjoi me një heshtje torturuese emrin e tij të shqiptuar disa herë nga i ati dhe bëri të dilte jashtë. Pastaj u pendua në çast, u fut brenda, tha do të kthehem shpejt dhe doli me hapa të nxituar. Në rrugë lëviznin njerëz. Ai i shikonte me zili. Eci gjatë me duart ngjeshur në xhepa dhe me jakën ngritur lart, pa guxuar të mendonte asgjë, sikur ndiqte gjurmët e një sekreti që e ruante edhe nga vetja.

«Mirëmëngjesi, i dashur!»

Ai shtangu. Përballë tij vinte një vajzë e re, me flokët derdhur mbi supe shkujdesur. Ajo e shikonte në fytyrë me guxim dhe buzëqeshje lehtë. Ai ndali me një ndjenjë pasigurie turbulluese. Pas pak ndali edhe vajza.

— Mirëmëngjesi... — tha ai duke u menduar të dukej sa më i natyrshëm.

— Çfarë? — vajza kafshoi buzët për të mos qeshur nga ky mirëmëngjesi në orën 17.00. —

— Ik, mor çun, — tha pastaj me mospërfillje dhe u largua pa e kthyer kokën.

Ari ndenji në vend i mpirë e i fyer sikur ta kishin goditur me shuplakë. Ah, ç'bëj kështu, tha me vete, ç'bëj kështu?! Pastaj nisi sërish të lëvizte nëpër rrugën e mbushur me kalimtarë dhe dalëngadalë filloi t'i dukej vetja i kthjellët dhe i sigurt. Nga larg shquhej ende profili i vajzës së panjohur, që lëvizte e zhdukej mes turmës, dhe ai e shikonte me pamjen e një njeriu që kërkon të falur për diçka që kishte ndodhur krejt rastësisht dhe që nuk do të përsëritej më...

Në shtëpi u kthye vonë. Mendoi se të tjerët kishin fjetur dhe e hapi derën ngadalë, për të mos i shqetësuar. U fut në korridor, hoqi pardësynë, xhaketën, këpucët e, ndërsa ngrihej, i dolën përpara të tre me fytyra të ndrydhura nga alarmi.

— Ah, Ari! — klithi nëna.

— S'ka gjë, s'ka gjë, — tha Arqileja, — asgjë nuk ka ndodhur.

Tezja bluante gishtërinjtë me panik. Ari buzëqeshi me mirëkuptim, tha po shkoj të fle dhe u fut në dhomën e vet duke i lënë të gjithë të shtangur në korridorin e errët. Nga pas dëgjoi ankimin e nënës, klithmën e mbytur dhe teatrale të tezes dhe më në fund arsyetimet e pakundërshtueshme të të atit, që vendosën përfundimisht qetësinë. U shtri në krevat dhe në çast e zuri gjumi...

Të nesërmen shkoi në punë me kokën të rënduar dhe me humor të prishur. Zyra ishte

mbushur me dritë vezulluese, sikur të ishte e tëra prej qelqi. Ia qepi sytë kasketës së telefonit dhe iu duk sikur ajo dridhej si qenie e gjallë. Qëndroi ashtu për një kohë të gjatë, i bindur se nga çasti në çast do të dëgjonte sinjalin e përhershëm misterioz. Zilja ra me alarm. Ai e mori receptorin në dorë, e shtrëngoi fort sa i dhembën gishtërinjtë dhe e afroi pranë veshit...

— Mirëmëngjesi... i dashur!

Zëri i saj dilte dhe kthjellohej mes ca zhurmërash që ngjanin herë si përplasje ujërash në shkëmbinj dhe herë si gjëmim pylli në vjeshtë.

— Deri kur do të tallesh kështu ti? — Ai foli me ton të ashpër e kërcënues. Dridhej i terri nga nervozizmi.

— Me të vërtetë mendon se tallem? Nuk tallem, — tha ajo.

Zëri ishte i tillë, që i krijoi përfytyrimin e një njeriu të mbushur përplot me keqardhje të sinqertë dhe në të njëjtën kohë qe aq i dashur, aq i qartë e kumbues.

— Dëgjo... ti...

Sinjali u pre. Ai e përplasi receptorin në kasetë me inat. U ngrit, hapi dritaren dhe thithi ajër të ftohtë sa i therën mushkëritë. U kthye sërish pranë tavolinës, pa me një vështrim të përqëndruar dhe mosbesues kasetën e bardhë të telefonit dhe befas u drodh. Mendoi se gjatë gjithë kësaj kohe e kishte ndaluar jetën e vet te kjo kuti e ftohtë dhe te një zë që s'dihej nga vinte dhe në ishte i vërtetë, apo pjellë e imagjinatës së tij të lodhur. Gjatë tërë

paradites u hëngër me veten si me një kundërshtar kryeneç. Aty nga mesdita trokiti dera dhe hyri brenda shoku Asim. Nga mënyra si e shikonte, nga buzëqeshja e dhembshur në fytyrë dhe nga kujdesi i tepërt për të qenë i lirshëm, Ari e kuptoi se ai kishte biseduar me të atin.

— Po si je, o shoku Arian? Toke njëherë!

Ari e përshëndeti i qetë. I porsaardhuri iu afrua pranë, pastaj futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës, nxori një tufë me letra, kontrollloi për disa çaste, e gjeti atë që kërkonte më në fund dhe i zgjati një zarf ngjyrë blu.

— Ç'është ky?

— Raporti për ty. E siguroam më në fund.

Ariani e rrotulloi zarfin nëpër duar për disa çaste, pastaj nxori fletën e raportit dhe u mundua ta lexonte. Veç tre emrave të mjekëve, të shkruar në fund me makinë shkrimi, pjesa tjetër ishte e palexueshme, si pjesa dërrmuese e recetave dhe raporteve të botës.

— Nga se vuaj unë? — pyeti.

— Eh, ç'rëndësi ka, mo Ari, — tha shoku Asim me intimitet, — ta kesh, dreqin. T'i mbyllet goja paq atij Reshitit.

— Ta dija nga se vuaja, të paktën. Megjithatë falemnderit shumë!

— S'ka gjë, Ari, s'ka gjë. Unë s'lahem dot me Arqilenë. Ta dish sa kemi vuajtur për këtë raport.

Ai fliste dhe Ariani shikonte se si në gushën e tij me lëkurë poroze, molla e Adamit, e madhe sa një mollë e vërtetë, lëvizte poshtë

e lart me nervozizëm dhe e tendoste aq shumë lëkurën, sikur do ta çante nga çasti në çast dhe do t'i kërcente atij në fytyrë.

— Dhe dëgjo, Ari, — vazhdonte të fliste shoku Asim, — ç'të ka hipur ta trembësh ashtu tët atë? Ja ku ta them që s'duhet të sillesh më si djalë i keq.

Ariani dëgjonte i heshtur dhe ndihej krejt i mpirë e i shushatur, sikur të ishte mes një turme që e tallte në mënyrë të vrazhdë.

— Po përse më duhet mua ky raport? — pyeti befas.

— Si?! — Tjetri u tërhoq ngadalë, duke e parë me një vështrim përgjues e të frikësuar.

— Mua nuk më duhet ky raport dhe as që e kam kërkuar, — tha Ariani duke ia zgjatur tjetrit zarfin me dorën që i dridhej. — Urdhëroni dhe, ju lutem, më lini pa këto kujdesjet tuaja!

— Ari, ti po nxitohesh! — tha shoku Asim dhe doli jashtë me pamje të befasuar e të tronditur. Ariani zbriti shkallët fill pas tij. Ishte ende herët për të shkuar në shtëpi. U fut në njërën nga rrugët e qytetit.

Mirëmëngjesi, i dashur! Zëri i së panjohurës nuk po i ndahej për asnjë çast. I besonte atij zëri edhe në qoftë se ishte një mashtrim apo një thirrje e vetvetes. Ai zë kishte tamam kumbimin e një qielli mëngjesor të porsalindur, me dritë të bujshme dhe ajër të bollshëm e të kthjellët. Qe tamam kështu dhe ai dinte ç'të besonte në të...

Ç'TË BËJA?!

— Meli, të kërkon një prind.

Në çast dola në korridor dhe pashë të vinte drejt meje një burrë trupmadh, veshur me sqimë, po disi trashë për stinën. Prindi u afrova, më zgjati dorën duke u përkulur pak më tepër seç duhej, tha nuk di se ç'fjalë të ngatërruara në vend të përshëndetjes dhe pastaj filloi të më shikonte me dashamirësinë e një njeriu të prekur e të nënshtruar. Isha mësuar tashmë me pamje të tilla të shqetësuara prindërisht, por ajo që qe disi e pazakontë te burri që kisha përballë, ishte një merak tepër i madh e i pakontrolluar për pamjen e tij të përgjithshme dinjitoze që ai kishte hedhur në fytyrë.

— Jam prindi i Anila Panit, — tha pas pak, duke ruajtur të njëjtën shprehje të fytyrës si më parë. Ngurrova për një çast për të mënjanuar Anila Panin nga ai kontigjent Ani-

lash që na kishin ardhur sivjet në vitin e parë të shkollës së mesme dhe burri, që, si dukej, e kuptoi mëdyshjen time, gati u skandalizua.

— Jam prindi i Anila Panit, — tha, — nuk ju kujtohet?

— Posi s'më kujtohet, — thashë dhe më erdhi rëndë për atë frenim të çastit, — më kujtohet shumë mirë. Me nënën e Anilës kam biseduar dy-tri herë.

— Po, — tha burri. — keni biseduar.

Ishte një pushim midis orësh dhe korridorit gumëzhinte si zgjua bletësh nga zërat e të thirrurat e nxënësve që shkonin nëpër kabinetet e ndryshme.

— Anila ka qenë një fëmijë e jashtëzakonshme, — përsëriti.

— Vërtet, — thashë sa për t'u përshtatur disi në këtë vrull sentimentalizmi.

— Ajo ka qenë një nxënëse e shkëlqyer në tetëvjeçare. Ja, mendoni dhe vetë, në provimet e fundit e ruajtën për ta dëgjuar i dërguari i Ministrisë së Arsimit. Kurse këtu, këta dy muaj ka marrë vetëm shtata dhe teta. Për ne është e pamundur të pajtohemi me këtë gjendje.

Zhurma në korridor nuk qe reshtur ende dhe ai fliste me zë të lartë, duke u rënduar fjalëve me një theks solemn e poetik.

— Shkojmë në një klasë, — propozova, — unë jam e lirë këtë orë. — Ai vinte nga pas duke marrë frymë me zor. Nuk duhej të qe më shumë se 45 vjeç, megjithatë në këto çaste, i ngrysur nga ca rrudha të thella, që i çanin ballin mes për mes, dukej i ligështuar, si një i sëmurë që porsa ishte ngritur nga shtrati. U

ula në një bankë. Ai ktheu një tjetër dhe ndenji përballë meje, në pritje për të më dëgjuar.

— Anila, — thashë unë, — në tetëvjeçare mund të ketë qenë ashtu siç thatë ju...

— O, mos dyshoni për këtë, — më ndërpreu ai.

— Edhe mësuesit e tjerë, që i japin mësim, — vazhdova, — edhe unë, kemi mendimin se ka ardhur me disa dobësi që ndoshta janë kalimtare, apo ndoshta s'janë për fajin e saj, po sidoqoftë janë dobësi.

Ai në fillim po më dëgjonte i përqendruar, me një vështrim zhbirues e të rreptë, që ma vështirësonte komunikimin, pastaj befas vëmendja e tij u shkatërrua nga një mendim që i lindi papritur, tha më fal i merakosur në kulm, hapi palët e xhakëtës dhe filloi të kontrollonte xhepat i preokupuar.

— Kam harruar stilografin në shtëpi, — tha i dëshpëruar, sikur të lajmëronte një gjëmë. Pas pak nxori një bllok të vogël ngjyrë gri, e la mbi syprinën e bankës e gjithë i merakosur e i tensionuar vazhdonte të kontrollonte xhepat.

— Ta marrë dreqi! Mos keni diçka për të shkruar?

I zgjata një stilolaps. Ai e mori, e provoi disa herë në punonte, pastaj hapi bllokun dhe m'i qepi sytë përsëri me vëmendje.

— Desha t'ju thosha se Anila është dhe ca kokëfortë.

Teksa unë flisja, ai filloi të shkruante duke belbëzuar: «Është ca kokëfortë», po.

— Herë-herë është e papërqendruar në mësim.

— Ashtu? — pyeti ai me mosbesim dhe i shkroi përsëri fjalët e mia, duke i rrokëzuar me të tundura të kokës.

— Po nuk është nevoja që t'i shkruani të gjitha këto, — vëreja.

— Jo, jo, s'ka gjë, — tha ai. — Unë mbaj shënim çdo gjë që thuhet për Anilën, veçanërisht nga mësuesit. Me to kontrolloj dhe vajzën dhe veten. Kjo është diçka personale, stili im familjar, si të thuash. Vetëm desha t'ju thosha se ju jeni e para që mendoni se Anila ime është kokëfortë.

— Po ky s'është vetëm mendimi im, — thashë dhe u mata të jepja sqarime të mëtejshme.

— Më falni, ju lutem, — më ndërpreu me një lëvizje të vrullshme të dorës, uli kokën dhe filloi të shkruante duke i belbëzuar fjalët në mënyrë shumë komike: «Mësuesja kujdestare ngul këmbë dhe thotë se Anila është kokëfortë.» — Urdhëroni, — tha pas kësaj. Pra unë duhej të flisja, që ai të shkruante fjalët e mia duke i belbëzuar me atë rrokëzimin e tmerrshëm e të mbytur si të një njeriu që ia shtrëngojnë hundën me gishtërinj.

— Kështu ne s'do të merremi dot vesh, — thashë e nervozuar. Kjo ishte një revoltë që në të vërtetë lindi nga shtrëngimi për të mos shpërthyer në gaz. Sa herë që e përfytyroja këtë skenë si duke u parë nga kolegët e mi, më mbërthente një dallgë të qeshuri që më gërrye-

nte gjoksin. Ishte një torturë e vërtetë ajo që bëja për ta përballuar.

— Po juve s'ka pse t'ju vijë rëndë që dua të shënoj të gjitha mendimet që keni për Nilen. Unë, për veten time, në këtë veprim nuk shoh asgjë që të tërheq vëmendjen. Pa mendoni. Për vajzën kam shënime të hollësishme që kur ajo ishte ende fëmijë e belbëzonte. T'i ndërpres ato, më duket se i bëj një dhunim kujdesit tim prej prindi, aq më tepër tani, që më duhet ta ndërtoj gjithçka nga e para. Anila ime merr shtata e teta, është kokëfortë dhe e pavëmendshme, po kjo është e tmerrshme. Më falni, — tha pastaj duke më parë me vështrim qortues dhe prapë shënoi diçka në bllok, — më falni.

— Po unë s'desha t'ju fyeja, — thashë duke u munduar të shqitja nga fytyra buzëqeshjen, — por, po të vazhdojmë kështu, do të vejë gjatë kjo punë dhe prapë s'do të merremi vesh. Le të flasim pa shënime, pastaj ju, po të doni, i shkruani ca gjëra më vonë.

— Mirë, — tha ai më në fund me nënshtrimin e njeriut që është i detyruar të bindet për mirësjellje, — mirë, po i lëmë shënimet, se, ku ta dish, mund të jenë edhe shfaqje burokracie.

— S'është puna aty, po diskutojmë lirshëm pa to.

Ai më dha stilolapsin, futi bllokun në xhepin e xhaketes, u kopsit me vrull, kryqëzoi duart dhe tha: «hë, po ju dëgjoj,» duke nxjerrë gjoksin para meje si para furtunës. Ç'më gjeti, thashë. Nxora nga çanta fletoren e shënimeve

t'i komunikojta notat që kishte marrë e bija në çdo lëndë.

— Më falni, — tha, — pak stilolapsin.

Nxori bllokun, e hapi në një faqe të bardhë dhe shkroi në krye me një shkrim të madh e të qartë: «Notat e Anilës deri më 11 nëntor, sipas shënimeve të shoqes Meli, mësueses së saj kujdestare.»

— Urdhëroni!

— Letërsi: shtatë.

— Si? — Ai u hodh përpjetë sikur ta kisha qëlluar me pëllëmbë. — Shtatë dhe në letërsi? Ky është kulmi. Nila, me ato hartimet e saj të mrekullueshme, ka marrë shtatë?! Unë s'kam dëgjuar gjë më absurde sesa ky vlerësim, — tha me një pamje pothuajse të ngashëryer.

— Ju bisedoni edhe vetë me mësuesin e letërsisë.

— Patjetër që do të bisedoj, patjetër.

Prita sa e mblodhi veten dhe vazhdova e druajtur:

— Gjuhë e huaj: tetë, shtatë.

Goditja që e pamëshirshme. Ai u ngrit në këmbë dhe po më shikonte me një vështrim të mjegulluar e të trembur, sikur unë të isha këmbyer papritur me një çudi të pangjarë. Lëvizat në bankë, u kolla, buzëqesha dhe bëra gjithfarësoj gjestesh për t'ia bërë gjendjen sa më reale.

— Shoqja Meli, ju lutem, ma thoni sinqerisht, edhe ju mendoni se Anila ime është nxënëse e shtatave? — Ai lutej dhe ishte e pamundur ta pajtoje me ato që dëgjonte. Të bëja

një kompromis me shqetësimin e tij, ishte, hëpërhë, jashtë të gjitha mundësive.

— Sikur të thërritnim dhe vajzën këtu? — thashë pa iu përgjigjur pyetjes së tij.

— Si të doni, — m'u përgjigj duke u ulur.

Megjithëse ajo ndodhej në mësim dhe drejtori ynë i rreptë na kishte tërhequr disa herë vëmendjen për raste të tilla, unë shkova dhe e mora pa ngurruar. Vajza u ndal kokulur dhe e turpëruar para të atit. Ishte e brishtë, delikate, me një fytyrë të bukur e plot dritë, si të veshur me xham. Unë fillova të flisja. Kisha përshtypjen se nuk më dëgjonte asnjëri prej tyre. Vajza rrinte kokulur, gërvishte dërrasën e bankës me gishtërinj dhe psherëtinte, kurse i ati rrinte ballë saj, me vështrimin e shtangur të atyre që shohin një tabu të cenuar. Befas vajza nisi të qante. I ati, i zverdhur krejt në fytyrë, u afrua edhe më pranë saj dhe unë pashë në fytyrën e tij të madhe e eshtërore të rrokullisej një lot sa një kokërr breshër.

— Ju lutem, — thashë, — ju lutem, ç'bëni kështu?

Ai ngriti kokën dhe më pa në mënyrë të përvuajtur, pastaj e shtrëngoi sërish të bijën në gjoks dhe filloi t'i belbëzonte ca gjysma fjalësh të pakuptueshme, në një zhargon prindëror krejt të veçantë.

— Mua m'i bëjnë të gjitha pyetjet e vështira mësuesit, vetëm mua. Edhe mësuesi i fizkulturës vjen te ne vetëm e vetëm që të më bëjë mua pyetje të vështira. — Akuza kishte shkuar tepër larg, dhe unë gati sa s'qesha kur dëgjova këto fjalë që u thanë për të gjorin

mësues të fizkulturës. Goditja ishte në shenjë. Për pyetje të vështira shko deri tek ai dhe kthehu mrapsh.

— Qetësohu, Anila!

Pas kësaj, i ati fshiu lotët me kurrizin e dorës, më buzëqeshi si fajtor dhe u bë në çast dinjitoz. Gjithë me këtë dinjitet i lëmoi kokën vajzës, e largoi nga vetja, më kërkoi të falur, për skenën sentimentale që qe krijuar dhe u ul.

Përsëri blloku dhe përsëri ca vetëtima pakënaqësie nëpër sy. Isha përballë një rasti të vështirë. Atë e bijë shkëmbenin ca vështrime të shpejta me njëri-tjetrin. Tani vajza qe qetësuar dhe fytyra e saj kishte marrë një pamje urdhëruese.

— Ju lutem, ma jepni pak stilolapsin, — tha burri.

Qëndrova një çast në mëdyshje. Ç'të bëja?

— Pak stilolapsin tuaj, — përsëriti ai me mirësjellje, po këmbëngulës.

U tremba kur mendova se gjithçka do të fillonte nga e para. Qëndroja kokulur, e lodhur. Ndieja se kisha nevojë për dhembshuri. E mora stilolapsin nga çanta dhe fillova ta rrotulloja për një kohë të gjatë nëpër gishtërinj, pa pasur forcë të bëja ndonjë veprim të mëtejshëm. Burri u ngrit nga vendi ku rrinte dhe erdhi pranë meje.

— Ç'keni? — pyeti me zë të merakosur.

— Nuk ndihem mirë, — thashë duke dalë përbri tij. — Më falni! E lëmë për një herë tjetër bisedën tonë?

— T'ju ndihmoj? — tha kur pa që po lëvizja me mundim.

— Jo, s'është nevoja, — kundërshtova. — Mirupafshim!

— Mirupafshim, — belbëzoi ai, i habitur, pas meje, — dhe të më falni. Do të më duhet të vij një herë tjetër. Dua të bisedoj gjatë. Më kuptoni?

— Po, — thashë, — ju kuptoj.

— Ah, diçka, ju lutem, — tha ai kur që larguar disi. Distancën që na ndante, e bëri me hapa të shpejtë dhe gati sa s'u përplasëm.

— Dëgjoni, — tha me një vështrim të ngrysur e hulumtues, — gjithmonë më mundon ideja se nuk kam bërë atë që duhet për time bijë. Ndaj ngulmoj që të arrij atë cak që përbën kulmin e harmonisë pedagogjike në marrëdhëniet midis prindit dhe fëmijës. Nuk di në jam i qartë.

— Po, — belbëzova e lodhur, — unë tani po filloj t'ju kuptoj shumë mirë.

Atij i ndriti fytyra aq fort e habitshëm, sikur sytë t'i kishte dy llambushka të ndezura. Vajza u afrua ngadalë, mori dorën e të atit dhe e hodhi pas krahëve. Ky gjest ishte aq mallëngjyes, sa e bëri burrin të mekej në çast.

— Veçse ta dini, — tha me zërin e këputur nga emocionet, — ta dini se me Anilën po ndodh një keqkuptim i madh. Aq i madh, saqë disa nesër mund të pendohen rëndë. S'ju kam ndër mend vetëm ju kur flas kështu.

Ika dhe nuk e di pse më erdhi ndër mend një rast nga jeta ime prej mësueseje këtu e mbi pesëmbëdhjetë vjet më parë. Atëherë na vinte në

shkollë një plak i ngrysur, i rëndë, rreth dy metra i gjatë, me të birin e trembur për dore. Djali nuk vente mirë me mësime. Plaku hynte në sallë pa përshëndetur njeri, më bënte shenjë me një gisht të gjatë si shkop t'i afrohesha dhe më pyeste me ngut e kërcënim: «Hë, po përparon ky mistreci im?» dhe, pa më lënë kohë t'i përgjigjesha, më tregonte se si një natë më parë e kishte rrahur paq me rripin e mesit, e kishte lënë pa ngrënë dhe e kishte futur në banjë për diçka orë. Fëmija dëgjonte kokulur, i tulatur, i trembur dhe më hidhte herë pas here vështrime që më luteshin për ndihmë. Atëherë më kujtohet që kaloja net të tëra duke klithur nga dhembja: ç'të bëj, ç'të bëj...

Shkova në shtëpi dhe pothuajse tërë natën nuk m'u hoq nga mendja fytyra e plakut të ngrysur me të birin e trembur për dore. Dhe nuk e di pse pastaj ajo pamje që më trembte vinte dhe këmbehej papritur me fytyrën e vagëlluar të burrit të sjellshëm dinjitoz... dhe të bezdisshëm. Shihja si ai vinte prapë në shkollë dhe më kërkonte, nxirrte bllokun dhe mbante shënim çdo gjë që thosha unë, dëneste duke shtrënguar në krah të bijën dhe pastaj derdhte një lumë argumentesh për keqkuptimin e tmerrshëm. Atëherë mua më dilte nga gjoksi, si një jehonë e largët, pyetja «ç'të bëj, ç'të bëj»

Kur u zgjova, isha e mbytur në djersë.

J E T Ë

Në tren dhe në vagon, si rrallëherë, kishte pak njerëz. Ata të dy, burrë e grua mbi të gjashtëdhjetat, rrinin përballë njëri-tjetrit, të heshtur, në një ndenjësë katërvendëshe. Shkonin në Tiranë, te vajza. Burri kishte veshur një kostum të ri ngjyrë gri, jelek e kapelë me strehë po prej copës së kostumit dhe kështu dukej hijerëndë, kurse gruaja ishte veshur më thjesht, me një fustan të errët basme dhe një triko akriliku. Duhej të ishin marrë me punë krahu, të paktën burri. Kjo dukej nga pëllëmbët e tij të mëdha e të ashpra si fletë fiku që mbulonin gjithë syprinën e tavolinës, nga të gërvishturat në gishtërinj dhe nga muskujt që i hovnin në krahë dhe në gjoks. Pinte duhan dhe shikonte nga dritarja i çinteresuar.

— S'u lodhe me këtë të shkretë duhan,
— tha gruaja e pakënaqur, — le veten, po na e bëre dhe neve barkun si oxhak.

— Ohu, — bëri burri i bezdisur, — gjithnjë një avazi ti.

— Këto të miat s'të pëlqejnë ty. Vetëm mendja jote të pëlqen. Të duket vetja profit.

— Ashtu më duket, po lërna rehat tani.

Gruaja u tërhoq disi mënjane me gjestin e njeriut të fyer, po burri nuk e vuri re. Ajo vazhdoi ta shikonte për një kohë të gjatë me bisht të syrit, me njëfarë nënqeshjeje të hollë, tinëzare në buzë, kurse ai vetëm pinte duhan dhe shikonte më nge pamjet që hapeshin nga dritarja e trenit. Gruaja u afrua prapë e pakënaqur.

— Po, mbrëmë, ç'qenë ato fjalë që i the djalit? — tha ajo e vrenjtur, — vetëm fjalë të sërta di të thuash. Ua bën haram çdo gjë. Punë e madhe se erdhi ca vonë. Tani janë burra.

— Jo po do ta lë të bëhet birbo. Ou. Të kisha mendjen tënde unë, do të venim natë për natë t'i kërkonim fëmijët në polici.

— Ashtu? — gruas i vetëtinë sytë nga marazi.

— Ashtu që ç'ke me të, — tha burri me ton të qetë.

— Ti tërë jetën kështu ke qenë, — tha gruaja duke u afruar edhe më, — ku e ku t'i përbuzësh të tjerët. Po pse të mos bësh. Ke gjetur mua shushkën.

— Zure prapë nga ankimet!

— E kur të kanë pëlqyer ty fjalët e mia që të të pëlqejnë sot? Unë prisha fëmijët, unë i vura kazmën shtëpisë, unë të gjitha të ligat.

Ç'të të bëj. Kur s'të ra në pjesë ndonjë pipiruçe, dhe flisje pastaj.

— Të kisha një si veten, do të isha si unë,
— tha burri.

— Ashtu? — gruas prapë i vetëtinë sytë nga marazi, — pse s'more një tjetër, kush të ndaloi? Unë të thashë të më qepeshe pas si rrodhe? Kishte fshati një bylyk me vajza. Të kishe marrë një tjetër. Hë, fol, pse s'flet?.

— Atëherë kam qenë budalla i madh, — tha burri dhe mbuloi fytyrën me pëllëmbë.

— Budalla i madh, ë? Se më more mua, kështu? — tha ajo.

— Ç'të ka gjetur sot xhanëm? Lërna rehat. Oi!

— Vetë i hap muhabetet, pastaj e kam fajin unë. Pse je bërë kështu? Dhe mos e fut krahun aty se do të ta presë xhami.

— Nuk ma pret.

— Po pse të mos e heqësh, xhanëm? Edhe për të mirën tënde je kokëfortë?!

— Ja, e hoqa. Tjetër ç'ke?

— S'kam gjë.

Gruaja u tërhoq përsëri mënjanë. Burri mbështeti kokën në bërryl dhe ua qepi sytë hapësirave i menduar.

— Sa do të rrimë te vajza?

— Tri ditë, e thamë një herë.

— Tri ditë? Po pse, në botë vemi?

— Unë mërzitem. S'rri dot më shumë.

— Po pse, ç'të duash ti do të bëjmë gjithmonë?

— Ti rri sa të duash. Ç'ke me mua?

Gruaja u nxeh.

— Si s'fole një herë mbarit, — tha, — po fajin e kam unë, që vij me ty.

— Mos vije, s'të detyroi njeri.

— Ashtu?!

— Ashtu që ç'ke me të.

Burri hoqi kapelën nga koka, shtriu flokët e rrallë me gishtërinj, pa për një çast të shoqen me pakënaqësi, pastaj hodhi sërish vështrimin nga dritarja.

— Të kishim marrë edhe një kile tjetër raki, — tha gruaja, — do t'i bëhej qejfi kru-shkut.

— E po s'kemi fabrikat e rrushit në shtë-pi.

— Se mos harron të flasësh pa romuze, se bëhet kataklizmoja.

— Ashtu jam unë.

—, Ashtu je, po s'të duron njeri.

Gruaja po e shikonte me bisht të syrit.

— Po të duan të më durojnë.

— Ashtu? Po atë dorë, pse e vë nën xham? Për inatin tim e vë?

— S'e kisha mendjen, — tha ai me një pamje prej fajtori dhe e hoqi dorën në çast.

Gruaja buzëqeshi me vete.

— Po në Elbasan, te Dashi, do të vemi?

— Vemi.

— Kur?

— Kur të duash ti.

— Që kur u paske lënë kaq fre këtyre dë-shirave të mia?

— Ou!

— Mos u mërzit, mos u mërzit!

— Ç'të mos mërzitem, — tha burri duke nde-

zur cigaren, — gjithnjë e pakënaqur je. Sikur gjithë dynjanë të të falin, prapë do të rrudhje buzët e do të grindeshe. S'di nga t'ia mbajë njeriu i shkretë me ty.

— E, kështu jam unë.

— Ti je, po unë ç'kukur kam.

— Pse, kaq shumë ke vuajtur zotrote me mua?

— Dhe kam vuajtur.

Në Durrës burri kërkoi të zbriste në stacion. Do të blinte një paketë cigare.

— Shko, po mos u vono, siç bën gjithnjë.

— Mirë, mirë, — tha ai me ton paqësor.

Doli. Në fillim gruaja bëri sikur nuk e vuri re, por, kur ai u largua disi, ajo u var në dritaren e trenit dhe e ndoqi me sy për një kohë të gjatë. Kaluan disa minuta. Befas, disa metra larg dritares së tyre, u mblodh një grumbull i madh njerëzish. Turma sa vinte e zmadhohej. Konduktorja e vagonit vrapoi te dera. Gruaja u ngrit nga vendi e alarmuar.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti.

— U rrëzua një plak, — tha dikush në vrap e sipër.

— Kush? — belbëzoi gruaja dhe u mek. Fytyra i përcelloi nga dhembja sikur t'ia kishin fshikur me kamxhik. Merrte frymë me zor e ngashëryer. Ecte dhe këmbët i ndiente të rënda si trarë. Lot të trashë ia errën vështrimin në cast. Ai është, mendoj, ai. Ç'më gjeti! Buzët iu thanë sikur të kishte një jetë të tërë pa pirë ujë. Doli me mundim te shkallët e vagonit, duke u mbajtur nëpër hekura verbërisht. Njerëzit po shpërndareshin. Plakun e mbanin për krahësh

dy veta. Ecte ngadalë, i kërrusur. Ajo ndjeu në çast lehtësim. Të paktën qe gjallë. Fshiu sytë, bëri dhe disa hapa përpara dhe buzëqeshi e mallëngjyer. Bah, ç'qe kështu! Fërkoi sytë me kurrizin e dorës. Por ai s'qe burri i saj. Vazhdoi të rrinte te shkallët si e magjepsur. Ja, ai u duk larg. I madh, i fuqishëm, çante rrugën me siguri. Gruaja ngjiti shkallët e vagonit dhe vajti u ul në vendin e vet. Pas pak ai u fut brenda i qetë, vuri sendet e blera në tavolinë dhe u shtri në kolltuk duke hapur krahët.

— Ç'njerëz që kishte! — tha.

— Kishte shumë?

— Plot. Na, mora ca byrekë me djathë.

— Byrekë me djathë? Të lumshin duart! Po duhan për vete more?

— Mora.

— Ku e ke?

— Ja!

Ajo u përkul dhe ngriti një çantë lart, nxori diçka të mbështjellë me gazetë dhe e vuri përpara të shoqit.

— Na, ha se të ka marrë uria.

— Të ha, thua?

— Pse të mos hash.

Ai filloi të hante. Ajo u tërhoq mënjanë, u mblodh në qoshen e ndenjësës dhe po e shikonte me ca sy që i xixëllonin si thëngjij. Në gjoks dhe në të gjithë trupin ndiente një mundim që po ia merrte frymën, po që ajo donte të zgjaste e të zgjaste deri në pambarim.

— Ç'ke kështu? — pyeti burri i shqetësuar.

— Asgjë, — tha ajo duke i buzëqeshur, — do dhe ca?

— Ku ta fut? Ha dhe ti.

— Do të ha dhe unë.

Burri u ngrit, zhveshi xhaketën, e vari e, duke fishkëlyyer lehtë, u rehatua në vend dhe i hodhi sytë jashtë. Ndenjën për një kohë të gjatë pa folur. Ai i hodhi vështrime të shpejta së shoqes që hante e menduar dhe befasi u zymtua. U kthye në drejtim të saj, hoqi kapelën, e vuri mbi gjunjë dhe filloi t'i binte tavolinës me gishtërinj.

— Mirë the ti, të kishim marrë dhe një shishe raki, — tha pa e ngritur kokën.

— Ou! S'ka gjë. Do të vemi prapë.

— E po mirë, — tha buzagaz ai.

Gruaja mbaroi së ngrëni, i mbështolli me gazetë ato që mbetën i vuri në çantë dhe ndenji për një kohë të gjatë me duar të kryqëzuara në gjoks.

— Shiko, — tha pas pak, — mirë thua ti, dy-tri ditë rrimë në Elbasan, sa të çmallemi me fëmijët, pastaj u themi të na vijmë nga behari në shtëpi. Mirë them?

— Ashtu e bëjmë...

UNAZA

Ishte fillim shtatori dhe në atë hotel bregdetar çifti i ri, i veshur me pantallona të bardha e bluza të stampuara në gjoks, tërhoqi vëmendjen e të gjithëve qysh në fillim. Ishin të por-samartuar. Nuk kishte si të mos të binte në sy melankonia e pakuptueshme e vajzës, një druajtje e përgjithshme e saj deri edhe te mënyra e të ecurit mbi qilimin e trashë të hollit dhe më në fund kujdesi i guximshëm e i bujshëm i burrit të ri, pyetjet dhe ecejaket e pafund të të cilit në bufe, kuzhinë e në dhomë e mbyllnin vajzën me një rreth enigmatik. Ajo ishte tepër e re dhe shumë e bukur. Me fytyrën e bardhë e disi të hequr, ku vareshin shpesh një krah flokësh të zez, me trupin e derdhur e me hapat e kursyer e të trembur, sikur të ecte mbi xham ajo u shkaktonte të gjithëve një ndjenjë përgjimi dhe ndrydhjeje të pakuptueshme. Edhe i

shoqi ishte simpatik, megjithëse ndoshta dhjetë vjet më i madh se ajo. Kishte trup të drejtë, muskuloz, me lëvizje prej atleti, dhe një pamje aq të hareshme e të lirshme, saqë për një kohë të shkurtër u bë beniamini i tërë personelit e veçanërisht i kamerierëve...

Po dilnim me Petron për t'u larë në det. Njëri nga kamerierët që na shërbente, rrinte në kolltukët e hollit me një kitarë në dorë. Shkuam drejt tij duke qeshur.

— Hej, Miço, — foli Petroja, — po kjo kitarë? Apo është në stilin e hotelit që të na përcillni në det me këngë?

Kamerieri na ftoi të uleshim.

— Është kitara e atij shitësit, — tha pastaj duke qeshur. Sytë i shkrepën me dinakëri. — E, ore, kitara e shitësit, ç'ka për t'u habitur?

Ne në të vërtetë s'po shfaqnim ndonjë she-një habie, po sidoqoftë ai donte të na intrigonte.

— Ç'qenka ky shitës me kitarë? — pyetëm.

— Shët, se po vjen.

Nga shkallët e katit të parë zbriste çifti me bluzat e stampuara në gjoks. Vajza ecte, si gjithmonë, me kokën ulur, e brishtë dhe e imët si një gjimnaziste e viteve të para, kurse burri i ri bënte lëvizje të shkathëta, e ndalte atë në çdonjëren shkallë, lëshonte një mori pyetjesh që s'merrnin përgjigje dhe pastaj qeshte duke tundur kokën. Kur u afruan, kamerieri u zgjati kitarën dhe i njohu me ne. Burri i ri e pranoi në mënyrë të lirshme shoqërinë tonë, tha se emrin e Petros e kishte dëgjuar, bile kishte parë në Ekspozitën e fundit Kombëtare disa portrete të tij që i kishin mbetur në mendje. Petroja

ishte tepër i urtë e i sjellshëm për të thënë se në ekspozitën e fundit kishte marrë pjesë vetëm me një peizazh, dhe kjo më shërbeu edhe mua si mësim për të heshtur kur ai mburri si timen dramën e suksesshme të një autori të vdekur. Dhe sikur të mos e kishte korrigjuar e shoqja, me një turp që i skuqi fytyrën, ndoshta ai tërë jetën do të kishte kujtuar se atë vepër të paharruar e kisha shkruar unë. Sidoqoftë ai e kaloi shumë lehtë këtë keqkuptim të vogël dhe pas kësaj njohjeje intime na ftoi të laheshim së bashku, në rast se s'kishim kundërshtim.

Zbritnim për në det të katër dhe ndërkaq dëgjonim historinë komike të një të huaji dhe të qenit të tij skandaloz. Historia ishte me të papritura të këndshme dhe të pabesueshme, megjithatë ne e dëgjonim me ëndje dhe qeshnim. Ajo ngrinte herë pas here kokën, shihte përshtypjen që linte te ne rrëfimi i të shoqit dhe buzëqeshte lehtë...

— Hë? — pyeti më në fund burri i ri. — Si ju duket?

— Histori e lezetshme, — thamë ne gati me një gojë dhe qeshëm për atë përputhje të habitshme fjalësh hipokrite.

— Hë pra, — u kënaq burri i ri, — kurse kësaj, — tha duke treguar të shoqen, — s'i bën përshtypje asgjë. Edhe njeriu më ogurzi do të shkulej së qeshuri me atë ngjarjen në ashensor. Ai u kthye i tëri nga ne dhe unë vura re i habitur se sytë e tij kishin ngjyra të ndryshme: njëri ishte blu i thellë dhe i ndritshëm si një diamant, kurse tjetri ishte jeshil, më i qetë dhe disi më i vogël. E megjithatë pamja e

tij ishte simpatike, madje edhe pak misterioze.

— Ditën që erdhëm këtu, shkuam dhe u hodhëm në det, — nisi të tregonte ai. — Kësaj i ra unaza në ujë dhe shih si është bërë.

— Lëre tani atë punë, Gimi, — tha gruaja e re dhe buzëqeshi me një dhembje të lehtë.

— Në ç'vend ju ra unaza? — pyeta i intriguar.

— Aty, — tregoi me dorë burri i ri, — pesë-gjashtë metra larg bregut. Apo jo, Ada?

Ajo miratoi me bezdi.

— Pritni, — tha befas Petroja. — Ky, — vazhdoi duke më kapur nga supi, — mund të rrijë nën ujë më shumë se një minutë.

— Vërtet? — pyeti i mrekulluar burri i ri.

— Posi, — thashë me ngut dhe në çast u skuqa nga ai pohim aq pompoz që bëra.

— Mund të rrish më shumë se një minutë?

— Ëhë!

Gruaja e re shpërndau në fytyrën e bardhë e të trishtuar një buzëqeshje të lehtë mosbesimi.

— E provojmë njëherë? — pyeti burri i ri duke kërkuar edhe mendimin e së shoqes.

— Eh, Gimi! — Bezia në pamjen e saj qe e kujdesshme.

— Si thua, — pyeti burri i ri, — apo e ke të vështirë?

— E pse? — thashë. — Që tani mund të shkojmë.

— Vërtet? — Ai kishte një pamje tejet të lumtur. — Ada, si thua ti?

Ajo buzëqeshi duke ngritur lehtë supet, vuri syzet e diellit me një lëvizje nervoze dhe heshti.

Në pamjen e saj se ç'kishte një si habi dhe hutim bashkë, një plogështi të vagëlluar sikur të ecte mes kufijve të papërcaktuar të ëndrrës dhe realitetit. Bregu po mbushej dalëngadalë me njerëz, shumica çifte të reja. Ne u afruam te ca shkëmbinj bojë plumbi, porozë si sfungjerë, shtruam batanijet dhe hoqëm rrobat e paka që kishim në trup. Gimi tregoi vendin ku kishte rënë unaza dhe ne qëndruam për një kohë të gjatë duke parë të sugjestionuar luspata që krijoheshin nga rrudhjet e ujit.

— A je gati? — pyeti Gimi. Ada hoqi syzet e diellit dhe më pa për një çast me ca sy që sikur kërkonin të më fajësonin për diçka. Ishte një vështrim që nuk të lejonte mirëkuptim dhe prapë që i trishtuar e i patëkeq. Unë po e shikoja me vëmendje dhe çuditësha njëherësh me sjelljen e saj të ftohtë ndaj meje, që kërkoja të bëja diçka për ta dhe me veten që nuk po fyhesha. Edhe Petroja nuk kishte më atë entuziazmin e parë. Rrinte me duar në bel dhe shikonte me mosbesim. Në këtë çast më dukej sikur shoku im dhe gruaja e re, pavarësisht se s'njiheshin, ishin lidhur me fijet e një komploti të padukshëm kundër meje dhe shitësit, që nga ana e tij ishte shumë entuziast dhe optimist.

— Peshkatar i perlave, — tha Petroja, — kaq i sigurt je se mund ta gjesh atë unazë?

— Në rast se ka rënë në një vend kaq të afërt dhe të përcaktuar, s'kam përse të mos e gjej.

— Po sikur ta ketë gjetur dikush para teje?

— Kjo është tjetër punë, — thashë duke parë nga Gimi.

— Jo, — tha ai, — askush nuk e di vendin ku ra unaza. Vetëm unë kam kontrolluar, po s'mund të rri më shumë se njëzet sekonda nën ujë. Apo jo, Ada?

Ajo prapë ngriti supet.

— Shkojmë, — thashë.

Petroja u ngrit i pari duke lëshuar përreth shtëllunga të trasha tymi. Gimi ishte solemn e i emocionuar, kurse ajo lëvizi me shumë përtesë drejt një shkëmbi të afërt dhe i pëshpëriti të shoqit diçka me pakënaqësi. Ai e qetësoi me një zell që vazhdoi disi gjatë. Pastaj, ndërsa unë futesha në ujë, ata të tre shkuan dhe zunë vend te shkallët e hekurta në breg, pesë-gjashtë metra larg. Deti farfurinte si pasqyrë. Uji ishte ende i ftohtë, por i kulluar dhe i tejudkshëm si ajri. Ndërkaq u zhyta. Eca disa metra, pastaj e ngjita fytyrën përfund detit dhe fillova të kërkoja. Kontrollova disa sekonda vendin përçark dhe ndjeva se po lodhesha e po bëhesha nervoz. Mes zajeve shndritnin herë pas here vezullime të harkuara si unaza e humbur. Shkoja pranë tyre dhe asgjë. Më kapi papritur një inat i tërbuar, që ma mënjanoi lodhjen në çast. Ishte një inat i rëndë e qesharak me detin. Nën ujë sendet dukeshin të turbullta, mashtruese dhe iluzore. Shkisja mes zajeve, merrja nëpër duar gjithfarësoj gurësh, guaskash të vogla, copa qelqi a teneqeje të hollë dhe i lëshoja sërish me zemërim. Ndjeva që s'mund të rrija dot më dhe dola mbi ujë.

— Asgjë, — thashë duke shkundur kokën e duke marrë frymë me ngut. Ata shihnin nga unë pa lëvizur. Ndërkaq qenë afruar edhe disa

kureshtarë: një grua e shëndoshë me flokët të mbledhur topuz pas koke, i shoqi, teknik në një nga minierat e Jugut, një çift i ri me të cilët përshëndeteshim ngaqë hanim në tavolina pranë dhe një burrë me pamje të ngrysur që rrinte disi më larg se të tjerët dhe shikonte duke përtypur diçka në gojë. U çlodha pak dhe u zhyta sërish. Këtë radhë ndenja më gjatë dhe e zgjerova më tej rrethin e kontrollit... Kishte aty mes zajeve dhe zonës ku fillonin leshterikët e kaltër e magjepsës aq shumë sende që feksnin si harqe unazash, saqë u rraskapita duke rendur sa nga një vend në tjetrin. Edhe pse këto pamje mashtruese ma reshtën durimin, prapë kërkoja me këmbëngulje e kokëfortësi e s'më bëhej të dilja në ujë. Më dukej vetja aq i ngarkuar me ndjenjën e detyrimit ndaj atyre që pritnin lart, edhe ndaj gruas së re, që ishte shpërfillëse dhe e trishtuar deri në mosmirënjohje, bile më shumë ndaj saj, saqë mashtrimet e detit i vuaja si një armiqtësi personale. Dola i lodhur dhe e qëllova sipërfaqen e ujit me grusht disa herë. Dikush në breg qeshi me zë të lartë. Shkova dhe u ngjita në shkallët e hekurta. Petroja më shikonte me një pamje të tillë, sikur porsa t'i kisha bërë ballë një skandali. Ata të dy shikonin detin të heshtur. Gruaja e shëndoshë, shumë gazmore, erdhi me të shoqin më pranë nesh.

— Sa seriozisht e ke marrë këtë punën e unazës, — tha Petroja. Unë qesha. Me të vërtetë, sa seriozisht e kisha marrë.

— Ti je ca supersticioz. Kujton sikur ajo unazë ka kaq shumë lidhje me lumturinë e tyre, sidomos të asaj, — pëshpëriti me zë të ulët. —

Kurse unë vë bast që ajo s'do t'ia dijë shumë për të, dhe sidomos për gjestin tënd kalorësiak. Në përgjithësi mua më duket se atë e bezdis kujdesi i të tjerëve.

Burri i gruas me topuz që ngritur më këmbë. E shoqja e mbante nga krahët dhe qeshte në mënyrë shumë shpërthyesë. Të gjithë kthyem kokat andej. Ky publicitet e bëri burrin të ngurronte i turpëruar për një çast, pastaj u shkëput nga e shoqja dhe shkoi me hapa të vendosur pranë ujit.

— Ta provoj njëherë dhe unë, — tha, — kam qenë notar i mirë dikur. — Gimi u ngrit dhe i tregoi vendin. Ada lëvizi pak dhe i buzëqeshi me mirësjellje. E shoqja, pranë nesh, tregonte e entuziazmuar se si atij i shkrepnin herë-herë në kokë gjëra aq të çuditshme dhe të pabesuara, sa që ajo rrinte një javë të tërë duke qeshur. Notari ktheu njëherë kokën nga e shoqja, që vazhdonte të qeshte me qesëndi, u mat të thoshte diçka, pastaj ndërroi mendje, mori frymë thellë dhe u zhyt. Qëndroi gjatë nën ujë, aq sa e shoqja u ngrit e befasuar në këmbë.

— Ç'është kështu? — tha. — Të kisha vdekur, s'do ta kisha marrë vesh që buçkoja im qenka notar kaq i madh.

Ai vazhdonte të qëndronte nën ujë. Mbi sipërfaqe dolën një mori filluskash dhe gruaja me topuz u kap nga paniku. Burri që përtypej i ngrysur, u afrua edhe ai pranë bregut me një pamje të tendosur. Vajza e çiftit tjetër kishte hedhur të dyja duart në krahun e të shoqit dhe e shikonte detin me vështrim drithërues. Burri

doli më në fund i shoqëruar me një pasthirmë habie.

— Ah, dreqin, m'u duk për një çast se e gjeta.

E shoqja qeshi përsëri me një alto kumbuese, që i shkonte për shtat shëndetit të saj të bujshëm. Sërish ra qetësi. Ada u mbështet në një pjesë të shkëmbit dhe filloi të shfletonte një libër, kurse shitësi i ri luante gishtërinjtë me nervozizëm mbi telat e kitarës.

— Sikur ta provoja dhe unë, — i pëshpëriti aty pranë së shoqes djali i çiftit tjetër.

— Mundesh? — pyeti gruaja e re.

— Po ta provoj njëherë.

— Ah, sikur ta gjeje ti, Gjergji, sikur ta gjeje ti! S'di çfarë mund të të jepja!

Djali qeshi dhe u përkul pranë saj.

— Ti kujton me të vërtetë se ka diçka në botë që më mungon mua?!

Edhe ai kërkoi sqarime për vendin dhe u nis. Ishte i emocionuar sikur të shkonte në një duel. Sidoqoftë kishte një pamje të mbushur me vetëmohim.

— Më mirë të mos shkonte, — tha Petroja, — sot ai rrezikon të bëhet i zakonshëm në sytë e së shoqes.

— Mbase ai shkon pikërisht për një gjë të tillë, — thashë. E shoqja aty pranë e ndiqte me vështrim të mrekulluar. Burri i vetmuar u ul në gjunjë pranë nesh.

— Ç'ju ka hipur të kërkoni një unazë në det? — pyeti. Ai e shqiptonte me grykë e të shformuar r-në kur fliste. Kishte një fytyrë të ashpër, në të cilën vinin vulën një palë musta-

qe pis të zeza e të trasha. Nuk iu përgjigjëm. Pyetja qe tepër e vështirë. Befas gruaja me topuz ndërhyri me pakënaqësi.

— Aman dhe ju burrat, na hëngrët me këto mustaqe!

U krijua për një çast një situatë e tmerrshme. Burri i akuzuar shikonte përçark me alarm.

— Dëgjo, — tha pas pak, — unë nuk anko-hem ngaqë ti je kaq e shëndoshë. — Përgjigjja qëllloi tamam në shenjë. Gruaja me topuz e mbylli gojën.

— Të lumtë, or mik, — tha i shoqi. Burri me mustaqe e quajti veten të shpërblyer me kaq dhe u qetësua.

Notari humbi nën ujë. Pas pesëmbëdhjetë — njëzet sekondash, doli mbi sipërfaqe, mori frymë dhe u zhyt prapë. Një gjë të tillë e përsëriti disa herë. Gruaja e re përkrah e ndiqte me ankth. Petroja u kthye duke qeshur nga ajo.

— Ti mos u mërzit, në rast se ai s'e gjen dot unazën.

Gruaja e pa e habitur dhe në çast u bë flakë e kuqe në fytyrë.

— Jo, pse të mërzitem. Mua më vjen keq për atë, — tha duke treguar nga Ada, që tani rrinte me kokën në gjunjë si një Ofeli. — Në fund të fundit ç'është një unazë?

Petroja miratoi i qetë.

— Ju jeni durrsakë? — pyeti ai pastaj.

— Çne durrsakë ne?! — tha e habitur gruaja e re. — Unë jam nga Himara, kurse Gjergji është nga Lezha. Punojmë në një qytet të Veriut. Jemi mjekë.

— Shumë mirë, shumë mirë!

Në të vërtetë Petroja ishte diçka mbi të tridhjetat, po që kur ishte martuar, kishte idenë se që bërë burrë i lashtë dhe u fliste më të rinjve me intimitetin e një gjyshi. Si dukej edhe gruaja e re e vuri re një gjë të tillë dhe qeshi.

Ndërkaq notari kishte dalë dhe po afrohej drejt nesh. Kishte pamjen e një të munduri.

Provën e fundit të asaj dite e bëri burri me mustaqe. Ishte gjeometër. Ai notoi për një kohë të gjatë përreth, u largua dy-tri herë tej, te shenja e një anijeje të mbytur, pastaj u afrua dhe befas u zhyt. Lëvizjet e tepërta i bëri ngaqë, si dukej, nuk donte të binte tepër në sy. Por, pasi u zhyt një herë, e harroi krejt kujdesin për të mos u vënë re dhe ndenji aty gati një orë duke kërkuar. Ishte me të vërtetë një notar i shkëlqyer.

— Hë, — i tha minatori së shoqes, — ç'do të thuash tani për mustaqet e tij?

— S'them gjë, — tha ajo me një zë të përvuajtur, — i meriton...

Pasdite, teksa shëtitnim buzë detit, e pamë Gimin pa të shoqen mes tre-katër moshatarëve të tij. U fliste atyre me zë të ulët, me pasion e këmbëngulje, duke lëvizur në mënyrë energjike duart, këmbët e tërë trupin. Të tjerët vetëm dëgjonin të përqendruar dhe e ndërpritnin më të rrallë. Kjo e bënte atë të riniste një ligjërim edhe më të tensionuar.

Pas dy orësh e takuam prapë te shkallët e hotelit. Ishte shumë entuziast. Në dorë mbante një pako të mbështjellë. Ndali dhe na takoi.

— E di ç'keni ju, — tha pas pak, — ejani të kthejmë nga një gotë aty lart. — Ne kundërshtuam duke i kujtuar të shoqen që ndoshta e priste në dhomë.

— Jo, — tha ai, — Ada akoma nuk është shkëputur nga romanet, nga ky mallkim i tërë vajzave të reja të botës.

Shkuam u ulëm në bar dhe porositëm nga një gotë konjak. Fliste vetëm ai. Kishte mbi dhjetë vjet që punonte si shitës në një nga lagjet e Tiranës, kurse e shoqja porsa kishte mbaruar shkollën e mesme. Pastaj na u desh të dëgjonim ca hollësira romantike me vajza që ishin çmendur pas tij, me Adën që i kishte sfiduar të gjitha, peripecitë për ta bërë atë të vetën, kundërshtimet e gjata të prindërve të saj dhe më në fund dasma e bujshme dhe e kushtueshme, saqë do të vinte në hall dhe një milioner të vërtetë.

— Si është e mundur?! — pyeta unë i habitur.

— Ja që është, — tha ai me pamjen e një konspiratori. — Kështu, — vazhdoi pastaj me një përvuajtje të shtirë, — një shitës i thjeshtë jam unë.

Kur, më në fund, biseda rrodhi tek unaza e humbur dhe unë i premtova se të nesërmen do të kërkonim sërish, ai vuri buzën në gaz me një dozë të papërmbajtur vetëkënaqësie.

— Eh, — tha, — unë mund t'i blej asaj dhjetë unaza njëherësh, t'i mbulojë gjithë gish-tërinjtë me to.

— Kaq shumë! — tha Petroja.

Ai qeshi në mënyrë mospërfillëse.

— Ajo po ma bie në majë të hundës, — tha për të shoqen. — Sot i kam blerë një plaçkë që s'e ka kush. Ku ta dish, mbase bëhet me mendje tjetër.

Pastaj thirri kamerierin, pagoi duke i përballuar përpjekjet tona për të mos e lejuar, me një gjest shumë kalorësiak dhe u largua duke na lënë të habitur. Ndenjëm ashtu edhe për disa çaste.

— Ç'është kaq i shkathët ky fis shitësish, — tha Petroja i pakënaqur. Unë nuk fola. — Me të vërtetë nuk të bën përshtypje? — tha. — Nuk e vure re që ai kërkonte të dukej?

— Është reklama e profesionit, — i thashë.

— Unë e heq pjesën e tepërt dhe prapë ajo që mbetet është revoltuese.

Pas pak u futëm në pjesën e hapur të barit dhe porositëm birrë e karkaleca deti. Ata erdhën gjysmë ore më vonë. Kamerieri u tregoi një vend të rezervuar. Ajo kishte veshur një fustan të bardhë, pak të gjatë dhe ashtu, me flokët e derdhur pas, e heshtur dhe e bukur, ngjante si një Afërditë e dalë nga shkuma e deti. Një tavolinë larg nesh hanin biftekë grua-ja me flokët topuz dhe burri i saj i qetë. Ajo sot ishte e tëra e prirë për incidente. Kishte disa minuta që po bënte fjalë me një kamerier për shërbim tepër të vonuar. Më në fund ajo na u drejtua neve e pakënaqur:

— Hajt të të mbushet mendja që ky njeri është me të vërtetë shërbëtor i popullit.

Ada na përshëndeti teksa kalonte pranë, bile edhe qëndroi disi e gatshme për t'u ulur, por i

shoqi i tregoi tavolinën më tej dhe ajo u largua. Pas pak tavolina ë tyre u mbush sikur do të hanin dhjetë veta...

Të nesërmen vazhduam përsëri të kërkonim. Madje na erdhi në ndihmë edhe një i huaj, me fytyrë krejt të bardhë si qumësht, norvegjez apo irlandez, pra diçka e tillë. Ai u afrua pranë grupit tonë dhe kërkoi sqarime nga gjeometri me mustaqet pis të zeza, i cili u mundua për një kohë të gjatë ta sqaronte me atë rusishten e vet të shkollës së mesme. Si dukej, norvegjezi apo irlandezi s'kishte dëgjuar kurrë në jetën e tij ndonjë fjalë ruse dhe tërë mundimi rraskapitës i gjeometrit shkoi kot. Më në fund ata përdorën shenjat dhe suksesi që i plotë. Të huajit i ndriti fytyra si një poç elektriku dhe u zhyt në det me vrap, si të kishte frikë mos unazën e gjente kush tjetër para tij.

— Gjëja më e tmerrshme, — tha mjekja e re, — është që ta gjejë unazën ky i huaji.

— Në asnjë mënyrë, — e siguroi i shoqi. — Mua gati — gati po më mbushet mendja që unaza nuk është veçse një trill i asaj.

— Ti s'je në vete, Gjergji, — tha mjekja e re, — pa shihe njëherë atë! Ka një pamje aq të trishtuar, sa të këput shpirtin.

Të gjithë ne kthyem kokat andej nga tregoi mjekja. Ada rrinte mbi tre-katër gurë të vendosur mbi njëri-tjetrin, me një pamje prej njeriu të braktisur. I shoqi i rrinte te gjunjët si një skllav dinak. Fliste pa pushim, vrenjtej, qeshte e nervozohet dhe prapë ishte i sigurt si një aktor i vërtetë. Ajo e dëgjonte me qetësi, pa folur, në një pozicion profil, që herë-herë të jepte

përshtypjen e një pamjeje shumë kryengritëse. Si të gjithë, edhe i huaji dështoi në kërkimet e veta dhe u largua duke na përshëndetur me mirësjellje.

— Tani priten të vijnë për të kërkuar kinezët dhe afrikanët, — tha Petroja, — një nga çdo kontinent dhe detyra quhet e kryer.

Nuk di pse humori i tij më dukej krejt i papranueshëm në atë gjendje të vërtetë shqetësimi që kishim për unazën e humbur. Nuk qe e vërtetë që ishim supersticiozë, siç besonte ai, ose të paktën shumica s'qe e tillë. Por, teksa ajo grua e re qe kaq e mërzhitur dhe i vetmi shkak që dinim qe unaza, atëherë ne e ndienim si detyrim që të bënim për të aq sa mundnim. Rrinim nën ujë, kërkonim me këmbëngulje dhe pastaj, të lodhur, uleshim në breg, pranë njëritjetrit dhe bisedonim aq seriozisht për unazën e humbur dhe për mundësitë e gjetjes së saj, sa të thoshe se për ne s'ekzistonte asgjë tjetër. Përkushtimi ndaj saj ishte kthyer në një ndjenjë të vetvetishme dhe s'na shkonte ndërmend se mund të bëheshim ndopak qesharakë...

Edhe atë ditë ne vazhdonim të kërkonim, megjithëse koha ishte disi e vrenjtur, si e trazuar me tym. Kishim dalë të gjithë ne, me përjashtim të atyre të dyve. Fakti që ata po vononin, na nxiste më tej, na dukej tamam si ato kurdisjet e lumtura që sajton rastësia. Vonesa nuk ishte veçse koha kur ne do ta gjenim unazën, do ta vinim në shkëmbin ngjyrë plumbi, ku rrinin ata zakonisht dhe kështu botës do t'i shtoheshin dhe dy njerëz të lumtur. Ata u vonuan gjatë. Ne kërkonim. Për çudi, atë ditë u hodh disa herë

edhe Petroja. Thjesht për të mos qenë jashtë radhëve, tha ai.

Aty nga ora dhjetë zbriti në det Gimi, shi-tësi. Ecte ngadalë, me një pamje të lodhur dhe me fytyrën disi të buhavitur. Dukej që porsa ishte zgjuar.

— S'qenka këtu ajo? — pyeti pas pak i habitur, duke parë nga vendi ku mendonte se do të qe e shoqja. Ne ngritëm supet.

— Nuk e keni parë?

— Jo, — u përgjigj mjekja e re po kaq e habitur sa edhe ai.

— Ç'dreqin i ka pjellë mendja, — tha ai i revoltuar dhe u nis në drejtim të hotelit. Ne ndenjem për një kohë të gjatë duke e parë të largohej me hapa të shpejtë e nervozë, pastaj, sikur ta kishim bërë me fjalë, u kthyem të gjithë nga deti dhe po shikonim në heshtje përplasjen e përjetshme të valëve në breg. Heshtjen e prishi e para mjekja e re.

— Si s'na kishte shkuar mendja për një gjë të tillë, — tha. Nga mënyra se si fliste, dukej sikur mezi frenonte një kënaqësi të fshehtë si duf.

— Për çfarë të na shkonte mendja? — pyeti i shoqi me naivitet. Ajo nuk u përgjigj, vetëm e pa me një vështrim të lumtur, sikur porsa ta kishte fituar.

Koha po vishej gjithnjë e më tepër dhe zagushia filloi të bëhej e padurueshme. Pranë nesh erdhën dy djem me maska xhami në fytyrë. Peshkonin oktapodë. U afruam të lehtësuar pranë bregut për t'i parë.

— Unë s'mund të duroj dot pa marrë vesh

se ç'ka ndodhur, — tha gruaja me flokët topuz.
— Buçko, më prit këtu.

U largua me hapa tepër energjikë për trupin e vet. Djemtë u zhytën të dy njëherësh dhe ndenjen për një kohë të gjatë nën ujë.

— Ja, — i thashë Petros, — këta mund ta gjenin shumë lehtë unazën.

Ai më pa i ngrysur.

— Ti je i çuditshëm, — tha, — megjithë mend mendon se mund ta gjejë kush atë unazë?

— Pse, ç'ka këtu të pamundur?

Ai lëvizi ngadalë në shkëmbin poroz ku qe ulur, dhe m'u drejtua mua me një pamje të ngrysur:

— Dëgjo, — tha, — gjithë notarët e botës të mblidhen, nuk e gjejnë dot lumturinë e asaj gruaje të re. Kupton? Nuk e gjejnë dot për një arsye të thjeshtë: ajo nuk ka ekzistuar kurrë.

Vazhdonte të më shikonte i pakënaqur e i alarmuar. Balli i qe mbushur përplot me bula djerse, sikur të vuante një mundim të madh.

— Ku ta dish, — thashë i menduar, — mbase ke të drejtë.

— Mbase kam të drejtë? O pacifist i pandreqshëm. Si nuk e kupton që ajo ka ikur një herë e përgjithmonë. Vetëm çuditem pse iu deshën këto ditë plazhi për ta kuptuar një gjë të tillë?!...

Në drekë, kur u ngjitëm në holl, morëm vesh gjithçka. Ada kishte ikur me një «Zuk» të Tiranës, pasi kishte lënë për të shoqin një lajmërim tepër lakonik: «Unë ika. Ada.» Kaq. Ai qe nisur pas saj me një taksi, por ishte tani disa orë vonë...

Atë mbrëmje shkuam dhe u ulëm në bar më herët se netët e tjera. Nuk e di pse ndienim nevojën të ishim të gjithë bashkë. Në të vërtetë ne ishim kontigjenti më i palëvizshëm i atij hoteli bregdetar në këtë mes shtatori. Ishte një natë e butë, që fëshfërinte nga era si mëndafsh. Natë me hënë lundruese, me peshkatarë të shumtë në breg dhe me një kundërmim ere deti që të çante mushkëritë. Të gjithë sa vinin, uleshin pranë tavolinës së përbashkët me po atë natyrshmëri dhe intimitet që shkohet në një mbrëmje familjare. Dhe dukej sikur gjithkush ishte kujdesur të shfaqej me diçka të bukur e të re: një këmishë, fustan apo thjesht një mënyrë tjetër të të krehurit të flokëve. I fundit erdhi gjeometri. Ai në fillim ngurroi të afrohej, bile u drejtua te një tavolinë tjetër, por, kur ne u ngritëm të gjithë në këmbë dhe e thirrëm në kor, ai mori një karrige dhe shkoi pranë minatorit me të shogën, që sonte i kishte lëshuar flokët e bardhë mbi supe si përrua.

— Po vij, — tha ai, — megjithëse këtu ka një njeri që m'i ka sharë paq mustaqet.

Humori i tij u duartrokit në mënyrë të bujshme. Prania jonë tërhoqi vëmendjen e klientëve rastësorë përçark dhe të kamerierëve.

— Ç'ka bërë vaki atje? — pyeti njëri prej tyre.

— S'merret vesh, — u përgjigj i habitur, kamerieri — qejfe njerëzish.

Ne pinim verë të ftohtë me biftek e peshq të fërguar. Ndihehim të lehtësuar sikur të kishim hequr nga supet një barrë të rëndë. Dhe kur më në fund erdhi biseda te çifti i ikur,

mjekja e re tha se ajo që në çastin e parë kishte pasur parandjenjën se tek ata të dy diçka nuk shkonte dhe se humbja e unazës që aq rastësore për gjithë atë trishtim të gruas së re, sa ç'mund të qe, ta zëmë, humbja e një karfice flokësh. Një gjë e tillë asaj i qe forcuar edhe më shumë kur kishte kuptuar diçka edhe nga pehlivanllëku i të shoqit. Ndoshta të gjithë veç e veç po kuptonim se kjo parandjenjë s'kishte qenë vetëm e saj. Po atëherë pse kërkonim me aq ngulm?!

— Vërtet, pse kërkonim? — pyeti mjekja e re.

Gjeometri ngriti gotën me verë dhe e trokiti me të gjithë.

— Gëzuar, — tha, — gëzuar!

Kishte një pamje të mallëngjyer dhe solemne sikur të ishte në një ceremonial. Rebelimi i r-së në fund të fjalëve të shqiptuara po e bënte gjithmonë e më intime praninë e tij. Tringëllimi i zhurmshëm i gotave me verë sërish tërhoqi vëmendjen e klientëve përreth. Kamerierët po masakroheshin nga kureshtja.

— Hë, pse kërkonim, — këmbënguli mjekja e re.

Për një çast ra një qetësi e nderë dhe të gjithë po shikonim nga njëri-tjetri të habitur, sikur papritur të kishim rënë në një kurth kolektiv.

— Pse kërkonim? — Petroja e shtrëngonte gotën e verës në dorë si granatë. — Ku ta dish, — tha pastaj me një pamje të rreptë e qortuese, — mbase ngaqë nuk duam të besojmë se akoma ndodhin gjëra të shëmtuara.

Të gjithë po e shikonim atë me një ndjenjë

DIÇKA NGA E PAMUNDURA

Porsa mora vesh se babai të nesërmen do të shkonte me urgjencën në Tiranë, u nisa me vrap drejt spitalit. Fytyra më përvëlonte si zjarr, kurse gjoksi më gufonte e më therte sikur të ma shqyente dikush nga brenda. Isha i tëri në alarm, në dhembje, në dëshpërim, në atë zemërimin e plogët që i kap njerëzit kur kuptojnë se janë të pafuqishëm përballë së keqes. Portieri i spitalit nuk më ndali, siç bënte zakonisht, vetëm më buzëqeshi lehtë dhe uli kokën i dëshpëruar. Unë vështrova vetëm një çast fytyrën e tij të plakur me rrudha të thella e të varura trishtueshëm dhe zemra më theri nga dhembja.

Ngjita shkallët me ngut dhe s'më ndali askush. Hipa në katin e tretë, përshkova disa metra me hapa të nxituar dhe befas u bëra i arsyeshëm. Ku shkoja kështu! Tre-katër metra më tej ndodhej dhoma e tim eti, dhe ai e dinte

që do të shkonte urgjentisht në Tiranë. I rra-
kapitur, zgjata kokën në njërën prej dritareve
të korridorit, nxora shaminë dhe fillova të
fshija fytyrën e mbuluar nga djersët e nxehta.
Dikush më kapi nga supet. Ishte njëra nga
ndihmësmjeket e pavijonit.

— Ç'bën këtu? — pyeti.

— Pres të shkoj te babai.

— Shko, s'ka njeri.

Unë e vështrova në fytyrë dhe ajo shtangu
në vend.

— Prit, — tha me zë të lehtë dhe çuditë-
risht kërcënues, që në kushte të tjera do të
më bënte të vija buzën në gaz, — ku shkon
kështu, me këtë pamje? Ç'ke?

— Më thanë se babai do të shkojë në Tiranë

— E çfarë? — tha ajo e revoltuar. — Do
të shkojë për një vizitë në Tiranë. Nesër venë
dy të sëmurë dhe, meqë është rasti, mjekët
menduan të shkojë edhe ai. Ç'ka këtu për t'u
alarmuar? Hajde, qetësohu, pastaj hyr brenda.

E pashë me vëmendje në fytyrë. Ajo ishte
e brishtë dhe e re, mbase sapo kishte mbaruar
shkollën e mesme. Dy sy të mëdhenj, të gu-
ximshëm, të ftohtë, me një mirëdashje të kur-
syer, më shikonin qortueshëm. Rrinte para
meje e rreptë dhe e gatshme t'i qëndronte bes-
nike deri në fund profesionit të vet.

— Babai juaj s'ka asgjë. Ju shqetësoheni
kot, — tha më në fund me atë mospërfilljen
profesionale të mjekëve, që megjithatë s'e
kishte përvetësuar sa duhej.

Nuk e di në kisha dashur ndonjëherë në
jetën time kaq furishëm që ato që po dëgjoja

të ishin të vërteta. Shqetësimi për babanë nuk qe një hov sentimental. Sëmundja e tij kishte kohë që s'po na pëlqente. Ai qe bërë delikat, djersinte, lodhej shpejt dhe kishte temperaturë të herëpashershme. Dhe ja tani urgjent në Tiranë. Kurse ai ishte ende i ri, energjik, i kthjellët. E pamundur! Ç'mbrojtje do t'i vinim përballë këtij lajmi?...

Hapa derën. Babai kishte kthyer kokën nga dritarja. Krevati ishte mbushur me trupin e tij të madh e të gjatë. Më ndjeu dhe u rrotullua ngadalë.

— Hë? — pyeta duke u munduar me të gjitha forcat që të isha i lirshëm dhe i natyrshëm.

— Erdhe? — buzëqeshi ai lehtë. — Do të vete në Tiranë për një vizitë, — tha. — Më mirë kështu. Ta marrim vesh ç'është, në fund të fundit.

— Ashtu? E po mirë.

Ai rrinte i menduar. Ishte hera e parë që e shikoja në pozitë e njeriut që kërkon të vihet në mbrojtje, dhe kjo më pikëlloi në shpirt. I sëmuri i krevatit tjetër flinte, dhe ne flisnim me zë të lehtë.

— S'kuptoj pse më çojnë kaq urgjent, — tha pas pak, — tani edhe temperatura më ka rënë, megjithëse ndiej dobësi. Kushedi për se dyshojnë.

— Eh, ku të shkon mendja, — thashë dhe përsëri u përpoqa të flisja sa më natyrshëm. — Unë bisedova me ta. Çojnë dy të sëmurë me komplikacione në veshka dhe menduan të shkosh edhe ti. Pse, si të tha mjeku?

— Cili mjek? — tha babai dhe unë vura re

i habitur një ndryshim të menjëhershëm në tërë pamjen e tij. Sytë e lëngëzuar, të lodhur e të përskuqur në skajet nga pagjumësia vetëtinë nga një zemërim që ai mendohej ta fshihte më kot.

— Ç'ka ngjarë? — pyeta.

— Asgjë, — tha.

Merrte frymë me zor dhe lëvizte gishtërinjtë me nervozizëm nëpër vijat e pizhameve. Sytë e tij të mëdhenj shkanë me shpejtësi nga fytyra ime dhe ranë në dysheme me pikëllim. Ndjeva për së dyti në qëndrimin e tij njeriun që kërkon të vihet në mbrojtje dhe m'u duk sikur thellë në gjoks u këput diçka me një zhurmë të mbytur e të padurueshme. Ç'të bëja me këtë detyrim të ri e të papritur?! Babai kishte qenë gjithmonë një burrë i ndershëm, krenar e sedërmadh; e kishte parë jetën drejtpërdrejt në sy dhe kishte ecur barabar me hapat më të guximshëm të saj. Njeriu s'e ka në dorë t'i zgjedhë prindërit, por ç'gjë e mahnitshme është kur kupton se rasti të ka privilegjuar deri në fund duke të bërë të birin e një burri të thjeshtë e të vërtetë. Atëherë, edhe sikur të bëhesh një shkencëtar i madh, punëtor i nderuar a burrë shteti i përmendur, ndien se midis njerëzve të mirë është në botë edhe një njeri i veçantë, pranë të cilit ke dëshirë ta ndiesh veten gjithmonë fëmijë. Po në këto çaste më dukej se kishte ndodhur diçka që e kishte prishur ekuilibrin.

— Po çfarë ke kështu? — e pyeta sërish me atë vetëkontrollin e mundimshëm për t'u dukur i qetë.

— Thashë se më pyete për doktor Kristaqin, — tha babai.

— Për doktor Kristaqin? — Emri i mjekut që u përmend s'qe shumë i njohur për mua. Doktor Kristaqi ishte një burrë me shtat të zakonshëm, i qetë, me një pamje disi të tultë, që ia jepnin faqet e fryra pak si tepër. Ai s'kishte ndonjë emër të veçantë si mjek, por s'qe as i sharë. Kisha dëgjuar herë-herë të qarkullonte një folklor satirik i hidhur në lidhje me oreksin e tij. Po këto raste s'janë gjithmonë për t'u besuar. Çfarë s'bëjnë ndonjëherë dashakëqinjte?!

— Po ç'pate me doktor Kristaqin?

Ai zgjati dorën në komodinë, mori paketën ndezi një cigare dhe, teksa e thithte, tundi kokën i pakënaqur e disi nervoz.

— Këmbeva ca fjalë me të.

— Ashtu? Po pse?

— Po ja, e pyeta: more doktor Kristaqi, përse më çoni me urgjencë në Tiranë? Ca gjëra s'thuhën, more shoku Pano, më tha. O, me ju intelektualët është bela e madhe. Doni t'i dini të gjitha. Si, ore, më flet kështu, i thashë. Ai u kthye nga Sabriu dhe vazhdoi prapë avazin Dëgjon, ti, Sabri, i tha. Ju punëtorët, mor vëlla, jeni të thjeshtë, s'futeni në të thella, po këta intelektualët, këta vetëm të pyesin dinë. Jo pse kështu, jo pse ashtu. Kuriozë të inëdhenj janë. Kështu, more shoku Pano. Mos u bëj hiç merak e mos e mundo hiç veten. Do të bësh një vizitë në Tiranë dhe kaq. Qeshte dhe më dukej sikur kërkonte të tallej.

— Po ai ka bërë shaka, — thashë duke u menduar t'i vishja një logjikë të pranueshme veprimit të mjekut, — ti je i shqetësuar dhe e ke marrë ters.

— I shqetësuar jam, se s'më çojnë në dasmë, por edhe ashtu nuk flitet.

Dhoma ishte mbushur përplot me tym cigareje. Babai dukej i qetë në pamje, megjithatë duhanin e thithte me njëfarë mllefi.

— Habitem, sa rëndësi u jep këtyre fjalëve të doktor Kristaqit, — thashë.

Ai ktheu kokën në çast nga unë dhe më pa për një kohë të gjatë me një vështrim të menduar e të habitur. Fytyra e zbehtë dhe e hequr nga sëmundja dalëngadalë iu gjallërua. Një buzëqeshje e papritur dhe e lirshme e ndriçoi të tërin dhe ai fitoi sërish atë sigurinë e për-hershme.

— E, mor dreqin, — tha duke qeshur, — sesi jam bërë këto kohët e fundit. Shtrati të ligështoka.

Krisi dera dhe në prag të saj u duk mjekja e pavijonit. Rrotulloi vështrimin nëpër dhomë dhe vuri duart në faqe e alarmuar.

— Ç'bëhet kështu? — tha me zemërim. — Ç'është ky tym këtu, sikur ka rënë zjarr? Ah, shoku Pano. Ju as që pyetni për këshillat tona. I pini këto cigare një-rën pas tjetrës, tamam si për inat. Unë s'di çfarë të bëj me ju.

— Kjo është cigarja e dytë që kam pirë sot, — u shfajësua babai.

— Cigarja e dytë? Kujt ia thoni ato, — tha mjekja me ton të rreptë. — Këtu ka kaq tym, sikur të kenë pirë cigare gjithë duhanxhinjtë e qytetit. Kurse ju s'duhet të pini asnjë cigare. Kuptoni, absolutisht asnjë.

— Këtë ta shikojmë, — tha babai duke qeshur.

— S'keni ç'të shikoni, — tha ajo. — Ne jua ndalojmë dhe jeni i detyruar të bindeni. Ashtu?!

— Mirë, mirë.

Mjekja u ul në krevat pranë tij.

— Shiko, shoku Pano, kam ardhur t'ju lutem për diçka, — tha pastaj, — ja që më mbeti mua kjo punë.

Babai përqendroi vëmendjen. Mjekja e re uli kokën për disa çaste.

— Për se do të më lutesh? — pyeti babai.

— Po ja, — tha mjekja e re duke ia afruar dorën pranë vetes. — Ju nesër do të shkonit në Tiranë. Kurse unë kam ardhur t'ju lutem që të mos shkoni, pasi na duhet vendi për një të sëmurë tjetër. Nga ata të dy s'mund të ndalim asnjërin. Kurse me ju është ndryshe puna. Jemi të bindur se do t'ju thonë po ato që ju thamë edhe ne. Tani gjendja juaj është e përmirësuar dhe e qartë. Ndoshta më vonë, po të doni, mund të shkoni të bëni një vizitë për merak.

Babai dëgjonte i vrenjtur.

— Unë nuk kuptoj si është kjo punë, — tha. — Njëri vjen dhe më thotë se duhet të shkoj patjetër në Tiranë, kurse ju thoni se kjo s'është e nevojshme. Nuk di, nuk di, — vazhdoi ai i vrenjtur dhe zgjati dorën të merrte cigaret.

— Cigaret lërini ku janë, — tha mjekja duke vënë pëllëmbën mbi paketë, — po kush ju ka thënë se duhet të shkoni patjetër në Tiranë?

— Doktor Kristaqi.

— Doktor Kristaqi? Ah, po. Fillimisht ne u shqetësuam nga temperatura që s'po ju binte, pse t'jua fsheh, kurse tani çdo gjë është në natyrën

e sëmundjes që kemi diagnostikuar. Dhe meqë shkon makina në Tiranë, meqë ju vetë donit të bënit një vizitë te specialisti, thamë se mund të shkonit. Por askush s'ka menduar se kjo gjë është e domosdoshme. Kur biseduat me doktor Kristaqin?

— Mbrëmë.

— Mbrëmë? Ah, ai doktor Kristaqi, — tha ajo duke qeshur. — Po sëmundjen tuaj nuk e ndjek ai.

— S'di ç'të them, — tha babai.

— Ç'të thoni, — tha mjekja e re duke qeshur me zë të lartë. — Ju e keni bërë dhomën pus me duhan nga shqetësimi.

— Pse, e paktë është?! Vjen i biri i botës dhe të thotë se do të shkosh urgjent në Tiranë. Ti do të sqarohesh dhe ai ta pret drejt e me sëpatë: i sëmuri nuk duhet t'i dijë të gjitha gjërat.

— Si? — mjekja e re u afrua më pranë babait. — Kështu ju tha doktor Kristaqi? Jo, s'mund t'ju ketë thënë kështu. S'ka forcë të më bëjë të besoj se ai ka thënë tamam kështu.

Ajo dukej në këto çaste naive dhe e çiltër si një fëmijë. Qeshte, habitej, rrihte shuplakat dhe thoshte vazhdimisht «e pabesueshme, e pabesueshme». E qeshura e saj e kumbueshme mbushte tërë dhomën. Nisëm dhe ne të qeshnim me të. I sëmuri tjetër u zgjua, u mbështet në kokën e krevatit dhe po shikonte i habitur.

— Si ju paskan trembur kështu, — tha mjekja duke marrë frymë thellë. — Të lumtë, doktor Kristaqi! — Zgjati dorën nga komodina, mori paketën, nxori një cigare dhe ia zgjati babait. — Pijeni, — tha me ton gazmor, — pijeni! E

keni hak një cigare. Shoku Pano, thoni të drejtën, jeni trembur?

— Jo, — tha babai duke ndezur cigaren.

— Ju jeni trembur që ç'ke me të. Kujt kërkoni t'ia hidhni?! — Mjekja u përkul edhe më. — Shih ç'pamje e lodhur, kurse sytë i keni ende të buhavitur nga pagjumësia. Dhe thoni pastaj që s'jeni trembur.

Më duket se babai e ndiente veten disi ngushtë përpara naivitetit shpërthyes të mjekes së re, megjithatë ishte i qetë. Rrinte mbi shtrat me këmbë të shtrira, buzëqeshte me mirësjellje, i kundërshtonte po me të njëjtin ton kërcënimet e shtira të mjekes për duhanin dhe më hidhte mua herë pas here vështrime të druajtura, sikur të më kërkonte të falur për situatën disi të pazakontë në të cilën ndodheshim.

Mjekja vazhdonte të fliste e të qeshte pa pushim. Ajo tha dhe gjëra të tjera, po veçanërisht ngulmoi ta ngacmonte babanë në atë që doktor Kristaqi e kishte trembur paq mbrëmë.

— Po unë s'kam më atë moshë që të vë kaq merak sa thua ti, — kundërshtoi babai me të qeshur.

— Posi! Vë bast që ju sot jeni me të vërtetë sëmurë, — tha mjekja, pa e përfillur kundërshtimin e tij. — O, ç'keni menduar ju tërë natën sot! Ja edhe djali juaj, — u drejtua ajo për herë të parë nga unë, sikur fliste për një të mitur, — qenka i tronditur. Me siguri që ia keni turbulluar mendjen me ato dyshimet tuaja.

— Jo.

Vura re se në ballë dhe në tëmtha asaj i bulëzonin djersë të imta. Kjo gjë m'u duk e

panatyrshme dhe tronditëse. Në çast më gllabëroi mendimi shqetësues se gjithçka që bënte mjekja e re, lutja për të mos shkuar babai në Tiranë, humori që rrihte të krijonte një gjendje normale e gazmore pas shqetësimit të krijuar, qortimet e shtira, nuk ishin veçse një detyrim profesional për të korrigjuar pakujdesinë e vrazhdë të doktor Kristaqit. Ky konstatim më bëri gati të klithja, por as babai, as mjekja, as Sabriu, që qe futur tani në muhabet, nuk e kishin mendjen tek unë.

Sabriu nisi të tregonte ca historira të lezetshme dhe ata qeshnin me lot. S'e kisha parë kurrë kaq në humor tim atë.

— Bobo, — tha mjekja më në fund, — mbeta këtu. Pra, shoku Pano, kështu e lamë, — ajo e ndërpreu të qeshurën dhe i dha fytyrës një pamje të natyrshme.

— Ju i dini këto punë, — tha babai i qetë.

— Dhe shiko, — tha ajo duke ikur, — unë do t'ju ngacmoj gjithmonë për këtë frikën e sotme. Do t'ju ngacmoj sa të shqepem, le t'ju vijë rëndë.

Babai qeshi. Mjekja doli.

— Ka lezet, — tha Sabriu duke kruar kokën. — Jo po si ai Kristaq dallamënga.

Unë ndenja edhe pak e dola.

Babai më në fund ishte i qetë. Ecja nëpër korridorët e bardha, zbritja shkallët ngadalë dhe përpiquesha të përqeshja veten e të bëhesha me turp për atë shqetësim që kisha treguar një orë më parë, por s'mundja.

Ato bulëzat e vogla të djersës në ballin e mjekes së re më kishin mbetur në mendje si

një peng i rëndë dhe ishte e pamundur t'u jepja një kuptim qetësues, po megjithatë sa mirënjohës i isha për atë mashtrim të mrekullueshëm.

Në hollin e katit të parë ajo po bisedonte me dy nga kolegët e saj dhe me ndihmësmjekun e pavijonit ku qe shtruar babai. Unë ndala një çast dhe ata ulën kokat...

Atë ditë e kujtoj edhe sot, kur babai s'është më. Ai kaloi edhe disa ditë në humor e shkujdesje, derisa gjithçka u bë në mënyrë të pamëshirshme e qartë. Mendoj për mjekjen e re. Ajo që i ndodhi babait, ishte tej mundësive, por ca ditë për të, në fund të fundit, ajo diti t'ia vidhte vdekjes...

NË JETËN E NJË VAJZE

Ajo tani pothuajse kishte harruar gjithçka. E dhënë e tëra pas punës, ishte bërë sërishmi e çiltër dhe gazmore. Mendimi se diçka i kishte ndodhur, i fekste herë-herë si një yll i ftohtë dhe harrohej në çast. Nuk donte ta pyeste më veten për Gjergjin dhe veçanërisht nuk donte ta ngarkonte atë me faj. Ajo që ndodhi me ta, ishte aq e qetë dhe e pafajshme, saqë mund t'u ndodhë vetëm dy njerëzve që i venë pas zërit të arsyes. Edhe me mendimin se ndoshta e kishte dashur, nuk pajtohej më. Ata ishin shoqëruar disa muaj bashkë, kishin shëtitur, disa herë kishin vajtur edhe në kinema, kishin biseduar për gjithfarë gjërash të rëndësishme dhe të parëndësishme dhe pastaj, një mbrëmje, në mënyrën më të pandërlikuar që mund të mendohet, ishin ndarë pa bërë asnjë premtim dhe pa marrë me vete asnjë brengë. Ajo e dinte

se kjo ishte gjëja më e çuditshme që mund të ndodhte me një vajzë e me një djalë, po çudia kishte ndodhur. Ai shkoi në qytetin e tij dhe Semi në të sajën. Kaq. Dhe sikur tani ta takonte papritur, ajo ishte e bindur se nuk do të ndiente asnjë lloj ndrydhjeje apo shqetësimi. Përkundrazi. Do t'i zgjaste dorën, do t'i fliste lirshëm, si gjithë të njohurve të saj, bile dhe do të qeshte pak tinëzisht me atë që u kishte ndodhur. Një skenë të tillë ajo e improvizonte shpesh dhe vazhdimisht ndiente sigurinë e një ngadhënjimi që e ngazëllente. Kurse Gjergji gjithmonë e më tepër merrte vlerat e një partneri të paanshëm në këto lloj inskenimesh dhe gjithçka ishte aq e bukur dhe e qeshur, saqë të mbushej gjoksi me kënaqësi.

Vinte në shkollë e kënaqur, hynte në mësim me ndjenjën romantike të mësuesve të viteve të para, që duan të jenë me nxënësit idealë, si heronjtë e romaneve pedagogjike, dhe ishte e zënë aq tepër me punë të zellshme, saqë tmerrohej kur mendonte se për pak desh ia kishin vjedhur këtë kënaqësi. Ah, Gjergji! Sa do t'ia kishte ndërlikuar jetën me atë druajtjen e tij të çuditshme. Oh, ishte njësoj sikur të thoshte djalë me fiongo. Ajo vetëm tani po e kuptonte se i kishte tmerrësisht inat djemtë e ngathët, ata që heshtin para vajzave si guakë dhe që befas mund të skuqen. Veçanërisht në muajt e fundit të shkollës ajo mendonte se nuk e kishte pasur mendjen tek ai. Ishte e dhënë kaq tepër pas provimeve, saqë, kur e shihte në derën e madhe të fakultetit, që e priste i shqetësuar, duke thithur me vrull cigaren, i vinte të shqyhej gazit.

Kurse merak u me të cilin ai e pyeste për rezultatin e provimit i kalonte të gjithë kufijtë dhe ishte aq argëtues, saqë ajo i harronte në çast emocionet që kishte kaluar. Tani ajo i sillte të gjitha ndër mend dhe thoshte me vetëmburrje se kishte vepruar me shumë takt që qe ndarë me të aq qetë e miqësisht. Edhe Gjergji, nga ana e tij, kishte qenë i arsyeshëm për të mos u larguar i fyer, apo më keq, me ndonjë lloj brengje. Në të vërtetë ajo e kishte trajtuar atë si më të afërmin e gjithë djemve që kishte njohur, po ç'kishte këtu të pazakontë?!

Ishte një mësues tani në shkollë që kishte filluar t'i bënte komplimente të guximshme, por ai e ndiqte efektin e fjalëve që i thoshte me një vështrim aq përgjues e tinëzar, saqë ajo mezi mbante veten nga marazi. Ishte një mashkull i shëndoshë, me një të kuq të vrazhdë, që i rrinte përballë dhe e shikonte me një vështrim të shtirë melankonik. Kur shkante në mbrëmje në shtëpi, e shtrirë në krevat, pasi lexonte diçka, mbyllte dritën dhe rrinte për një kohë të gjatë duke menduar buzagaz për gjithë sa i kishin ndodhur. Dhe, si të kishte bërë një kompromis me vetveten, kalonte gjithmonë në heshtje faktin që pas çdo riprodhimi të ndodhive të ditës përgjonnin lloj-lloj ngjarjesh që kishin të bënin me Gjergjin. I kujtohej kur ai e kishte kërkuar te dera e konviktit me dy bileta teatri në dorë...

— Hë, Gjergji, ç'kemi?

— Kam marrë dy bileta për në teatër. Mendoja se doje të shikoje premierën.

— O, shumë mirë. Me të vërtetë kisha dëshirë ta shikoja. Vetëm dy bileta ke?

— Kaq na mjaftojnë! — Kishte qeshur lehtë Gjergji.

— E kishim lënë të shkonim me Rozën.

— Vërtet? — kishte thënë ai i zënë ngushtë.

— Atëherë shkoni ju të dyja.

— Nuk të ngelet qejfi?

— Aspak.

— Më prit këtu.

Ajo ishte ngjitur lart, ishte veshur, ishte krehur, nuk i kishte thënë asgjë Rozës, pastaj kishte zbritur poshtë. Ai rrinte disa metra larg ndërtesës, tashmë i qetë e i arsyeshëm si një filozof. I kishte vajtur pranë.

— Po Roza? — kishte pyetur ai.

— Ah, Roza. Tërë naze. Tha se ishte pa qejf. Shkojmë bashkë, si thua ti?

— Shkojmë.

Zbritnin për në teatër dhe fliste vetëm ajo, kurse ai dëgjonte në mënyrë miratuese. Semit i dukej e çuditshme mahnitja e tij nga ajo mori historish të rëndomta. Herë-herë ndalej në vend dhe ia shkrephte të qeshurit.

— Çfarë ke? — pyeste ai i hutuar.

— Habitem, sa i përqendruar më dëgjon, — i thoshte ajo mes kukurismave, — sesi më duket vetja. A nuk mund ta kesh më pak serioze fytyrën kur jemi bashkë?

— Si? — në këto raste ai skuqej, e shikonte tepër i çuditur, dhe ato fjalë që thoshte i rrokëzonte si i belbët. Ndoshta mendonte se e vinin në lojë...

I mendonte të gjitha këto dhe ndihej shumë e qetë, sidomos e shpërblyer deri në fund për taktin e saj në sjelljen me Gjergjin. Ishte një e

kaluar që e kishte pasur në dorë të tërën, krejt të sajën, si një vepër arti, ta zëmë si ai zogu i vogël që kishte qëndisur në përparësen e bardhë të mbesës. Shkonte çdo mëngjes në punë nëpër një rrugë me blirë, përshëndeste kalimtarët e qeshur, hynte në sallën e mësuesve dhe priste me ngazëllim të fillonte ora e mësimit. Gjergjin tani gati e kishte harruar. Mendonte se me të rruga nga shtëpia deri në shkollë, mes blirëve kundërmues, nuk do të ishte kaq e qetë. Edhe përshëndetjet e mëngjesit do të ishin të ndërlikuara. Do të ishte e mundimshme të përballonte heshtjen e tij, qetësinë e lëvizjeve dhe atë vështrim që shprehte vazhdimisht mahnitje të reja në historitë e saj të rëndomta.

Në shtëpi filluan ta ngacmonin. Bile si rastësisht i kishin bërë dhe disa rekomandime. Kurse Gjergjin e kishte harruar. Ta zëmë, siç harrohen personazhet e një libri. Kështu mendonte. Sidoqoftë, qortonte ajo veten, është edhe një fakt mosmirënjohjeje e vrazhdësie të harruarit kaq shpejt të një njeriu që dikur ka qenë një shoku yt i mirë. Dhe në këto raste ajo e vinte Gjergjin në pozicionin e çuditshëm të njeriut që kërkon ta mbrosh nga vetvetja. Po ç'mund të bënte për të më shumë se kaq?

Mëngjesi ishte i brishtë, i mbushur me miliarda kristale që kumbonin lehtë e qartë anembanë. Ajo shkonte mes blirëve të porsaçelur me të gjitha pretendimet e një vajze të re e të bukur. Nga pas e ndiqte një potere zogjsh. Një turmë gjimnazistësh shpejtënin hapat ta përshëndetnin, kurse një shkullm i ri borziloku që e kishte hasur te një bahçe e vogël në qoshe të

rrugës i bënte shoqëri gjatë gjithë kohës. Mëngjesi kullohej, bëhej i tejdukshëm e kumbues në çdo hap që hidhte.

— Semi!

Ajo shtangu. Gjinnazistet ngrinë përkrah saj. Furtuna e zogjve iu fut në kraharor. Kumbimi i mëngjesit iu shkund dhe i ra mbi kokë si një breshëri e rrëmbyer tingujsh. Buzëqeshi lehtë e trishtueshëm si një njeri që i dorëzohet papritur një kurthi. U kthye ngadalë drejt tij dhe tha gati duke psherëtirë:

— Ç'do ti këtu?

Ai e shikonte i qetë. Heshtja nuk i ishte dukur kurrë kaq armiqësore. Edhe ai kostumi ngjyrë gri, që kishte veshur e që s'ia kishte parë ndonjëherë, ishte ndrydhës e i rreptë si një parzmore lufte.

— Pse erdhe ti këtu? — pyeti me nervozizëm. Ishte e vetmja gjë që kishte forcë të bënte. Dhe ato gjinnazistet rrinin aty pranë, me sytë shkëndijues që ndiqnin me një kureshtje të pamëshirshme hutimin e saj.

— Kalova këtej rastësisht dhe thashë të të takoja. Pas një ore nisem, — tha Gjergji më në fund. Zëri i tij ishte i qetë, i ngadalshëm, bile i rreptë, si i një njeriu hakmarrës.

Ajo më në fund e mblodhi veten, buzëqeshi lirshëm, mendoi se pamjen e kishte të shpenguar dhe çapkëne si atëherë kur bënte me të lodrën e biletave të teatrit, tha: sa mirë, Gjergji, sa mirë bëre që erdhe! dhe një lumë fjalësh të trazuara e të rrëmbyera. Kurse ai dëgjonte me atë shprehjen e tij të përhershme e të qetë që ajo mendonte se, më shumë nga çdo gjë, ia jep-

nin sytë e mëdhenj e të kthjellët që gati s'mbylleshin kurrë.

— Ah, po këto drejka, — tha Semi për gjimnazistet.

— Kush? — pyeti Gjergji.

Ajo ktheu kokën anash dhe ndjeu që u turbullua.

— Kujtova se ishin këtu. Nejse. Do të ikësh pas një ore the? Më prit, të lutem.

Iku me hapa të shpejtë. Orën e parë nuk kishte mësim, por ishte e domosdoshme të ikte. Duhëj të dëbonte nga gjoksi atë furtunë të çmendur zogjsh që po e torturonte. Hyri në shkollë, lëvizi me hapa të shpejtë nëpër korridoret e bardha, hapi dy-tri dyer klasash dhe doli sërish. Mendoi se tani ishte e qetë. Edhe buzëqeshjen e kishte të arsyeshme dhe të mençur, aq sa e lejonte takti. Ah, po, tani ajo kishte një barrë me përvojë. Dhe sa mirë që ishin ndarë para një viti. Tani atij i mbetej vetëm gjysmë ore. Dhe gjatë kësaj kohe ai do të thoshte vetëm tri-katër fjalë, jo më shumë. Ajo shkoi përballë tij. Ndenjën disa çaste pa folur dhe befas Gjergji pa orën.

— Më duhet të iki, — tha.

— Kaq shpejt?!

— Pas dhjetë minutash niset makina.

Ajo ngriti kokën dhe hodhi mbi të një vështrim të vëmendshëm, provokues dhe lutës njëkohësisht.

— Ti gënjen, — tha pas pak, — tani nuk niset asnjë makinë.

— Të betohem, Semi!

Ajo e uli kokën për të ruajtur prej tij të kuqtë përvëlues të fytyrës.

— Ka kohë, — tha.

Kaluan edhe pesë minuta. Gjergji pa sërish orën. Ishte një orë me zinxhir të verdhë që vezullonte sa herë ai lëvizte dorën.

— Semi! — Ai bëri një lëvizje energjike të krahut, dhe ca fasha drite që reflektoheshin nga zinxhiri i verdhë, i ranë në sy si vetëtima.

— Ka kohë, — tha përsëri ajo dhe ndjeu se përqark nuk kishte më ajër. Që përtej supeve të tij shikonte oborrin e shkollës të mbushur me nxënës që lëviznin e shtangnin në mënyrë të çuditshme si të goditur nga një mekje e papritur.

— Semi! Është me të vërtetë një makinë që më pret. Tani duhet të nisem. Unë mund ta arrij.

Ajo prapë heshtte. Më në fund nuk kishte fuqi të thoshte asnjë fjalë. Vetëm ndiente se pamundësia për të folur në këto çaste ishte një mrekulli e vërtetë. Mendonte se gjatë gjithë njohjes së saj me Gjergjin kishte vuajtur armiqësinë e atyre që thoshte pa dëshirën e saj. Dhe më tej akoma mendoi se ky mëngjes me dritë të bollshme diellore nuk qe aspak rastësor. Ajo e kishte kërkuar me këmbënguljen e palodhur të atyre që kërkojnë një thesar. Dhe e kishte gjetur pikërisht në çastin kur i kishin shterur të gjitha forcat për të ecur më tej.

— Tani s'mund të iki dot edhe sikur të dua, — tha Gjergji.

Ajo mori frymë e lehtësuar dhe buzëqeshi lehtë. Tani kishte boll takt. Dhe koha ishte e tëra me të. Dhe e kishte harruar krejt, krejt Gjergjin. Ta zëmë, siç harrohet vetvetja...

DHEMBJE

Xhovani Tarmini ishte i mallëngjyer. Kishte ardhur pas njëzet e pesë vjetësh në Shqipëri. I mbështetur në ndenjësen e makinës, me duart të kryqëzuara në gjoks, vërente si i topitur rrugën që shkiste me shpejtësi, gurët kilometrikë që feksnin dhe vraponin t'i linin vendin njëri-tjetrit, pamjet e largëta malore që hapeshin ngadalë, si gjoksi i një gjiganti të fantazuar dhe ndiente se nuk ishte në gjendje të mendonte asgjë të saktë.

Kishte kërkuar të shkonte në qytetin e vogël N. dhe tani, gjatë udhëtimit për atje, kishte një ndjesi të ndërlikuar dhe romantike, sikur po shkonte drejt një dashurie të largët e të privuar. Emocionet e kishin ndryshuar të tërin dhe ai rrinte drejt, pa lëvizur, që të mos e tradhtonte veten. Xhovani Tarmini, tha, ti po plakesh dhe s'je i zoti t'i durosh ngasjet e forta. U kthye

nga pas, ndeshi në vështrimin pyetës të shoqëruesit të ri në moshë, la një buzëqeshje dhe për sëri e hodhi vështrimin nga malet. Ishte fillim vjeshte dhe malet përthyheshin me hije të mëdha. Xhovani Tarmini kishte qenë një vit në qytetin N., në një garnizon të vogël italian. Pastaj që andej kishte shkuar në çetat partizane. Tani vetëdija e tij po kthjellohej dhe në imagjinatë po i vinin njëra pas tjetrës fytyra nierëzish të njohur që para 25 vjetësh. Të gjithë të rinj, me ca vështrime të rrepta e të vëmendshme. Tarmini i ndalte para sysh, i vështronte për një kohë të gjatë, buzëqeshte dhe i linte të shkonin duke i shoqëruar nga pas me një dhembje të thellë që s'e kishte ndier kurrë më parë.

Ata ishin të gjithë të rinj, kurse ai vetë, mes tyre, ishte kaq sa tani, një burrë i gjatë me pardësy gri, i thinjur, me fytyrën të rrahur nga pesëdhjetë vitet. Ah, po, edhe unë kam qenë dikur sa ata, po pse s'mundem ta kujtoj veten si atëherë, pse? Shoqëruesi u përkul drejt tij.

— Çfarë thatë? — pyeti.

Xhovani Tarmini e pa i habitur e i turpëruar.

— Jo, asgjë, — tha. Pastaj ndenji një hop i menduar. Pyeti me zë të druajtur. — Ju keni qenë në N.?

— Posi, — tha shoqëruesi, — kam qenë disa herë.

— Ashtu? E njihni vallë një mikun tim, Guri... Guri Vrusho, kështu quhet.

— Posi, e njoh.

Xhovani Tarmini u kthye i tëri nga shoqëruesi. Pas një çasti sytë iu zvogëluan nga mallëngjimi.

— Pra e njihni?! Shikoni, unë atë duhet ta takoj patjetër, — tha dhe i erdhi përsëri rëndë kur ndjeu në tingëllimin e zërit të vet një notë lutjeje. Shoqëruesi po e shikonte me vëmendje.

— Më falni, — tha Tarmini, — po jam shumë i tronditur. Unë i detyrohem aq shumë atij djaloshi. Sikur ta dinit! — Shoqëruesi i rrahu shpatullat me intimitet.

— Do ta takojmë patjetër, — tha, — megjithëse tani s'është më djalosh.

— Sigurisht, — psherëtiu Tarmini. — Ndoshta ju duket e çuditshme, por unë s'mund t'i përfytyroj miqtë e mi të dikurshëm veçse si djem e vajza të reja. Më kuptoni?

— Ju kuptoj, ju kuptoj, — tha shoqëruesi.

— Kanë kaluar kaq kohë, — tha Tarmini, — dhe mua më ka marrë malli shumë. Dhe ta dini se ky nuk është një mall i thjeshtë. O, në asnjë mënyrë s'është i thjeshtë. Në njëfarë mënyre, unë vij në këtë qytet të takoj vetveten. Sikur të më kuptonit tamam, — tha Xhovani Tarmini i ngrysur dhe u ra gjunjëve me pëllëmbë, — sikur të më kuptonit tamam! Kam frikë se këto çaste ju mund të mendoni se Xhovani Tarmini është një egoist plak dhe i keq. E kjo ardhje në Shqipëri në muzg të jetës nuk është veçse një trill. Në rast se mendoni kështu, ma thoni. Në dreq të vejë mirësjellja, ma thoni.

— Jo! Unë s'mendoj kështu, — tha shoqëruesi, i ndodhur ngushtë.

— Po çfarë mendoni ju? — pyeti befas me këmbëngulje Xhovani. — Unë dua të di, ç'mendoni ju në këto çaste? Mos vallë ju vjen ndër

mend një pyetje e tillë, p.sh., ç'e ka bërë ky Xhovani Tarmini për 25 vjet me radhë këtë mall që na shet sot! Pra, sikur t'ju vinte ndër mend një pyetje e tillë, ç'më mbetet mua t'ju them?! — Xhovani Tarmini ngeli për një çast në mëdyshje, i mbushur me një keqardhje të madhe për veten. Pastaj uli kokën dhe tha befas me zë të rreptë: — E megjithatë, në rast se mendoni kështu, ma thoni. — Shoqëruesi buzëqeshi. Xhovani Tarmini priste përgjigje.

— Unë s'mendoj aspak kështu, — tha më në fund shoqëruesi dhe nxori nga xhepi i xhaketës paketën me cigare «Arbëria». Ia zgjati mikut duke qeshur. Tjetri e mori me plogështi.

— Ti duhet të më kuptosh, — tha Tarmini duke e thithur tymin e cigares me pangopësi. — Mua s'më ka ndodhur kurrë një gjë e tillë. Një dehje kaq e fortë dhe, si të them, e mrekullueshme, është tamam një privilegj në prag të pesëdhjetë vjetve të mi të ngatërruar.

Heshti një çast, ktheu sytë nga shoqëruesi, vuri re në fytyrën e tij një habi të përmbajtur prej njeriu të sjellshëm dhe mendoi se ky djalos, më shumë se një zyrtar i thjeshtë, ishte dhe një mik i mençur.

— Ardhjen time këtu, — tha pastaj, — unë s'e kisha menduar kurrë të tillë. Ja, kam një muaj në Shqipëri dhe më duket se po jetoj atë pjesë të magjisë që jeta ia jep njeriut me shumë kursim, ose mund të ndodhë që edhe të mos ia japë fare. Më kuptoni?

— Posi, — tha shoqëruesi, — mua më vjen mirë që ju flisni kështu për vendin tim.

Xhovani Tarmini uli kokën i menduar.

— Vendi juaj, — tha me zë ëndërrimtar. —
Po në Itali keni qenë?

— Jo.

— Gjynah! Është vend i mrekullueshëm dhe, si të them, si të them... — nuk mundi ta shpreh-te atë që donte të thoshte dhe e pa tjetrin me sy prej fajtori. — Por unë jam sicilian, nga Taormina, — tha si e mblodhi veten. — Sicilia. E keni dëgjuar? Vendi i mistereve, i hakmarrjes dhe... i bukur si një margaritar. Por unë tani jam në Shqipëri dhe s'ka çast të mos e pyes veten i alarmuar: ç'ke bërë ti, Xhovani Tarmini, ç'ke bërë për ta merituar vendin tënd? Unë këtë shqetësim nuk e kam ndier kurrë atje në Taormina, në zyrat e një firme të vogël e të vjetër sa bota. Kurse gjëja e parë që vë re te të gjithë shqiptarët që takoj, është pikërisht fakti se ata nuk i mundon një gjë e tillë. — Shoqëruesi ishte mbështetur i tëri në ndenjësen e pasme të makinës dhe e dëgjonte i përqendruar. Shoferi kthe-nte kokën herë pas here nga të dy dhe buzë-queshte.

— Të lodha, — tha Tarmini, — një i mo-shuar është gjithmonë i vështirë për rrugë të gjata.

— Jo. Në asnjë mënyrë, — kundërshtoi sho-qëruesi me energji.

Tarmini u kthye përpara, kryqëzoi sërish duart në gjoks dhe u lëshua në pozicion dre-mitjeje... Pepino Sardini, tha me vete. Pepino Sardini, or maskara i madh! Si nëpër mjegull i erdhi ndër mend një natë e ftohtë në Parmë, vite më parë. Rrinin në një lokal të madh e të shtrenjtë, përballë njëri-tjetrit, dhe pinin ko-

jo pa qëllim
evendos autor
dhe propo-
gandën
reaksiounë
të tij

njak «Karlos Primero». Ai i kishte thënë se donte të shkonte në Shqipëri dhe e ftonte të venin bashkë, kurse Sardini kishte qeshur me të madhe dhe kishte hedhur një rën pas tjetrës dy gota me konjak. Të përshëndes, o mik, që paske mbetur kaq naiv, i kishte thënë. Kjo është kaq e rrallë në kohën tonë, sa ç'është i rrallë një sicilian që vjen të marrë mendje në Parmë. Të qoftë udha mbarë, veç dije mirë se, sa të zbresësh nga avioni, do të të rrethojnë një gardh policësh dhe pastaj edhe ajrin që do të thithësh do ta marrësh vetëm me lejen e tyre. Ata ishin grindur për një kohë të gjatë dhe ai, sado që nuk i kishte besuar ato që i kishte thënë Sardini... Tani Tarmini rrinte i menduar, merrte frymë me zor dhe ndiente t'i përvëlonte fytyra e t'i mbushej trupi me djersë të nxehta nga turpi i asaj nate.

* * *

Në qytetin N. arritën në të perënduar të diellit. U rregulluan në hotel dhe pas gjysmë ore Tarmini kërkoi të dilnin jashtë. Qyteti ishte i vogël, i pjerrët, me një gjelbërim të dendur në skajet, që dukej sikur lëvizte me hapa të qetë e të padukshëm drejt qendrës. Ishte diçka magjepsëse ta lije veten në krahët e këtij iluzioni dhe Tarmini nuk bëri asnjë përpjekje për të kundërtën. Shikonte në heshtje, i druajtur e i rrudhur nga mallëngjimi. La qendrën dhe hyri në rrugicat me kalldrëm, që të çonin në pjesën e vjetër të qytetit.

— Ku po shkojmë? — pyeti shoqëruesi.

— Shët! — Tarmini vuri gishtin tregues në buzë. — Ejani pas meje, ju lutem!

Shoqëruesi shpejtoi hapat dhe i doli për-krah. Në bërrylin e një rruge të ngushtë Tarmini ndali. Rrinte i mekur si përpara një magjie. Shoqëruesi e kapi nga supet i shqetësuar.

— Ç'keni kështu? — tha.

Tjetri u shkund, buzëqeshi, i doli djalosht përpara dhe tha me një zë që i dridhej nga emocionet:

— Dëgjoni. Po të hapet kjo portë, do të dalin përballë gjashtë shkallë të vogla guri, pastaj një rrugicë e veshur me trëndafila dhe rozmarinë, që të çon në një shtëpi dykatëshe.

— Unë nuk e di këtë, — tha shoqëruesi.

— Ju s'e dini, kurse unë e di shumë mirë, — tha Tarmini. — Në këtë shtëpi kam qëndruar për një kohë të gjatë i sëmurë. Unë u sëmura në mal, dhe ai, Guri, më pruri këtu, te nëna e tij plakë. Unë rri e mendohem gjithnjë për atë kohë dhe rrah të gjej se ç'mund të bënte më shumë ajo grua për të birin! Tani ajo s'është më dhe unë vij këtu pas 25 vjetve, — tha ai me fytyrën të shtrembëruar nga dhe- mbja.

— A të trokasim në këtë portë? — pyeti Tarmini pas pak, duke e parë tjetrin me vështrim lutës.

— Posi.

— Ai jeton ende këtu. Edhe këtë e di. Para një viti kemi shkëmbyer letra. Të trokas? — Ai qe i druajtur si një fëmijë.

— Trokitni, trokitni, — tha shoqëruesi.

Xhovani kapi dorezën e hekurt dhe e kër-
citi fort. Pastaj e hoqi dorën, psherëtiu, i buzë-
qeshi shoqëruesit me mirënjohje dhe priti me
kokën ulur. Porta u hap shpejt. Në prag të saj
doli një vajzë e re me uniformë shkolle.

— Urdhëroni! — tha ajo me një pamje të
druajtur e buzagaz.

Xhovani Tarmini u afrua pranë saj.

— O zot! — tha ai duke e kapur vajzën nga
supet. — Po si të hyjmë? A e di ti kush jemi
ne? — Vajza buzëqeshi edhe më dhe ua qepi
sytë të panjohurve me kureshtje.

— Po urdhëroni, — tha ajo.

— Si kështu, — tha Xhovani Tarmini pa
lëvizur nga vendi. Shprehja e fytyrës së tij të
tronditur e shtangu vajzën në vend.

— Po ç't'ju them unë, — tha ajo duke kër-
kuar ndihmë nga shoqëruesi, — kë kërkoni?

Nga shtëpia u dëgjua një zë burri.

— Vjollca! Kush është?

Vajza ktneu kokën, u mat të thoshte diçka,
pastaj heshti.

— Vjollca! — foli përsëri zëri.

Xhovani Tarmini u mbështet fort pas sho-
qëruesit. Mendoi në këto çaste se mund të rrë-
zohej përtokë. Burri që foli, po vinte drejt tyre
me hapa të lehtë. Me duart në bel, ai ecte
disi duke u lëkundur. Ndenji për një çast në
krye të shkallëve, hoqi duart nga beli, buzë-
qeshi me mirësjellje dhe pastaj tha me një zë
të trashë prej basi:

— Ejani, o miq, ejani! Pse rrini aty? Hyni
brenda!

Xhovani Tarmini i doli përballë. Burri i

hapi rrugën dhe, duke i bërë shenjë me të dyja duart, e ftoi të hynte brenda.

Xhovani Tarmini i kapi dorën lehtë dhe, pa e parë, pa i folur të zotit të shtëpisë, u nis hapngadalë drejt hyrjes. Ecte drejt, i heshtur, i ngrirë, sikur të qe në ëndërr. I zoti i shtëpisë pa nga shoqëruesi me vështrim pyetës.

— Lëreni, ju lutem, — tha shoqëruesi, — mos i flisni!

Xhovani Tarmini qëndroi përballë derës së shtëpisë, pastaj u kthye te njëri nga sofatët e hyrjes, e përkëdheli me duar dhe, gjithmonë si në një ëndërr të thellë, shkoi dhe u ndal në një tufë rozmarinash. U përkul mbi to me supet që i dridheshin nga ngashërimi, këputi një degë dhe me të në gjoks shkoi e u ul në sofa. Ndenji për një çast me pamje të çmeritur, të ngrirë e ëndërrimtare, sikur të sodiste një vizion që u shfaq papritur. Pastaj e shkundi kokën me forcë dhe në fytyrë iu end një dëshpërim që kërkon ndjesë, një pikëllim i pamëshirshëm që ta shqyen gjoksin si kthetrat e një bishe... Dhe sërish i doli përpara pamja tallëse e Pepino Sardinit me flokët e rrallë ngritur përpjete dhe me fytyrën të skuqur si mëlçi nga konjaku i tepërt. Ej, Pepe! Kemi lënë një pjesë të rinisë në atë vend, ndoshta më të bukurën, i kishte thënë Tarmini. Shko, or mik, shko! Sardini kishte mbushur gojën sërish me konjak, e kishte rrotulluar nëpër gojë një kohë të gjatë, pastaj kishte qeshur me klithma: «Po qe se të është rënduar vetja, shko, se ke ende diçka për të lënë. Kurse mua më kanë mbetur akoma aq tru, sa për të mos bërë marrëzira të

tilla»... Pastaj Xhovani Tarmini u ngrit, e vuri tufën me rozmarina në krye të sofasë, sikur ta vinte në kokën e një varri dhe filloi ta lëmonte me një prekje plot ankth e maraz, si një njeri që ka ardhur tepër vonë... tepër vonë. Në këto çaste ai e shihte veten të dyzuar. Njëra pjesë ishte e njeriut të ri, energjik, po që tani ishte kthyer në hije me një tufë rozmarinash mbi kokë, kurse tjetra, e lodhur, e nemitur, rrinte pranë tij e pafuqishme për të ndrequr gjë nga humbja. Midis tyre pajtimi vinte tepër ngadalë dhe Xhovani Tarmanit iu njomën sytë nga lotët e nxehtë. «Si të besova, Pepe Sardini?» — pëshpëriti. Shoqëruesi vrapoi drejt tij me hapa të shpejtë dhe i foli me guximin intim që mund t'i flitet një të vogli.

— Ç'bëni kështu?! Nuk është mirë!

Tarmini pa nga ai për një çast me sy akuzues.

— A nuk ju thashë, nuk ju thashë?

Shoqëruesi nuk e kuptoi se ç'donte të thoshte tjetri me ato fjalë. Më tepër se atij, këto çaste Tarmini i drejtohej vetes. Dhe tani, jo vetëm sytë, por tërë pamja tregonte se ai, Xhovani Tarmini, ishte singerisht në armiçësi me vetveten. Shoqëruesit i erdhi keq për të. Ai u bëri shenjë vajzës dhe burrit që të afroheshin...

KU ISHIN NJERËZIT?!...

Shtëpia jonë ishte në mes të fshatit, anës një përroi të thellë e të thyer, që dimrit vinte me gjënim të llahtarshëm e kërcënues si përbindësh. Unë isha tepër i vogël për të kuptuar se bota ishte më e madhe se fshati ynë dhe se shtëpia jonë e vjetër, me gurë të tymosur e me trarë të shtrembër, që nëpër netët e gjata të dimrit kërcitnin me një zhurmë të mbytur e të frikshme dhe më turbullonin ëndrrat e bardha të fëmijërisë. Gjyshja ishte një grua e gjatë, me flokë të dendur dhe krejt të bardhë. Mbante një fustan të zi e të gjerë deri në fund të këmbëve dhe qëndronte me trupin drejt si plepat e bardhë buzë arave të fshatit. Në fytyrë s'kishte asnjë rrudhë dhe unë s'kam parë kurrë në jetën time pleqëri më të bukur dhe më të pastër se atë të sajën. E doja atë mbi gjithçka, me një dashuri që ma gufonte gjoksin dhe shpesh kthehej

në qëllimin e vetëm të jetës sime prej fëmije. Pushteti i gjyshes ishte pushteti i parë me të cilin unë rashë në kontakt dhe mendoja se në botë nuk do të kishte asnjë lloj brengje dhe dhe mbje, sikur ajo të drejtohej sipas logjikës së këtij pushteti. Babai ishte i gjatë dhe i bukur si gjyshja dhe çastet kur ai rrinte përballë saj i qetë, i urtë, fjalëpak dhe i nënshtruar, kanë genë për mua çaste të një mrekullie të pashpjegueshme. Ndoshta një gjë e tillë ndodhte ngaqë ai ishte pak i vrazhdë me ne, dhe unë e kisha frikë. Gjyshja e quante tim atë *bir*, ashtu sikurse më quante edhe mua e kjo ishte një ngatërresë që s'më linte të qetë. Më vonë unë mora vesh se babai që djali i vërtetë i gjyshes, kurse unë kisha për nënë një grua tjetër, një grua me fytyrë të qeshur, me sy të mëdhenj, pak të trishtuar, një grua me gërsheta të gjatë deri në bel, që lëvizte nëpër shtëpi vetëm për një kohë të shkurtër si ëndrrat, pastaj zhdukej gjithë ditën s'di se ku. Kjo e vërtetë nuk më trishtoi aspak, përkundrazi. Por s'di se si në jetën time u shfaq papritur, si një kërcënim, një njeri i tmerrshëm. Ky ishte plaku Babo, një plak i lashtë, i rrudhosur, me mustaqe të trasha e të gjata deri te veshët dhe me fytyrë të ngrysur e të madhe. Mbante vazhdimisht në gojë, një llullë të zezë e të ndritshme dhe një shkop të trashë të veshur me teneqe të praruar. Ai vinte vazhdimisht te ne dhe unë habitesha e brengosesha që gjyshja gëzohej porsa e shikonte. Më vonë mora vesh se ai ishte miku më i ngushtë i gjyshit, që s'ishte më. Porsa dukej ai te porta e shtëpisë, gjithçka qetësohej e

ngurosej si me magji. Unë kisha vënë re se edhe nëna ime druhej e turbullohej lehtë nga plaku Babo. Ai hynte brenda i qetë, me hapa të shkurtër e të plogët dhe shkonte e ulej pa folur në një minder të vogël. Pas tij, e ngazëllyer, në heshtje, shkonte dhe rrinte përballë gjyshja. Plaku Babo mbushte çibukun me duhan, merrte një thëngjill me dorë nga vatra dhe, pasi e vinte mbi çibuk, fillonte të pyeste:

— Mirë të gjithë?

— Mirë, mirë.

— Mirë nusja, djali, fëmijët?

— Mirë, mirë, — përgjigjej gjyshja e kënaqur.

Unë prisja me frikë radhën time dhe ajo s'vononte të vinte. Pasi rrinte për një kohë të gjatë me kokën kërrusur mbi shpatulla, befas plaku Babo ngrinte sytë mbi oxhak, përdridhte mustaqet e mëdha me njëfarë nervozizmi të lehtë, shikonte nga unë i habitur, lëvizte vetullat e trasha që ngjanin si gjysma mustaqesh mbi sy dhe pyeste për mua.

— Po ky, kush është?

— Ky është Kola, — përgjigjej gjyshja duke buzëqeshur.

— Nuk e kam parë ndonjëherë.

Këto fjalë më bënë fatkeq dhe në çast doja të ngrihesha, të kundërshtoja, të klithja, të thosha se kisha qenë përherë në këtë shtëpi, se ai, plaku Babo, më kishte parë gjithmonë, po nuk guxoja.

— Çudi, si s'e kam vënë re, — thoshte.

— Ah, po ai s'vihet re, se është djalë shumë i urtë, — thoshte gjyshja.

— Ka bërë ndonjë faj sot? — pyeste i ngrysur plaku.

— Çne, — përgjigjej gjyshja. — Ku di Kola ynë të bëjë faje.

Plaku Babo nuk besonte. Ai ngrysej më tepër dhe ma bënte me shenjë t'i afrohesha. Ky ishte çasti më i rrezikshëm. Ai i bënte duart e holla e të rreshkura grusht dhe i vendoste në ballë si dylbi. Pas kësaj fillonte të vrojtonte dhe të gjen-te në trupin tim gabimet që mund të kisha bërë. Dylbitë afroheshin në kokë, në duar, në flokë, deri në mollëzat e gishtërinjve. Unë rrija si në ethe. Kurse gjyshja më shikonte e merakosur. Kur mbaronte vrojtimin, plaku psherëtinte, i hapte duart dhe fërkonte mustaqet me pakënaqësi, sikur porsa të kishte ndodhur një hata.

— Paska bërë tri faje të rënda, — i thosh-te gjyshes me zë solemn, — e di ç'do të thotë të bësh tri faje?

— Po kur i bëri tri fajet? — pyeste gjyshja e merakosur.

— Tri, thonë dylbitë. Pa të shoh edhe një herë.

Por unë nuk dëshiroja kurrsesi që plaku Babo të niste sërish vrojtimin e tij mizor. Ato dylbi të pamëshirshme mund të më gjenin gabime të tjera.

— Jo, — thosha gati me klithmë, — mos shiko më me dylbi. Vetëm tri faje kam bërë.

Atëherë ai ulte duart përfundimisht mbi pre-hër, ia ngulte sytë i menduar prushit të zjarrit dhe heshte për një kohë të gjatë.

— Ti, që quhesh Kola, — thoshte pas pak

me një zë që dridhej në mënyrë misterioze, — numëro fajet që ke bërë!

Unë, që quhesha Kola, porsa dëgjoja numrin e fajeve që më kishin gjetur dylbitë e plakut Babo, sillja ndër mend ç'kisha bërë gjatë ditës dhe përgatitesha t'ia tregoja. S'më shkonte kurrë ndër mend të gënjeja.

— I kam shkukur flokët Malisë.

— Një, — thoshte plaku Babo me kokën ulur dhe ngrinte përpjetë gishtin tregues.

— Piva qumësht në vedër.

— Dy.

— Kafshova Lilin.

— Tri.

Pas singëritetit tim vinte dënimi. Plaku Babo më urdhëronte të rrija në qoshe të shtëpisë me një këmbë dhe fillonte të numëronte në mënyrë të ngatërruar 10, 9, 8, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1, 3, 4, 17, 19, 25, 27, 3, ... Përgjithësisht dënimi varej nga numri i fajeve megjithatë ai rrallë i kalonte të dy minutat...:

I vetmi njeri që s'çante kokë nga plaku Babo qe Lili, vëllai im i vogël dyvjeçar. Ai afrohej zvarrë-zvarrë tërë guxim e trimëri, hipte në prehërin e plakut dhe, duke qeshur e duke belbëzuar fjalë pa kuptim, i hidhte duart mbi mustaqet e trasha. Në fillim unë dridhesha, shtan-gesha, prisja të ndodhnin gjëra të tmerrshme, të binte tërmet, të thyheshin trarët, të na binin mbi kokë pllakat e gurta të shtëpisë, po nga të gjitha këto s'ndodhte asgjë.....

Kur ikte plaku Babo, gjyshja ngrihej në këmbë, i dilte përpara me trupin disi të përkulur dhe i lutej të rrinte dhe ca. Këto ishin të vet-

met raste kur unë e merrja inat gjyshen time të urtë e të mirë.

Fshati ynë ishte në formën e një govate të madhe, në buzën perëndimore të së cilës ngrihej një shtëpi e vogël dykatëshe me portë llamarine. Në këtë shtëpi të dashur, me oborr të mbushur me pjergulla, trëndafila e borzilok, jetonte hallë Kristina. Ajo vinte shumë rrallë në shtëpinë tonë, kurse unë shkoja vazhdimisht atje. Porsa më shikonte, ajo më pushtonte në krahë e më çonte pranë një muslluku të madh, më lante, më pastronte dhe me një dëshirë që nuk iu resht kurrë më krihte flokët. Kishte raste që ajo edhe qante mbi flokët e mi. Hallë Kristina ishte grindur rëndë me babanë dhe ai nuk donte ta shikonte në shtëpi. Te hallë Kristina jetohej disi më mirë se te ne. Të paktën atje kishte gjithmonë diçka për të ngrënë e për të marrë me vete. Porsa ikja nga hallë Kristina, unë dilja në bregun e fshatit prej nga dukej shtëpia jonë dhe flisja me zë të lartë:

— Gjyshe, gjyshe, moj!

Gjyshja dilte në divan.

— Më dha hallë Kristina përshesh me dhallë.

Gjyshja diçka thoshte, po zëri i saj s'arrinte dot deri në breg.

— Më ka dhënë hallë Kristina një kungull për lakror. — Unë i tregoja që nga bregu të gjitha ç'kisha biseduar me hallë Kristinën, tërë pyetjet që më kishte bërë, apo i kisha bërë dhe këto muhabete i merrte vesh tërë fshati. Kur mbaroja, zbritja poshtë i lodhur, i djersitur e fitimtar, me kungull në dorë.

Në shtëpi s'kisha ç'të tregoja më. Gjyshja

më afronte pranë, ma fuste kokën në gjoks dhe me zë të merakosur e të pikëlluar më thoshte:

— Mos qe e mërzitur Kristina?

— Jo, — përgjigjesha unë pa u menduar. — Ajo qeshte.

Në të vërtetë unë as që e vija re nëse ishte e qeshur apo e mërzitur hallë Kristina.

Fëmijëria ime mban mend vetëm njerëz të ngrysur, të dëshpëruar e të heshtur. Njerëzit e qeshur ishin të rrallë, siç ishin të rrallë lejkët që fluturonin mbi fshat vetëm për pak kohë në muajin gusht. Dhe ja, mes këtyre të paktëve sjell ndër mend mendjeturbulluarin Koto Plepi, një plāk të vogël e të hollë si dordolec. Në fytyrën e murrët si qiramidhe e pjekur kishte dy sy të vegjël, të qeshur, të ndritshëm si kopsa, që s'i mbante kurrë në një vend. Ai vinte shpesh te ne, hapte portën me të dyja duart, futej brenda në majë të gishtërinjve si komplotist dhe shkonte rrinte përballë gjyshes me një ndjesi shpartallimi, që ia bënte më të dhimbshëm e më të venitur fatin e keq. Për gjyshen kishte një ndjenjë të trazuar pasigurie e adhurimi bashkë. Ngrinte sytë në drejtim të saj, i buzëqeshte me druajtje si fëmijë dhe i lutej me përgjërime që ta linte të rrinte te shkallët. Por, sa i jepej leja, ai shkonte te shkallët me një vrap komik, ulej këmbëkryq dhe fërkonte duart e vogla e skeletore i lumtur, sikur kishte zënë qiellin e shtatë.

Pasi rrinte kështu për disa çaste, ngrihej befas me vrull, shkundte krahët sikur do të fluturonte dhe i drejtohej gjyshes përsëri me zë lutës:

— Të qesh një çikë?

Përgjigjen e gjyshes e priste i tkurrur, i alar-
muar, sikur prej saj të varej tërë fati i jetës
së tij.

— Po qesh, — i thoshte gjyshja, — s'bëhet
kiameti.

Atëherë ai fillonte të qeshte për një kohë të
gjatë. Lëshonte ca hihira të mprehta e të thata
që gjyshen e dëshpëronin pa kufi, kurse mua
më bënë të papërmbajtur. Zakonisht pas tij fi-
lloja të qeshja dhe unë me të madhe. Kjo
gjë e kënaqte atë në mënyrë të jashtëzakonshme
dhe bëhej ujë në djersë nga mundimi i ngër-
dheshjes së fytyrës së vogël dhe lëvizjeve të pa-
reshtura të duarve e të këmbëve. Pasi traska-
pitej për një kohë të gjatë kështu, heshte krejt
papritur dhe largohej në majë të gishtave pa
thënë asgjë. Shkonte të qeshte nëpër shtëpi të
tjera.

Pastaj unë shkova në shkollë për katër vjet
dhe pas kësaj përfytyrimi im për jetën e për
njerëzit u bë më i qartë e më i rëndë. E që-
ruar nga ajo mjegulla e trashë e vështimit naiv
fëmijëror, jeta po merrte para syve të mi dome-
thënien e saj tmerrësisht të vërtetë...

*
*
*

Babai ka qenë për mua vazhdimisht një qe-
nie e ndërlikuar, që më shfaqet para sysh me
buzëqeshjen e njerëzve të braktisur nga të gji-
tha mundësitë. Ai punonte në qytet dhe në

shtëpi vinte rrallë. Më kujtohet se si nëna dhe gjyshja, porsa hynte ai, gjallëroheshin, lëviznin nëpër shtëpi me një ndjenjë kujdesi dhe lumturie të veçantë, kurse ai rrinte si i huaj dhe në fytyrën e ashpër e burrërore i mpiksej një ndjenjë e rëndë faji, që e bënte shpesh të psherë-tinte dhe të vështronte nga dritarja për të mos ndeshur me vështrimet e grave. Kjo ndjenjë e përvuajtur dhe e përhershme krijonte një lidhje organike dhe me mënyrën e të veshurit të tij, me ngjyrën kafe të pantallonave dhe me xhakëtën gri, me mënyrën si ecte, si e merrte Lilin nëpër duar, me mënyrën si buzëqeshte dhe si e shikonte nënën kur ajo merrej me punë shtëpie dhe nuk e kishte mendjen aty.

Një ditë ai erdhi në shtëpi më i ngrysur se herët e tjera dhe midis tij, nënës dhe gjyshes filluan të bëheshin ca biseda të zgjatura e të pikëlluara. Pas kësaj nëna shkoi në plevicë, u përplas përdhe, i ra barit disa herë me duart e bëra grusht, rënkoi me duf dhe qau për një kohë të gjatë me ngashërim dhe me zë. Unë qëndroja në oborr i shtangur, duke parë nënën që lebetitej mbi sanën e thatë dhe isha gati të shpërtheja në dënësë, kur befas nëna u ngrit, fshiu fytyrën me shami dhe doli nga plevica, e qetë dhe e sigurt, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Unë qëndroja në vend i shtangur.

— Ç'bën aty? — më pyeti nëna.

— Përse qaje ti në plevicë?

— Jo, — tha nëna e habitur, — nuk qaja.

— Ti qaje, — thashë i dëshpëruar.

— Ah, — psherëtiu ajo dhe më shtrëngoi fort në gjoks, — jo, Kola, jo, ti nuk ke parë asgjë.

Unë heshtja.. Ç'lumturi ishte që jeta të kalonte kështu pa fund, e ngrohtë, e dhembshur, plot drithërima dhe magjepsje si në gjoks të nënës.

— Ti s'ke për t'u thënë asgjë gjyshes dhe babait, hə, Kola?

— Jo, — thashë unë, — jo, s'kam për t'i thënë kurrë njeriu.

U futëm brenda. Babi grinte duhan i menduar. Kur hymë ne, e la për një çast punën, fërkoj ballin me dëshpërim dhe filloi të shikonte nga nëna. Ajo sillej përçark si ëndërr, e hutuar, e papërqëndruar, e lodhur dhe bënte ca punë që s'kishin fare lidhje me atë që ndoshta donte të bënte në të vërtetë. Mbushte një kanë me ujë dhe papritur shkonte me të në musandren e rrobave. Aty rrinte për një kohë të gjatë dhe mendohej të sillte ndër mend se pse i duhej në të vërtetë kana me ujë. Ose shkonte në dollap, e hapte, rregullonte aty ndonjë gjë të rëstit dhe e mbyllte prapë, pa iu kujtuar se përse kishte vajtur aty dhe ç'duhej të mernte. Babai e shikonte dhe ulte sytë përdhe. Po atë mbrëmje erdhën te ne shumë njerëz. Midis tyre ishte dhe plaku Babo, tashmë krejt i zbardhur e i rrudhur, me mustaqe të gjata e të trasha që dukej sikur i kishin zënë ndryshk nga tymi i duhanit. Kishte kohë që frika nga plaku Babo më qe qetësuar dhe ia kishte lënë vendin njëfarë pa sigurie dhe druajtjeje, sepse plaku Babo, sa herë që vinte në shtëpi, niste dhe tregonte ca ëndrra misterioze, në qendër të të cilave ishte ai dhe një njeri i panjohur, që shkonte dhe i parathoshte të gjitha gjërat që do të ndodhnin

në botë. Plaku Babo fliste si i përgjumur për një vend të largët, me emra të ngatërruar qytetesh dhe njerëzish, ku kishte qenë për një kohë të gjatë në rininë e vet të largët me tim gjysh dhe ku tani do të shkonte dhe im atë me «pampor». Burrat e tjerë dëgjonin si të topitur dhe herë pas here e ndërpritnin plakun Babo me pyetje të ndryshme, që e bënë atë të heshte për një kohë të gjatë, t'ia qepte sytë prushit të vatrës, të ndizte llullën e trashë dhe të përgjigjej me një plogështi që kërkonte durim të madh për t'u përballuar. Babai dëgjonte i papërqendruar, me atë buzëqeshjen e përhershme prej fajtori që u rëndonte të gjithëve në gjoks si shkëmb. Dikush tha se pampori ishte ku e ku më i madh se shtëpitë e Qirjako agait. Në të mund të futej brenda gjithë fshati, me njerëz e me gjë të gjallë dhe përsëri të kishte aq vend të lirë, sa të futej brenda dhe një fshat tjetër po kaq i madh. Unë dëgjoja i mrekulluar dhe në fantazinë time pampori mori trajtën e një kali gjigant, sa një kreshhtë malore, që shkiste mbi ujëra duke turfilluar me lemeri e duke nxjerrë nga goja flakë zjarri të përbindëshme si kuçedrat e përrallave. Njerëzit ngjiteshin mbi të me litarë të gjatë e të trashë si trarë dhe humbisnin mbi kurrizin e tij si mizat në rërë. Befas biseda e burrave ngriu në vend sikur mbi të kishte fryrë një thëllim. Dikush tha se kishte ardhur hallë Kristina. Të gjitha vështrimet ishin ngulur plot ankth në drejtim të babait.

Nëna kishte hapur sytë e zez e të mëdhenj dhe shikonte me lutje e përgjërim, kurse gjy-

shja ishte ngritur papritur më këmbë, kishte kryqëzuar duart në gjoks dhe rrinte në mes të shtëpisë sikur priste të ndodhte një gjëmë e madhe. Babai kishte ulur fytyrën e ngrysur mbi gjoks dhe kafshonte cepin e buzëve me nervozizëm.

— Ka ardhur Kristina, — tha gjyshja pas pak me zë të mekur. Babai ngriti kokën lart sikur ta kishin qëlluar pas shpine, pa i habitur e i alarmuar përçark, pastaj e uli përsëri kokën mbi gjoks me dëshpërim dhe pas kësaj heshtja u bë e rëndë si plumb. Heshtjen e prishi plaku Babo.

— Nuk bën ta lësh motrën me një peng të tillë, — tha ai duke shtrirë me gishtin e madh e të verdhë mustaqet e trasha, — ku i dihet...

Fjala i mbeti në grykë, u mek nga ngashërimi dhe përplasi llullën në gurin e oxhakut.

— Jetë qeni, — klithi papritur Cule Vakoja, një kushëri i afërt i nënës, jashtëzakonisht i gjatë e i fuqishëm. Sa herë e shikoja, më jepte përshtypjen se po vazhdonte të zgjatej e të zgjatej pa pushim. Ky njeri, me një fytyrë përherë të shqetësuar nga një zemërim naiv si prej fëmije, më dukej se kishte ardhur në botë për të mos u kënaqur kurrë dhe për t'u mahnitur nga fjalët e mençura të plakut Babo. Sa herë që fliste plaku Babo, fytyra e tij lulëzonte nga kënaqësia dhe koka e tij e madhe dhe plot flokë, si çerdhe lejlekësh, lëvizte lart e poshtë me vrull në shenjë miratimi. Tani ai shikonte i alarmuar.

— Le të vijë, — tha pas pak babai pa iu drejtuar askujt dhe pa e ngritur kokën lart.

Hallë Kristina hyri e druajtur. Ishte hera e

parë që vinte në shtëpi kur aty ndodhej babai. I takoi të gjithë njerëzit me radhë, pastaj shkoi e ndenji për disa çaste e palëvizur përballë tij. Ishte skuqur krejt në fytyrë dhe dridhej. Babai vazhdonte të rrinte kokulur. Hallë Kristina pa për një çast nga gjyshja, pastaj u ul pranë babait. Gërsheti i saj i gjatë, ngjyrë ari, e preku tim atë lehtë mbi sup dhe ai u drodh e u shkund sikur të qe zgjuar nga një ëndërr e keqe. Hallë Kristina ngjeshi kokën në gjoksin e tij si fëmijë dhe ndenji ashtu për një kohë të gjatë duke u dridhur. Hallë Kristina ishte për mua mrekullia e vërtetë, magjia e përrallave, e Bukura e Dheut që rrinte buzë ujërave apo në thellësinë e pyjeve të dendura dhe vuante pareshtur nga një shtrigane mizore që ia bënte jetën të pikëlluar e të mundimshme.

Edhe për gjyshen, e Bukura e Dheut kishte gjithmonë një fytyrë të bardhë e të pastër si mermer, një gërshet të gjatë deri në bel, sy të shkruar me qerpikë të gjatë si të hallë Kristinës. Pas pak babai ngriti kokën, i buzëqeshi gjyshes, pastaj nënës, pastaj të gjithëve dhe tha, duke qeshur e duke mbështjellë me pëllëmbën e tij të madhe kokën me flokë të dendur e të shpupuritur të hallë Kristinës:

— E, mjaft de, mjaft!

Hallë Kristina hoqi kokën nga gjoksi i tij, e pa atë për një kohë të gjatë me dëshpërim e dhembje dhe doli me vrull përjashta. Pas saj dolën dhe nëna me gjyshen.

Njerëzit e ardhur u larguan shpejt. Mbetëm vetëm ne dhe hallë Kristina, që tani ishte qetësuar disi dhe e shikonte babanë me dhemb-

shuri e mirënjohje të pafund. Babai na mori pranë vetes mua dhe Lilin dhe ndërkaq u jep-te porosi të shumta nënës dhe gjyshes; u prem-tonte se do të kthehej shpejt, se s'do t'i ha-rronte kurrë, se do t'u dërgonte letra e të holla, kështu që ato as që duhej të ligështoheshin e të bëheshin merak.

Herë pas here ai e ndërpriste bisedën, rrëm-bente me të dyja duart Lilin, që shqyhej gazit, e ngrinte lart dhe e puthte me pangopësi në fy-tyrë, në gjoks, bark, në pulpat e këmbëve, ku të mundtë. Lili klithte, qeshte, lëvizte duart si-kur voziste dhe babai mekej e drithërohej nga lumturia.

Pastaj ai bënte një mundim gati titanik për ta lënë Lilin mënjanë dhe vazhdonte përsëri të jepte porosi dhe këshilla pa fund... Nëna e dëgjonte sikur të qe në ëndërr, sikur ai fliste diku nga thellësitë e humnerave. Herë-herë ajo s'e kishte mendjen aty dhe pyeste papritur:

— Çfarë? Çfarë?

Babai buzëqeshte lehtë, kurse hallë Kristina dhe gjyshja ulnin sytë përdhe me dhembje. Të nesërmen babai dhe dy burra të tjerë do të iknin.

Kishte dalë t'i përcillte gjithë fshati. Babai doli nga shtëpia me Lilin për dore. Hallë Kristi-na mbante në duar një valixhe dërrase ngjyrë gri. Pas tyre venim unë, gjyshja dhe nëna. Gru-mbulli i madh i njerëzve qëndroi pranë një she-shi të vogël, në fund të shtëpive të fshatit. Babai dhe dy burrat e tjerë filluan të për-shëndeteshin me njerëzit duke pëshpëritur në buzë fjalë të mekura. Pasi u takua me të gji-thë, babai erdhi pranë nesh. Brenda pak ças-

tesh fytyra e tij ishte transformuar, ishte zbardhur e venitur sikur prej saj të kishte rrjedhur tërë lëngu i jetës. Gjyshja e shikonte e heshtur. Ai shkopsiti fustanin e saj në gjoks dhe futi në të fytyrën duke regëtirë e duke u dridhur si fëmijë. Qëndroi ashtu për disa sekonda. Njerëzit përqark, të shpartalluar nga dhembja, me një ndjenjë braktisjeje dhe faji, ulën kokat përdhe duke mërmëritur. Hallë Kristina rrinte pa lëvizur, drejt, e ngurtësuar. Nga gropat e syve i rridhnin rrëke të gjata lotësh. Unë u afrova pranë nënës dhe e kapa fort nga duart. Duart e saj ishin të ftohta si copa akulli. Mua nuk më vuri re. Babai e hoqi kokën nga gjoksi i gjyshes, na përqafoi dhe ne të tjerët me mall, mori valixhen nga duart e hallë Kristinës, që vazhdonte të rrinte e ngrirë si statujë dhe, pasi tha edhe një herë me zë të drithëruar, sikur fliste për herë të parë, «mirupjekshim», u largua me hapa të shpejtë, pa e kthyer kokën pas. Gjithë njerëzit ndenjën aty pa lëvizur për një kohë të gjatë. derisa mërgimtarët u zhdukën pas një kthese që e fuste rrugën në një grykë mali me erëra të ftohta. Vigani i revoltuar Cule Vako ngriti grushtin lart, mallkoi me zërin e tij si bubullimë dhe i ra gjoksit me grusht sikur do ta çante.

Pas ikjes së babait jeta në shtëpinë tonë u bë shumë e trishtuar. Nëna rrinte si e huaj dhe unë vija re se si gjyshja ndiqte çdo lëvizje të saj me sy të merakosur. Ajo niste dhe e qetësonte, i thoshte se duhej duruar, se babai do të kthehej nga ai vend i mallkuar dhe se jeta jonë do të ndryshonte. Edhe nëna bëhej përpara saj si fëmijë. I afrohej, e vinte kokën në gjoksin e

gjyshes dhe dëgjonte e mahnitur me dhjetëra e dhjetëra ngjarje të gëzueshme, që kishin të bënin kryesisht me fëmijërinë prej çapkëni të tim eti. Unë nuk e di nëse ishin të vërteta apo sajime të gjyshes ato ndodhi, po sidoqoftë nëna qeshte me gjithë shpirt dhe i ndritnin sytë nga lumturia.

Tre muaj pas ikjes së babait ne mbetëm shumë keq. Për darkë hanim kokoshka misri, që gjyshja i piqte në një qebap të madh kafeje. Në një natë të tillë erdhi Cule Vakoja. Ne porsa kishim filluar të përtypnim darkën tonë të mjerë. Ai përshëndeti me zërin e vet si bubullimë dhe vajti u ul pranë vatrës.

— Ç'po bëni? — pyeti.

— Ja, — tha gjyshja, — na vajti mendja për kokoshka...

Po Cule Vakos nuk ia hidhje dot. Ai u ngrit me vrull në këmbë, shkoi hapi dollapin e vogël prej druri, kontrolloi me vëmendje nëpër të ndarat e tij dhe u kthye nga ne i alarmuar.

— Ç'bëhet kështu në këtë shtëpi, — tha dhe filloi të vinte rrotull me hapa të gjatë e të rëndë. Nëna dhe gjyshja e shikonin të heshtura. — Ç'bëni kështu?! Të vdesin fëmija për bukë, dhe ju t'u jepni nja dy kokrra misri si pulave të zgjebosura. Dhe të më thoni mua se ju vajti mendja për kokoshka, dhe ta flejë mendjen si budallai Cule Vakua, ooo! — Trupi i tij i madh kishte mbushur gjithë shtëpinë. Ai shkante sa nga njëri skaj në tjetrin, ankohej me ca fjalë që i rrokulliseshin nga goja si bubullima dhe betohej se s'do ta harronte sa të qe jeta mashtrimin që i kishin bërë ato dy gra të krisura.

Pasi shkrofëtiu kështu për një kohë të gjatë, Cule Vakoja hapi përsëri derën me vrull dhe u largua nëpër natë duke utërirë e gjëmuar si bishtë e plagosur. Ne vazhdonim të heshtnim.

— Ai s'ka për vete, — tha nëna. Gjyshja nuk foli. S'kaloi veçse gjysmë ore dhe dera u hap përsëri me vrull. Dyshemeja kërciti nga hapat e viganit të dëshpëruar Cule Vako, që tani mbante në duar një qeskë me miell. Gjyshja brofi në këmbë.

— Është gjynah nga perëndia t'u heqësh nga goja bukën fëmijëve të tu, — tha ajo duke shtyrë me të dyja duart qesen e madhe me miell. po çne! Cule Vakoja s'donte t'ia dinte për një qeskë si ajo. Ai e kishte hambarin të pangarë. Se kishte një djalë në Kuçovë Cule Vakoja, që binte çdo muaj nga tre thasë me miell. Se kishte dy djem të tjerë ai Cule Vakoja që punonin si bujq. Ku pyeste ai për një qeskë si kjo. Nuk iu dha, se mund të binte edhe një tjetër, edhe dy. Gjyshja e dëgjonte dhe qeshte me dhimbje. Ajo e dinte se Cule Vakoja s'kishte në shtëpi asgjë nga ato që thoshte dhe ky mund të qe mielli i fundit, po si mund ta përballonte atë mirësinë e vrullshme dhe plot zemërim të Cule Vagos, si mund t'i bënte ballë zemrës së tij të bardhë, që s'pranonte asnjë lloj kundërshtimi? Ajo e dinte se atë qeskë me miell e ndoqën nga pas dhjetë palë sy të uritur grash e fëmijësh, por e dinte gjithashtu se ai miell nuk do të futej më në atë shtëpi dhe nuk do të pranohej nga asnjëri prej tyre, edhe sikur të detyroheshin të hanin hirin e vatrës nga uria. Te ne vinte shpesh e shoqja e Cule Vagos, një grua e gjatë dhe ajo,

me një fustan të trashë ngjyrë plumbi si kambanë. Rrinte me orë të tëra t'i mbushte mendjen gjyshes se Culja i saj ishte i urtë e i mençur sa njëqind shenjtorë bashkë, po fatin e tij të gremisur e ndiqnin nga pas gjithë djajtë e skëterrës. Dhe sa më shumë i mbushej mendja gjyshes që s'kishte në botë burrë më të urtë e më të drejtë se Cule Vakoja, aq më shumë vuante dhe mundohej ajo të sillte argumente të reja. Le të kishte drejtësi në këtë botë dhe të shikonte bota pastaj kush do të qe Cule Vakoja, u thoshte ajo së fundi dhe i mbushte sytë me lot. Gjyshja mallëngjehej seriozisht.

Dalëngadalë po vinte pranvera dhe lajme nga babai nuk kishim ende. Nëna ishte paralizuar krejt nga dëshpërimi, kurse gjyshja mundohej ta mbante veten për hir të saj. Netët vazhdonin të ishin ende të ftohta. Mbrëmjeve mblidheshim në shtëpi të heshtur, ndiznim një zjarr të madh dhe turrnim gjithfarësoj mendimesh të hidhura. Shtëpia e vjetër ndriçohej nga gjuhët e flakëve të kuqe të zjarrit, dhe gjyshja, për të kursyer vajin e gurit, nuk e ndizte kandilin.

Atëherë nëna mernte një triko leshi dhe fillonte ta thurte. Gjyshja merrej me Lilin, kurse mua s'më mbetej gjë tjetër veçse të ndiqja hijet fantazmagorike që sajnin trupat tanë në muret e shtëpisë dhe mbi tavan. Te vija që ndante murin me tavanin këto hije përthyeshin, binin mbi njëra-tjetrën duke u dridhur dhe sajnin gjithfarësoj pamjesh të përçudnuara. Trajtat e tyre herë të frikshme e herë qesharake lëkundeshin e ndryshonin pa pushim nga lëvizjet e mia të pareshtura. Ishte një topitje dhe heshtje

plot merak, dhimbje, parandjenja të zymta, përgjim, një qelësi që po na e gërryente shpirtin. Pikërisht në një natë të tillë porta e jashtme trokiti fort. Dikush qëllonte me një breshëri shkopinjsh. Nëna u hodh përpjetë si ketër dhe doli me vrap përjashta.

— Kush është? — pyeti e trembur.

— Ku ini, moj gra, ku ini, moj të uruara?

Ishte zëri i trashë e i ngjirur i plakut Babo. Dolëm te dera e shtëpisë edhe unë me gjyshen me kandila në dorë:

— Ç'ka bërë vaki, mor zoti Babo? — Në çast unë vura re fytyrën e saj që u ngjeth nga një i kuq alarmues.

— Habere, — tha plaku Babo, duke qeshur me zë gurgullues, dhe nxori nga gjoksi një zarf të bardhë.

— Të lumtë ajo gojë!

Gjyshja vuri duart në bel dhe psherëtiu me gulç, sikur të nxirrte nga gjoksi gjithë ajrin që kishte thithur në ata muaj të vështirë të pritjes. Nëna zbriti me hapa të mëdhenj shkallët, iu hodh plakut Babo në qafë dhe filloi ta puthte me rrëmbim. Plaku Babo kishte ngritur dorën lart dhe e tundte letrën nëpër ajër me një pamje të rreptë mistike.

— Ja, ja ç'bie Baboja i varfër. Shajeni Babon, talleni Babon, mos e doni Babon, por ai prapë do të vijë në këtë shtëpi i pari për të prurë gëzime...

Ai fliste i ngashëryer, i trullësor nga lumturia. Flokët e gjatë e të bardhë i tundeshin si jele kali dhe i binin mbi fytyrë. Gjyshja rrinte ende pa lëvizur në krye të shkallëve, me duar të kry-

qëzuara në gjoks. Nëna u shkëput nga plaku Babo dhe përsëri me vrull iu hodh në krahë gjyshes si e mekur, futi kokën në gjoksin e saj duke lëvizur pareshtur, sikur donte t'ia çonte deri thellë në shpirt lumturinë e këtij çasti të shumëpritur.

— Kola, shpejt, shko vrap te hallë Kristina, — tha nëna pas pak. — I thuaj se erdhi haberi i mirë nga babai.

Të përpjetën që të shpinte te shtëpia e hallë Kristinës e ngjita si i çmendur, vrapoja, rrëzohesha, ngrihesha e vrapoja duke ulërirë me zë të lartë një këngë pa kuptim, me fjalë që i sajoja në vrap e sipër.

— Hallë Kristina, hallë Kristina!

Vazhdoja të rendja, sytë më përvëlonin nga djersa, gjoksi më gufonte me vrull, nata kumbonte si tunxh nga hapat e mi. Hallë Kristina, hallë Kristina! S'kishte më net të pikëlluara, s'kishte më nënë me sy të përlotur që varte kokën mbi atë triko të mallkuar prej leshi që thurej e thurej si qilimi i Penelopës. Hallë Kristina, hallë Kristina! Kishte ardhur pranvera. Mjaftonte vetëm ai zarf i bardhë, që mëngjeseve të avullonte një mjegull e tejdukshme si rrjetë e hollë qumeshti, të çelnin lulet e bajameve dhe të qershive të egra në koriye dhe nëpër arat me grurë të ngrihej një furtunë me pëllumba të kaltër. Pas kësaj bota do të rrotullohej sipas ligjeve të atij zarfi. Ajo letër ishte një eliksir që do të bënte mrekullira të padëgjuesha. Dhe atëherë unë, duke vrapuar, guxoja të vija në vend dhe të korrigjoja me energji të pashpjegueshme të gjitha padrejtësitë që ishin bërë deri në këtë çast.

Hallë Kristina, hallë Kristina! Pas kësaj gjyshja s'do të kishte më nevojë të na e mbushte boshllëkun gërryes të urisë me përralla të frikshme dhe të stërgjatura, fundin e të cilave s'e mësuam dot kurrë. Kur u afrova afër shtëpisë, nisa të thërritja sa më mbante zëri. Hallë Kristina, hallë Kristina! Në oborr më doli përpara vjehrra e hallë Kristinës, një plakë e vogël dhe e mirë, që më dukej se gjithmonë qe e lumtur ngaqë kishte nuse të Viktorit të saj, që punonte si kamerier në qytet, hallën time. Ajo e vështronte vazhdimisht hallë Kristinën me mall e përgjërim, sikur ta shikonte për herë të parë, sikur të kishte frikë se mos nusja e bukur s'ishte veçse një ëndërr e magjishme, që nga çasti në çast mund të zhdukej dhe ta linte atë të zhgënjyer përjetë.

— Hallë Kristina, Hallë Kristina! — vazhdoja unë të flisja mu pranë fytyrës së saj.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti plaka dhe më kapi për supesh me ato duart e saj të vogla plot damarë të vegjël e të kaltër.

— Ku është hallë Kristina?! — pyeta unë duke m'u marrë fryma. — Ka ardhur haber i mirë nga babai.

— Ah, ç'na gëzove, — tha plaka me zërin e saj të hollë e të butë dhe përplasi duart me ngazëllim. — Nuse!

Hallë Kristina u duk në krye të shkallëve.

— Djali thotë se ka ardhur haber nga Stefani.

Hallë Kristina zbriti shkallët dy e nga dy, e mpirë, e mekur, si një somnambul.

— Vërtet?! — pyeti dhe më kapi me vrull nga supet, më lëkundi me forcë sikur të shkund-

te nga trupi im mosbesimin që i rëndonte në shpirt.

— Vërtet?! — Zëri i saj ishte i pikëlluar.

— Plaku Babo, — thashë unë, duke marrë frymë me zor, — është në shtëpi, me letër nga babai.

— Vërtet, Kola, vërtet? — pyeti ajo për së treti, pastaj më afroi fytyrën pranë vetes, më puthi, më largoi prapë, më pa për një kohë të gjatë me sy që i përvëltonin, përsëri më puthi e së fundi, sikur të kujtohej për diçka që s'priste, që kërkonte ngut, më shtyu lehtë pranë vjehrrës dhe u nis me vrap nëpër monopat. Ishte zbathur. Në vrap e sipër mblodhi flokët e gjatë e të papleksur, që dallgëzonin nga era, dhe zbriti poshtë nëpër natë si një copë mjegull e bardhë. Unë u nisa pas saj.

— Dale, — tha plaka duke zgjatur krahët e hollë, — dale të të gostit. Na gëzove.

Unë ktheva kokën për një çast në drejtim të saj, tunda dorën në shenjë lamtumire dhe u nisa për në shtëpi... Kur u futa brenda, vura re një turmë të madhe me njerëz. Lumturia jonë i ngazëllente dhe bënte të shkëlqenin sytë e atyre njerëzve të mirë, që për pak çaste kishin braktisur tërë hallet e brengat e tyre dhe kishin ardhur të çlodheshin e të shpiheshin me atë gëzim të madh që kishim ne.

Plaku Babo tregonte për të disatën herë se si një natë më parë i kishte dalë në ëndërr i panjohuri i përhershëm e misterioz dhe e kishte pyetur: «Ti je plaku Babo?» «Unë jam» i kishte thënë plaku Babo. «Dëgjo, plaku Babo, — kishte

thënë i panjohuri, — ti gjithë jetën ke qenë burrë i palodhur dhe i ndershëm, s'i ke rënë asnjëherë njeriu në qafë, ke parë gjithnjë punën tënde, prandaj kjo gjë do të të shpërblehet.» «Po me se do të më shpërblehet», kishte pyetur plaku Babo.

— Drejtësia, drejtësia, — mahnitej vigani Cule Vako. «Ti, plaku Babo, s'e ke dëgjuar kurrë zërin e të paudhit, s'ke ndjekur asnjëherë rrugën e shtrembër të ptytëplaçurittësyve, s'i ke shkelur tjetrit në hakun e tij, dhe kjo do të të shpërblehet.» «Po me se do të më shpërblehet», kishte pyetur përsëri plaku Babo. Atëherë i panjohuri i kishte vënë gishtin kokës, ishte menduar për një kohë të gjatë dhe i kishte thënë plakut Babo se të gjitha këto do t'i shpërbleheshin me se t'i donte e bardha zemër. Po ja, plaku Babo i kishte thënë se hëpërhë të mirat që kishte bërë në jetë donte që t'i shpërbleheshin me një haber të mirë nga Stefani, që qe në kurbet, i biri i Harillës, pa miqësinë e të cilit mbase nuk do t'u kishte bërë ballë gjithë tundimeve të qoftëlargut. I panjohuri ishte menduar dhe një herë dhe i kishte thënë se çdo gjë do të bëhej si donte ai plaku Babo, që kishte qenë tërë jetën i ndershëm dhe i pastër si dëbora e malit. Kur qe ngritur në mëngjes, plaku Babo qe larë, qe pastruar, kishte veshur rrobat më të mira dhe kishte dalë të priste në sofa të portës. Kur e kishte pyetur plaka se ç'priste aty i larë, i kruar e i kapardisur si krushk, plaku Babo i kishte thënë se priste një haber të mirë. Kush s'besonte, le të pyeste plakën sa herë të donte. Po çne, asnjëriu s'i shkonte mendja të mos besonte.

— Papapa, si dalin ëndrrat, more, — thoshte Cule Vakoja, — një më një i dalin ëndrrat këtij plakut Babo.

— Posi, posi, — mernte zjarr plaku Babo dhe kthehej edhe një herë te fjalët që i kishte thënë i panjohuri. Ti, plaku Babo, ke bërë gjithnjë të mira në këtë jetë, prandaj...

Dikush po fliste jashtë derës me zë të hollë si pipëz:

— Gjyshe Lena, gjyshe Lena!

— Gjyshe Lena, gjyshe Lena!

Më në fund e mora vesh kush fliste dhe vajta pranë gjyshes.

— Ka ardhur Koto Plepi, — i thashë i gëzuar. Gjyshja u ngrit në këmbë dhe doli jashtë.

— Hajde, more Kotoja i shkretë, hajde, — tha ajo.

Koto Plepi zgjati kokën te dera gjysmë e hapur, por, kur pa shumë njerëz, e hapi shpejt e shpejt dhe filloi ta shikonte gjyshen i habitur e i frikësuar njëkohësisht. Pastaj zgjati qafën e hollë në drejtim të saj dhe i tha me zë lutës:

— Të qesh një çikë?

— Qesh, — tha gjyshja, — sa të duash qesh!

— Hihih.

— Papapapa, si i dalin ëndrrat këtij plakut Babo, more!

Gjyshja shkoi te sënduku, e hapi, nxori prej andej një ftua të verdhë dhe ia zgjati Koto Plepit. Ai shikonte me mosbesim, zgjati duart jo më tepër për të marrë ftuan sesa për t'iu përgjigjur shakasë së gjyshes, po, kur vuri re se peshqeshi i verdhë erëmirë s'po lëvizte nga vendi dhe po i drejtohej atij me ngulm, atëherë

i shkrepri në kokë mendimi i mençur se ky ftua duhej marrë, se qe për të, i tëri, i shijshëm. Duart e tij të vogla u zgjatën me energji, e rrokën ftuan me vrull, e shkulën nga duart e gjyshes dhe e afruan në gjoks. Pastaj u largua, pa një herë mos e ndiqnin dhe humbi nëpër natë, duke u hedhur pupthi si karkalec dhe duke lëshuar hihira.

*

*

*

Lajmi i mirë nga babai pati jetë të shkurtër. Ai shkruante se kishte arritur shëndoshë e mirë në një qytet që quhej Çikago, me shtëpi të mëdha e të larta deri te retë, me rrugë të shumta e të panumërta, ku lëviznin pareshtur lumenj të tërë njerëzish dhe makinash. Hëpërhë ai s'ishte rregulluar, punonte ku të mundte, por ishte njohur me ca shqiptarë të mirë, që do ta ndihmonin. Ne nuk duhej të bëheshim merak fare. Kaluan disa muaj nga letra e tij e parë dhe përsëri shtëpinë tonë e sulmuan parandjenjat e këqija dhe dëshpërimi i rëndë. Nëna, që tani kishte ndryshuar, bisedonte orë të tëra me gjyshen për atë. Sipas tyre babai porsa qe futur në punë dhe nuk donte të dërgonte letra, veçse atëherë kur të kishte mundësi të dërgonte bashkë me letrën edhe të holla. Patjetër që kështu do të ishte. Plaku Babo kishte pyetur një ditë të panjohurin e ëndrrave dhe ai i kishte thënë se, me që plaku Babo kishte qenë tërë jetën i ndershem dhe me zemër të bardhë si qumështi, do t'i shpër-

blehej e mira që kishte bërë në këtë botë dhe djali i Harillës, që ishte në Amerikë, do të futej në një punë të mirë, ku paratë fitoheshin me grusht. Hallë Kristina vinte çdo ditë në shtëpi dhe mjaftonte të shikonte njërin nga ne që të kuptonte se s'kishte ndryshuar asgjë që nga dita kur kishte ardhur letra e parë nga babai. Për disa ditë erdhi në fshat dhe burri i hallë Kristinës, Viktori, që punonte në qytet si kamerier. Më vonë unë mora vesh se Kristina ishte gruaja e dytë e tij. Të parën e kishte lënë për hir të saj dhe ky ishte shkaku i zemërimit të babait me të. Megjithatë mua ai më dukej i mirë. Sa herë që vinte në shtëpi, diçka do të binte për mua dhe Lilin. Hallë Kristinën dhe gjyshen i adhuronte. Ai i paraqiste gjërat me një lehtësi të çuditshme. Përballë gjyshes dhe hallë Kristinës ai fliste për babanë si për një perëndi. Gjyshja rrinte dhe e shikonte si shpëtimtar, i gëzohej, e aprovonte, qeshte me lot në sy, i kapte duart dhe ia afronte në buzë me një dashuri dhe mirënjohje të pakufishme. Në këto çaste, për hallë Kristinën Viktori ishte tërë bota. Duke e parë që fliste për babanë kështu, ajo mrekullohej, prushëzonte nga lumturia dhe ndoshta i pëshpëriste vetes, duke u magjepsur, se deri tani ajo s'kishte bërë në jetë gjë më të guximshme dhe më të bukur se atë që qe martuar me këtë njeri të jashtëzakonshëm dhe të mençur si një profet. Pas ca ditësh ai shkoi prapë në qytet dhe, në çastin që do të ikte, krejt rastësisht, sikur u kujtua në momentet e fundit, më tha mua që ta përcillja. Rrugës më pyeste për hallë Kristinën, për gjyshen dhe për nënën. Ç'bëjnë ato në shtëpi,

po hallë Kristina, veçanërisht ajo, qante për babanë, ishte e mërzitur? Bah, çne, hallë Kristina s'qe aspak e mërzitur, përkundrazi, përkundrazi. Ai më lëmoi flokët me mosbesim. Unë u skuqa nga turpi. Dukej shumë i mërzitur.

Pritëm më kot përgjigje nga babai. Plaku Babo nuk e përmendte më të panjohurin e ëndrrave. Ishte viti 1936. Nëna dhe gjyshja kishin disa ditë që punonin me usta Pilon. Ngriheshin në mes të natës, shkonin në majë të malit dhe aty usta Piloja nxirrte gurë të mëdhenj e të rëndë. I binim në shtëpi aty afër muzgut dhe me ta pastaj bëheshin gurë mulliri, që ustai plak i shiste nëpër fshatra të ndryshme. Nëna dhe gjyshja vinin në shtëpi të rraskapitura; shpesh këmbët dhe duart u kullonin gjak dhe me këtë gjak ne mbanim frymën gjallë. Babai heshtte. Kjo heshtje mbante me vete të gjitha parandjenjat e këqija që na fshikullonin çdo çast jetën, si fijet e një kamxhiku. Në fshat kishte ardhur djali i Cule Vakos. E kishin pushuar nga puna sepse kishte bërë demonstratë. Cule Vakoja ishte i lumtur, sepse djalit të tij s'ia hante qeni shkëpin dhe për drejtësinë të merrte gjak në vetull.

Edhe gushti erdhi me një vapë të rëndë që të trulloste. Nëpër rrugët plot pluhur, që dridheshin nga avujt përvëlues, lëviznin me plogështi njerëz të dëshpëruar e të lodhur.

Ditët ishin pa fund të gjata dhe të trishtueshme. Në një kohë të tillë erdhi lajmi i fundit nga babai. Pa dyshim, atë gusht mizor, me njerëz që lëviznin nëpër udhët plot pluhur si në një shkretëtirë të përbindshme, unë e gjykoj sipas ligjeve të këtij lajmi të hidhur. Plakut Babo i

dridheshin buzët dhe i rrokulliseshin nëpër faqet e zhubrosura e të çara si toka e përvëlur nga die-lli lotët e mëdhenj sa një kokërr breshri. Nëna dhe gjyshja rrinin kruspull të mbështjella në krahët e zinj të disa plakave të vjetra që vajto- nin me një zë të mprehtë e të thatë që të shkall- monte gjoksin. Hallë Kristina vështronte përçark me sy të ngrirë e të çapëlyer, pa folur dhe pa nxjerrë asnjë pikë lot. Një grua e vogël, e ve- shur krejt me të zeza, i rrinte pranë e tmerruar dhe e rraskapitur, i fërkonte ballin, duart dhe i thoshte vazhdimisht duke u lutur: «Qaj, shpirt, qaj!» Hallë Kristina nuk qante. Cule Vakoja kishte rënë në gjunjë i shpartalluar nga dhembja dhe ia bënte vazhdimisht: «Ah, more, ah, more!» Mua më mbante pranë burri i hallë Kristinës, më fuste kokën në kraharor dhe diçka më pëshpëriste me këmbëngulje, po se çfarë nuk e di. Kur ka- luan disa orë, vëmendja u përqendrua te hallë Kristina. «Qaj, shpirt, qaj!» I shoqi me një tje- tër u ngritën, e morën për krahu dhe e nxo- rën jashtë. Ajo shkante pas tyre e bindur. Edhe unë u ngrita dhe dola jashtë. Burri i hallë Kris- tinës ishte shumë i alarmuar.

— Kristina! — i fliste ai me një zë të lartë, duke e shkundur nga supet. Halla lëvizte e shtyrë majtas e djathtas prej krahëve të tij të fuqi- shëm dhe as që e kthente kokën. Sytë e saj të zmadhuar, me një vezullim të mekur e të egër, vështronin larg në zbrazëti pa kuptim. Në fytyrën e hequr e të zverdhur si limon nuk i lëvizte asnjë nerv.

— Hallë Kristina, hallë Kristina, jam unë Kola!

Ajo uli kokën, më vështroi për një çast e habitur dhe pastaj i lëshoi përsëri sytë në arratinë e ngrirë e pa jetë. Unë u futa përsëri brenda. Munda të çaja deri te nëna, në mes pyllit të dendur të trupave të zez të grave. Ajo më shtrëngoi fort në gjoks dhe në çast fytyra m'u qull nga lotët e nxehtë.

— Hallë Kristina, — thashë me zë të këputur.

— Çfarë, — belbëzoi ajo.

Ma mbështolli fytyrën me duar dhe filloi të më shikonte me ngulm.

— Çfarë? — pyeti përsëri.

— Hallë Kristina nuk qan dot.

— Çfarë, çfarë? — më pyeti ajo për të tretën herë me një hutim trulllosës.

— Hallë Kristina është jashtë.

— Ku është hallë Kristina?

— Po jashtë, jashtë!

— Jashtë?

Si duket ajo vetëm tani kuptoi diçka nga ajo që doja t'i thosha unë. U ngrit me vrull dhe doli në oborr. Unë u struka në prehrin e viganit Cule Vako, që vazhdonte të thoshte «ah, more, ah, more», sikur të mos i kishte mbetur në kujtesë asnjë fjalë njerëzore veç asaj klithme të dëshpëruar. Rrija i përhumbur dhe më bëhej sikur vozitja nëpër një mjegull të trashë e përvëluese. Kisha një ndjesi braktisjeje të pamëshirshme, që s'më qetësohej dot as nga besnikëria e sigurt e zemrës së dhimbshme të Cule Vakos, rrahjet e së cilës i dëgjoja pranë veshit si goditjet e çekanit mbi kudhër. Pas pak u futën brenda nëna me hallë Kristinën. Unë zgjata kokën nga gjoksi i madh i Cule Vakos dhe sytë më vajtën

përnjëherësh te gjyshja. Asaj i vetëtinte fytyra nga një dritë e kobshme dhe shikonte me lutje e përgjërëm nënën. Hallë Kristina qante sikur ta kishte dëgjuar këtë çast lajmin e vdekjes së babait....

Ajo natë ishte e gjatë pa fund.

*
-
*
*

Nuk më kujtohet sa zgjati kjo gjendje. Babai s'ishte më. Letrën e shkruante një kushëriri e afërt e gjyshes, që kishte disa vjet që qe larguar. Babai qe sëmurrur papritur dhe s'ishte ngritur më. Por, shkruante ajo, moj motër Lenë, mos të të mbetet peng, se ja bëra të gjitha Stefanit, sikur të ishe vetë. Dha shpirt në krahët e mi dhe e përcollëm me gjithë shqiptarët që janë në Çikago.

Një mëngjes erdhi Viktori i hallë Kristinës dhe më mori me vete në qytet. Unë nuk mbaj mend gjatë jetës sime të kem bërë rrugë më të rëndë dhe më të trishtuar se atë. Nuk më hiqej për asnjë çast nga sytë heshtja e mekur e fytyrës së nënës kur më përcolli. Ecja si nëpër ëndrra të frikshme. Viktori i hallë Kristinës mundahej të ma hiqte zymtësinë duke treguar ca ngjarje të gëzueshme, po të gjitha ato që thoshte ai, përziheshin dhe shqyheshin me përfytyrimet e hidhura të jetës sime të shkurtër prej fëmije.

Ku po shkoja? Përballë më dilte fytyra e madhe e gjyshes, që në çast merrte përmasa

vigane dhe më rëndonte në shpirt me një ndjesi të hidhur e torturuese. Pastaj hallë Kristina me kokën e mbushur me flokë të dendur dhe me sy të qullur nga lotët. *Ku po shkoja? Ajo që më priste, nuk më ngjallte asnjë lloj interesi, koka dhe veshët më gjëmonin nga zërat e atyre që lashë pas. Më dukej sikur isha mbështjellë i tëri nga një furtunë zërash klithës. Në qytet arritëm në muzg. Ishte një qytet i vogël, me rrugë të ngushta, të veshura aty-këtu me kalldrëm. Shkuam drejt e te dhoma ku flinte Viktori i hallë Kristinës. Pastaj ai më çoi në një restorant me drita të shumta e të zbehta si ankthe, me kamerierë të shpejtë e të bardhë që më bënë një përshtypje të vagëlluar. Aty hëngra diçka që s'e kisha ngrënë kurrë dhe që gjithashtu më la një përshtypje të vagëlluar. Viktori i hallë Kristinës bisedoi me kamerierët e bardhë për një kohë të gjatë dhe diçka u tha edhe për mua i merakosur. U ngritëm nga restoranti, shëtitëm rreth një orë në një rrugë të ngushtë e të shkretë qyteti dhe së fundi shkuam përsëri në dhomë. U shtrimë për të fjetur në një krevat. Unë nuk e mbaja dot veten dhe fillova të qaja me ngashërim. Viktori i hallë Kristinës u ngrit, hapi dritaren, u vesh dhe ndenji në fund të krevatit duke më parë i mërzhitur dhe i dëshpëruar.*

— Ti s'duhet të bësh kështu, — tha ai me një zë të lehtë e qortues, — ti s'je më fëmijë. Tek e fundit ke nënën, gjyshen, Kristinën dhe mua. Unë jam rritur më keq se ti.

— Mua më vjen keq për ato, — thashë.

— Nuk bën kështu, nuk bën, — tha përsëri

ai dhe më lëmoi flokët. — Ti tani je burrë dhe duhet të sillesh ndryshe në rast se i do me të vërtetë.

— Unë do të bëja gjithçka për ato, — thashë me një zë solemn, që tingëlloi edhe një çikë qesharak, se burri i hallë Kristinës vuri buzën në gaz.

— Kështu po, — tha. — A do të flesh tani?

— Po, — thashë.

Ai u zhvesh, fiku dritën dhe erdhi u fut pranë meje në krevat. Nuk më zinte gjumi. Pas disa çastesh Viktori i hallë Kristinës foli me zë të lehtë:

— Kola, Kola!

Donte të dinte nëse kisha fjetur. Unë nuk iu përgjigja. Ëtëherë ai psherëtiu thellë dhe u kthye nga ana tjetër. Ç'më priste pas kësaj nate pa gjumë?!

Do të punoja te një tregtar. Qysh në mëngjesin e ditës së nesërme Viktori i hallë Kristinës më shpuri përballë një shtëpie të madhe dykatëshe të lyer me bojëbizele. Në portën e madhe e të rëndë të shtëpisë varej një dorë e zezë hekuri. Trokitëm. Derën e hapi një grua e thyer në moshë, me një skufje të bardhë në kokë. Ajo dukej e lodhur dhe e përgjumur.

— Ç'kërkoni?! — tha.

— Duam zotin Kristaq, — tha Viktori.

— Po është herët, mor bir, — ia ktheu gruaja.

— Kemi biseduar me të, — tha Viktori i hallë Kristinës. — Na pret.

— Si t'i them? — pyeti gruaja.

— Thuaj se ka ardhur ai garsoni.

Gruaja u fut brenda me hapa të druajtur. Unë rrija i hutuar. Oborri i madh i shtëpisë ishte shtruar me pllaka të kuqe mermeri dhe flakëronte nga një vezullim i mahnitshëm. Dritaret ishin mbuluar me grila bojëbizele. Në hyrjen e derës së brendshme ishin ngulur dy shtylla të mëdha të lyera me të bardhë dhe nëpër të zvarritej si kulpër e trashë një lule zvarritëse. Mbi kokat tona hapësira ishte mbuluar nga pjergulla të mbushura me rrush të verdhë kokërrmadh. Anës oborrit kishte kumbulla dhe hurma. Pas pak gruaja me skufje doli prapë.

— Tani vjen zoti Kristaq, — tha dhe u fut brenda.

Mua filloi të më rrihte zemra me vrull. Kush do të dilte pas pak? Para sysh, njëra pas tjetrës më dilnin figura burrash të mëdhenj, të gjatë, të trashë, të shëndoshë, fytyra të vrenjtura, të egra, të pakënaqura, burra pa flokë, me buzë të trasha, me mustaqe të dendura e të gjata deri te lllapat e veshëve.

— E prure? — Ishte një zë i hollë si mjau-llimë.

— E prura, zoti Kristaq.

I porsaardhuri ishte një burrë i hollë si kalem. Koka e tij e vogël dhe e shogët deri në majë dukej sikur qe vendosur nga një dorë e kujdesshme në një këllëf flokësh të zez. Buzët i kishte të mavijosura dhe të holla si teneqe, kurse, në kontrast me gjithçka, sytë i kishte të mëdhenj, të turbull dhe të hutuar. Në fillim ai të jepte përshtypjen e një burri fatkeq, që, megjithëse ishte ndoshta diçka mbi të pesëdhjetat, s'kishte mundur të shkëputej dot nga fëmijëria.

— Kola, takoje zotin Kristaq, — tha burri i hallë Kristinës. Zgjata dorën dhe u rrëqetha nga kontakti me pëllëmbën e tij të qullët e të nxehtë.

— Duket shumë i vogël, — tha zoti Kristaq duke shtrembëruar buzët e holla.

— Është dymbëdhjetë vjeç, — tha Viktori i hallë Kristinës.

— Mos më gënje kështu, — tha zoti Kristaq me zë të ulët.

— Jo, zoti Kristaq, kaq është.

— Mos gënje.

I turbulluar, Viktori i hallë Kristinës mundohet t'i mbushte mendjen se unë isha me të vërtetë dymbëdhjetë vjeç, se isha i fuqishëm si një kalë, kurse zoti Kristaq ia kishte ngulur sytë pa mëshirë në fytyrë dhe buzëqeshte lehtë me një pamje djallëzore. Viktori i hallë Kristinës foli për një kohë të gjatë, trilloi gjithfarësoj historish. ku shquheshin aftësitë e mia prej punëtori të madh dhe pushoi vetëm atëherë, kur zoti Kristaq uli sytë përdhe me pamjen e njeriut që dorëzohet më në fund. Viktori më shkeli syrin i kënaqur. Zoti Kristaq ndenji për një kohë të gjatë me kokën e vogël varur mbi supe, pastaj e ngriti atë me mundim dhe ia nguli sytë e turbulluar Viktorit të hallë Kristinës.

— Më shqepe me gënjeshtër, — tha me zë të qetë.

— Dymbëdhjetë vjeç është, — tha i rraskapitur Viktori i hallë Kristinës nga kjo goditje e pamëshirshme. — Fundja, si të doni, zoti Kristaq. — Burri i vogël buzëqeshi lehtë dhe fytyra në çast iu rrudh e tëra si një copë letër e zhubra-vitur. Atij nuk i pëlqyen fjalët e fundit të burrit

të hallë Kristinës. Ishin fjalë tepër krenare për një garson.

— Po ç'ta bëj unë këtë djalë? — pyeti pas pak duke kruar kokën e shogët i menduar.

— Unë bëj ç'punë të doni ju, — thashë papritur me guxim.

Tregtari më vështroi i habitur.

— Vërtet? Po ç'punë bën ti, për shembull?

Kjo ishte një pyetje e papritur. Gjaku më vërshoi në fytyrë me vrull dhe unë u përvëlova nga turpi e hutimi.

— Hë, — tha tregtari, — ç'je i zoti të bësh?

— Unë ruaj kecërit.... — i thashë.

Në fillim ai më pa i shtangur, pastaj qeshi me zë të lartë. Hihhi. Zëri i dilte gulçe-gulçe, si të tështitura macesh. Lëkura e hollë e fytyrës, që mori në çast një ngjyrë purpuri të keqe, duke sikur do të pëlciste nga tendosja.

— Ky djalë është shakaxhi i madh, — tha.

Vazhdonte të qeshte. Viktori i hallë Kristinës më shikonte me keqardhje. Unë qëndroja i shtangur dhe i habitur.

— Djali s'ka qenë asnjëherë në qytet, zoti Kristaq, — tha Viktori.

Njeriu i shkurtër sikur e reshti një çikë të qeshurën.

— Domethënë, ti mund të ruash kecërit, ha-haha! — Filloi përsëri të qeshte me një vrull të ri. Unë po e shikoja i përqëndruar dhe vura re se sytë e tij vazhdonin të ruanin atë hutimin dhe turbullimin e mëparshëm. S'kishin ndryshuar asnjë grimë nga çasti kur i pashë në fillim, edhe pse ai vazhdonte të shqyhej së qeshuri.

— E po këtu, — tha ai duke lëmuar mjekrën

e hollë, — nuk ka kecër. Këtu ka djaj me brirë. Të ruash vetëm njërin prej atyre që hyn e del në dyqanin tim, është ku e ku më vështirë se të ruash në pyll një kope me ujçër.

Purpuri i sëmurë i fytyrës së tij u tret dhe dalëngadalë fytyra e vogël dhe e fishkur mori një të verdhë nervoze.

— Kështu! — tha ai me kënaqësi cinike, pasi na kishte mposhtur të dy. Për herë të parë qysh nga çasti që qe shfaqur përballë nesh, sytë e tij të mëdhenj e të turbull u aktivizuan dhe morën një shkëlqim të egër. Tani tek ai s'kishte asgjë nga ai njeriu i mjerë, që s'kishte mundur të burrërohej. Po ky ishte vetëm një çast. Pas pak sytë e tij u mbushën me atë turbullimin e përhershëm, kurse tiparet e mprehta të fytyrës u venitën dhe u mjeruan përsëri. Viktori i hallë Kristinës ndezi një cigare dhe filloi ta thithte me vull.

— Kështu, — tha përsëri zoti Kristaq.

Më pa dhe një herë me vëmendje, fërkoj faqet me kurrizin e verdhë të dorës dhe tha me zë të ulët:

— Po e mbaj njëherë.

Viktori i hallë Kristinës psherëtiu thellë. Mua ma përshkoi trupin një rrëqethje e ftohtë. Zoti Kristaq më kapi lehtë për supesh dhe më futi në korridorin e gjerë të shtëpisë. Më la aty për disa kohë, doli jashtë, diçka bisedoi me Viktorin, pastaj u fut brenda i vrenjtur.

— Prit këtu, — më tha me një pavendosmëri që e bezdiste.

Më pa për disa çaste me vëmendje, teshtiu nja dy herë dhe humbi pas një dere në thellësi

të korridorit. Unë mbeta fillikat përballë mureve të bardha të shtëpisë së panjohur. Ndenja ashtu për një orë të tërë. Vështroja muret që ndritnin me një vezullim të ftohtë dhe armiqësor, korridorin e shtruar me qilima të ngushtë ngjyra-ngjy-
ra, shkallët e katit të dytë të mbushura anash me koka të drunjta sorkadhesh, dhe më dukej vetja si i rënë në kurth. Gjithçka më dukej e pabesueshme. Shtëpia dukej si e braktisur. Pas një ore dera e dhomës kërciti dhe prej saj doli zoti Kristaq i veshur me një kostum të zi. Kështu ai dukej edhe më i frikshëm.

— Do të rrish këtu me zonjën, — tha kur më kaloi pranë. — Ajo do të të thotë se ç'do të bësh.

Tani zëri i tij dukej më i hollë dhe më i për-
vuajtur. Pas ikjes së tij heshtja u bë më e rëndë. Zonja nuk po dukej. Unë shkova te shkallët, u mbështeta në to, i lëmova për një kohë të gjatë me apati dhe papritur u kapita nga gjumi.... Nuk e di sa kohë kishte kaluar kur ndjeva se dikush po më shkundte nga supet. Hapa sytë i trembur. Mbi fytyrë më kishte rënë një gardh flokësh të zez. Pas pak flokët u zbrapsën dhe unë u ndodha përballë një gruaje të re me robë-
dëshambër të gjatë ngjyrë alle. U ngrita në këmbë i trembur. Gruaja po më shikonte me vëmendje. Prej saj vinte një erë e lehtë parfumi që më ngacmonte hundët. Buzët i dukeshin si të përgjakura nga të kuqtë. Ajo ishte e bukur.

— Për të fjetur ke ardhur këtu? — tha.

Kishte zë kumbues.

— Nuk e di, — thashë unë padashur.

Isha mbushur përplot me hutim. Më dukej

sikur trupi më që thërrmuar në mijëra grima të vogla. Gruaja buzëqeshi.

— Mirë, mirë, si të quajnë?

— Kola.

— Ëhë, Kola...

Zëri i saj tingëlloi i butë. Pas pak ajo u ngjit nëpër shkallë dhe unë shkova pas saj. Hymë në njërin nga dhomat e shumta të katit të dytë. Në njërin skaj ishte vendosur një krevat i madh, i gjerë, i mbuluar me një rrobë mëndafshi. Në murin përballë ishte shtrirë një bandë e madhe ngjyrë blu. E vështrova për një kohë të gjatë i mahnitur. Në të ishte pikturuar një shtëpi e vogël anës detit, mbuluar me shelgje dhe yje të kaltra. Pranë saj, në një ballkon të mbushur me dritë të verdhë hëne, rrinin të përqafuar një vajzë dhe një djalë. Poshtë bandës ishte vendosur një krevat i vogël fëmije.

— Ti do të kujdesesh për Beniaminin, — tha ajo duke treguar me dorë krevatin e vogël ku flinte fëmija. Unë miratova me kokë. Zonjën e bukur e habiti ky gjest dhe më pa për një kohë të gjatë me vëmendje.

— Unë jam zonja Meri, — tha ajo pas pak.
— Jam gruaja e zotit Kristaq.

Unë vazhdoja të isha në një gjendje apatie të rëndë dhe e shikoja zonjën Meri krejt i hutuar.

— Pse më shikon ashtu? — tha ajo.

Ktheva kokën i turpëruar. Në anën tjetër të dhomës ishte varur një bandë tjetër. Ishte një luan jeshil me zgavrën e gojës të hapur. Krifa e tij ngjyrë zjarri dukej sikur hidhte në dhomë dritë të kuqe. Zonja Meri ndiqte me vëmendje vështrimin tim.

— Pse shikon ashtu? — pyeti ajo përsëri.
— Unë s'kam parë asnjëherë shtëpi zotërinjsh,
— thashë.

Ajo qeshi.

— Po zonja dhe zotërinj ke parë?

— Jo, — thashë.

Në murin përballë ishte vendosur një komodinë e gjerë. Edhe ajo ndriçonte nga lustra. Mbi të ishte vendosur një pasqyrë e madhe vezake, e rrethuar me një kornizë të gjerë. Zonja, pasi shkoi dhe u ul pranë pasqyrës, hapi një sirtar dhe vendosi mbi komodinën e madhe gjithfarësoj krehrash, furçash, pincash, gërshërësh të vogla, tubeta dhe shishe parfumi. Ajo e vështroi fytyrën e vet të bukur e të gjatë me një kënaqësi drithëruese, sikur porsa t'ia kishin dhuruar. Pastaj me një furçë të gjatë filloi të krihte flokët.

— Kush qe ai djali që të pruri këtu? — pyeti papritur.

— Viktori i hallë Kristinës.

— Ç'është kjo hallë Kristina?

— Motra e babait, — thashë unë.

— Djalë e ka atë që të pruri këtu?

— Jo, — i thashë unë, — e ka burrë.

Dhoma u mbush në çast me erë parfumi, kurse Beniamini i vogël filloi të qante me të madhe. Zonja Meri kishte mbërthyer sytë me gishtërinjtë e saj të hollë. I shtangur nga gjithçka që shikoja, u afrova pranë krevatit dhe fillova ta tundja Beniaminin. Ai duhej të ishte më pak se një vit, po të qarët e kishte shumë të fuqishëm. Zonja Meri nuk u shqetësua fare nga të qarët e tij. Tha vetëm «tunde Beniaminin» dhe

vazhdoi të merrej me furçat dhe pincat e veta. Pas pak Beniamini pushoi.

— Ti do të rrish ca kohë në shtëpi, sa të rritet Beniamini, — tha zonja Meri. — Ne kemi një shërbëtore plakë, por unë nuk e lë t'i afrohet djalit. Fryma e pleqve është shumë e rëndë.

Pas pak zonja Meri u ngrit në këmbë, hoqi robëdëshambrin e gjatë dhe mbeti vetëm me një këmishë të bardhë. Unë u skuqa nga turpi, kurse zonjës Meri edhe këtë radhë, edhe gjithmonë për të tilla gjëra do t'i vinte aq rëndë nga unë, sa ç'mund t'i vinte nga çifti i dashnorëve të bandës së murit.

— Është e bukur gruaja e atij djalit që të pruri këtu? — më pyeti ajo duke u rrotulluar përpara pasqyrës dhe duke parë me bisht të syrit shpatullat e gjera lakuriq.

— Po, — thashë unë dhe mbulova fytyrën me duar. Faqet më kishin marrë zjarr nga turpi.

— E gjatë është? — pyeti përsëri zonja Meri me zë të qetë.

— Po.

— Sa unë?

— Po, thashë për të tretën herë.

Zonja Meri veshi robëdëshambrin ngjyrë alle dhe filloi të këndonte me zë të ulët. Rrotullohej përpara pasqyrës, mbushte duart me flokë, qëndronte befas si e ngrirë dhe shikonte veten në pasqyrë me dhembshuri, pastaj përsëri rrotullohej dhe këndonte me sy të vagëlluar si në ëndërr. Të gjitha këto i bënte sikur unë të mos isha fare aty. Si ndenji për një kohë të gjatë para pasqyrës, mori një revistë nga komodina dhe u lëshua

e lodhur mbi një kolltuk të madh. Filloi të shfletonte e shkujdesur.

— Ja dhe princesha, — tha, — i ke parë ti princeshat?

— Jo, — thashë unë.

— Janë të shëmtuara si dreqi, — tha zonja me neveri. — Edhe emrat i kanë të shëmtuar, Sanije, Myzejen, dreq. E di ti ç'janë princeshat?

— Jo, — thashë si i zënë në faj.

— Janë motrat e mbretit.

Në këtë shtëpi më habiste, më hutonte, më ndrydhte gjithçka, dhe sendet që ishin përçark me luksin e tyre të praruar, edhe zonja Meri me mënyrën e çuditshme të të folurit, edhe të tëra. Ishte një topitje që s'e shkundja dot, që më bënte të vuaja deri në ngashërim.

Beniamini filloi të qante përsëri.

— Tunde, — tha zonja Meri me mospërfillje.

Unë fillova të tundja të voglin, kurse zonja Meri u ngrit dhe ndenji për një kohë të gjatë mbi kokën time. Parfumi i fortë i trupit të saj më ra në fytyrë si valë e nxehtë. Pastaj zonja u përkul lehtë dhe më vuri dorën në kokë. Më hapi flokët, më pa këmishën dhe më në fund gishtërinjtë e saj të hollë e të ftohtë u futën deri në kurriz. Unë qëndroja si mbi gjemba.

— Qenke djalë i pastër, — më tha pas pak dhe filloi përsëri të rrotullohej e të këndonte me një zë të lehtë e të thellë si psherëtimë.

— Tani unë do të dal, — tha zonja Meri. — Ti s'do të largohesh për asnjë çast nga Beniamini.

Ajo vajti përsëri përballë pasqyrës, hoqi robë-dëshambrin, nxori nga një gardërobë e madhe disa fustanë dhe i hodhi mbi krevat, i pa të gji-

thë me radhë disa herë dhe më në fund, duke psherëtirë, zgjodhi njërin prej tyre e filloi të vishej me kujdes. Kjo punë zgjati rreth gjysmë ore. Veshi një fustan të gjatë jeshil me grykë tepër të hapur dhe me mëngë të shkurtra. Këpucët e zeza shkëlqenin si pasqyra verbuese. Flokët e gjatë i shpupuriti disa herë me gishtërinj, mbulonte me ta fytyrën, pastaj i hidhte me vrull pas shpine, shkante në pasqyrë, rënkante, psherëtinte, buzëqeshte e më në fund i mblodhi topuz e i mbërtheu me ca karfica të mëdha vezulluese. Në njërën dorë vuri orën, kurse në tjetrën një byzylyk të gjerë ari. Qafa e gjatë u mbush me rruaza të shtrenjta me ngjyrë purpuri të ndezur e vezullues. Kështu e veshur dukej shumë më e gjatë dhe më e bukur. Ndenji në pasqyrë për një kohë të gjatë si e ngrirë, duke admiruar vetveten me pangopësi. Këtë radhë dhe gjithmonë unë vija re se ajo largohej nga pasqyra duke psherëtirë, kurse sytë i njomeshin me lot të pakuptueshëm.

— Hë, — tha me një zë të dëshpëruar dhe mori revistën nga kolltuku. — Ja, këto janë princeshat. O perëndi! Ç'kanë këto për të qenë princesha!

Ajo klithi dhe fytyra iu tkurr nga një mëri e egër. Revista me princeshat u përplas me vrull në mur dhe ra mbi qilimin e trashë. Zonja Meri shkoi përsëri në pasqyrë, ndenji prapë për një kohë të gjatë, u qetësua, pastaj u ngrit, mori një çantë të zezë dore, më porositi edhe një herë të kujdesesha për Beniaminin e vogël dhe doli.

Kjo ishte dita ime e parë e punës. Nga mëngjesi deri natën vonë rrija i mbyllur në dhomën e madhe të gjumit dhe tundja krevatin e Be-

niaminit. Kur ai flinte, shkoja nëpër dhomat e tjera dhe pastroja mobiljet, fshija dhe bëja punë të tjera të rastit. Beniamini qante shumë. Zonja Meri përsëriste çdo ditë të njëjtën gjë. Më dukej se ajo s'çante shumë kokë për djalin e vogël. Zoti Kristaq vinte në drekë në shtëpi, hante bukë, rrinte disa minuta pa folur mbi krevatin e Beniaminit dhe ikte. Mua nuk më fliste fare. Edhe me zonjën Meri fliste shumë pak. Zakonisht grindeshin. Ata e urrenin njëri-tjetrin. Zoti Kristaq disa herë në sytë e mi e kishte quajtur zonjën Meri lopë. Zonja Meri ishte më e përmbajtur, po frikë nuk e kishte. Në këto raste zakonisht ajo turfullonte me shpoti, e mbërthente zotin Kristaq me sytë e saj të mëdhenj dhe i thoshte se gjithkush, para se të shajë tjetrin, duhet më parë të shikojë veten. Dhe mjaftonte kjo që koka e vogël e zotit Kristaq të skuqej në çast, të mbushej me damarë të vegjël e të dukej e mjerë dhe e vogël sa një ftua.

Një mëngjes, teksa zonja Meri po bënte tualetin e përditshëm, unë pashë nga dritarja e shtëpisë një burrë që kapërceu murin dhe u fut brenda me vrull.

— Një burrë u fut brenda nga muri, — i thashë i tronditur zonjës Meri.

— Ç'thua kështu! — tha ajo dhe pa orën e dorës.

— U fut brenda! — klitha i tmerruar.

Zonja Meri u ngrit, shkoi te dritarja dhe u ul prapë në kolltuk.

— Të kanë bërë sytë, — tha me qetësi të zakonshme.

— Jo, jo. Unë e pashë, — thashë i vendosur.

Sytë e mëdhenj të zonjës Meri shkrepnin nga inati. Ajo u ngrit, erdhi drejt meje, më kapi nga krahët dhe më shkundi si e tërbuar.

— Unë them se ty të kanë bërë sytë. Askush nuk është futur brenda.

— Jo, e pashë...

— Mjaft!

Ajo më shtrëngoi fort, më bërtiti me zë të çjerrë, nervoz, më shkundi, pastaj më qëlloi me pëllëmbë, një herë dhe një herë tjetër. Unë shtanga, ngriva. Ç'kisha bërë? U shkëputa prej saj me mundim. Ajo më mbërtheu prapë dhe tani dridhej e tëra. Besova se këto çaste edhe mund të më mbyste.

— Ty të kanë bërë sytë, askush s'është futur brenda, askush!

— Po unë...

— Ti sheh fantazma!

Mezi merrja frymë.

— Thuaj se të kanë bërë sytë dhe se askush nuk është futur brenda!

— Po, — belbëzova më në fund, i tmerruar nga pamja e saj.

— Ah, Kola, Kola!

Zonja Meri u lëshua mbi një kolltuk e rras-kapitur. Për një kohë të gjatë, ashtu e shtrirë dhe e lëshuar e tëra, më vështronte me ca sy të tmerrshëm e të ligj. Pastaj u ngrit, shkoi përballë pasqyrës dhe filloi të shikonte me ëndje se si nga fytyra e saj e bukur po zhdukeshin dalëngadalë gjurmët e egra të inatit. U ngrit, shkoi diku dhe mori një pece të bardhë, më pa përsëri me zemërim dhe filloi të fshinte me kujdes të kuqin e buzëve.

— Ç'të shkrepni që të thoshe se dikush hyri në shtëpi? — më pyeti.

Unë rrija i heshtur, kokulur, i shpartalluar.

— Mos mendon akoma se pe njeri që u fut brenda?

— Jo, — belbëzova, — më kanë bërë sytë.

— Kuptohet që të kanë bërë sytë, — tha zonja Meri dhe m'u afrua duke më parë me dhembshuri. — Ty të ka marrë malli për shtëpinë, — tha, — ti je i lodhur. Unë do t'i them zotit Kristaq që ditën e shtunë të shkosh në shtëpi me atë djalin e ri që të pruri. Ke qejf të shkosh në shtëpi?

— Po, — i thashë me afsh.

Zonja Meri më dha premtime të tjera. Ajo do t'i lutej zotit Kristaq të më blinte dhe një palë pantallona të reja, bile, në rast se unë do të rrija urtë, do të punoja mirë dhe sidomos në rast se nuk do të thosha gjëra të frikshme si ato që thashë sot, ajo do t'i lutej zotit Kristaq që të ma rriste pagën. Zonja Meri fliste me një zë të butë, të dhembshur e tërë përkujdesje, megjithatë unë vura re se fytyra dhe tërë pamja e saj dridhej nga një padurim i madh, që s'më kishte rënë kurrë në sy. Ajo ndenji dhe pak në dhomë, pastaj tha se do të shkonte të flinte, sepse ndihej shumë-shumë e lodhur. Unë s'duhej ta lija për asnjë çast vetëm Benjaminin e vogël dhe, nga ana tjetër, edhe sikur Beniamini të pëlciste së qari, unë në asnjë mënyrë s'duhej të veja ta zgjoja atë. Ajo s'kishte qenë kurrë kaq e lodhur. Doli nga dhoma e menduar dhe e heshtur. Mbylli derën me një plo-

gështi të shtirë dhe më pas unë ndjeva nëpër korridor hapat e saj të shpejtë...

Ajo u kthye pas dy orësh, e çlodhur dhe e lumtur. Mua edhe herë të tjera m'u duk sikur nga muri i prapmë i shtëpisë hynte dikush me vrull, po nuk i thashë më kurrë zonjës Meri. Kisha filluar vërtet të besoja se më bënin sytë. Sidoqoftë, në raste të tilla nuk më kishte shpëtuar pa vënë re që, sa herë më dukej se dikush hynte vjedhurazi në shtëpi, zonja Meri shkonte përpara pasqyrës, pastronte buzët e kuge me pecetë dhe hynte në dhomat e tjera për të fjetur, sepse ajo «s'kishte qenë kurrë, kurrë kaq e lodhur». Në këto raste unë s'duhej ta lija vetëm Benjaminin edhe s'duhej ta shqetësoja kurrsesi zonjën Meri.

*

*

*

Beniamini u sëmur papritur. Zoti Kristaq vinte disa herë në ditë për ta parë. Fytyra i qe bërë më e verdhë dhe më e vogël nga merak. Një mjek plak vinte vazhdimisht me të, e vizitonte Benjaminin, rrinte disa çaste i heshur, buzëqeshte me vete, i tregonte zotit Kristaq se si njëherë kishte shëruar djalin e një konti italian që ia kishin hequr shpresën gjithë mjekët, se si kontesha donte t'i dhuronte një fermë me kuaj kur e kishte shëruar fëmijën, kurse ai s'kishte pranuar veçse pak të holla, pak, sa kishte ndërtuar një shtëpi të vogël, dhe konti me konteshën qenë mahnitur nga kjo bujari e tij.

Pastaj ai niste dhe shkruante për një kohë të gjatë receta të reja për ilaçet e Beniaminit. Të sëmurin e çuan në një dhomë tjetër më të vogël. Pas tij shkova dhe unë.

Kur erdhi e shtuna, unë i përmenda zonjës Meri premtimin, por ajo u largua e mërzhitur, pa më kthyer përgjigje. Në mesditën e së shtunës erdhi Viktori i hallë Kristinës. Dola jashtë për ta takuar. Zbriti dhe zoti Kristaq. Ai i tha Viktorit se s'mund të më linte të shkoja në fshat për shkak të Beniaminit të sëmurë, i dha ca të holla, rrogën time, dhe u fut brenda me nxitim. Mbeta vetëm me Viktorin.

— Si ia kalon? — tha duke më përçafuar.

Unë heshtja kokulur.

— Mos të kanë rrahur? — më pyeti i shqetësuar Viktori i hallë Kristinës.

— Jo, — i thashë.

— Po pse rri kështu?

— Më mori malli për nënën, — thashë.

Viktori i hallë Kristinës më afroi më pranë vetes.

— Mos u mërzhit, — më tha. — Sot do të shkoj unë në shtëpi, do t'u them se ti je shumë mirë dhe se po u dërgon para. Ah, u bëre burrë, more Kola, dhe çfarë burri!

Unë e dëgjoja i heshtur dhe i mallëngjyer.

— Lodhesh në punë?

— Jo, — thashë.

— Ç'punë bën?

— Përkund Beniaminin, pastroj mobiljet, çaj dru... nuk lodhem.

— A të bërtet zonja?

— Jo!

— A të japin bukë?

— Po!

— Po ti jeton si princ, — tha Viktori.

— Unë jam mbyllur brenda si në burg, — thashë.

Viktori i hallë Kristinës qeshi me të madhe.

— Ja, — tha, — sa të rritet ky biçim Beniamini, pastaj do të shkosh të punosh në dyqan. Po s'ke për të qenë më mirë se tani.

Viktori iku dhe unë u ngjita lart. Beniamini vazhdonte të qante. U ula në gjunjë dhe fillova ta përkundja. Zoti Kristaq me zonjën Meri po grindeshin. Ngrita kokën lart, i pashë me radhë të dy dhe vura re se ata dridheshin nga inati duke parë njëri-tjetrin. Grindja u ndërpre për disa çaste kur hyra unë. Pjesën e dytë të saj e nisi zonja Meri.

— Unë s'kam parë asnjë ditë të bardhë me ty, vetëm grindje. O perëndi, ma nxive jetën!

Zoti Kristaq u hodh përpjetë sikur ta kishin pickuar. Ai zgjati turçkat e vogla e të përskuqura nga inati në drejtim të zonjës Meri dhe tha me maraz:

— Ti i vure zjarrin kësaj shtëpie, e çkule nga themelet.

— Unë?!

— Edhe djalin ti e sëmure. Ti je bishë!

Zonja Meri kafshoi dorën që të mos klithte.

— Dita kur u martova me ty ka qenë e mallkuar, — tha ajo.

— Lopë!

— Plesht!

— Çfarë?!

Zoti Kristaq u zbeh. Fytyra e vogël iu shtre-

mbërua nga një dhembje e llahtarshme sikur ta kishte goditur dikush me sëpatë në kokë.

— Unë plesht?!

U ngrit në këmbë. Rrafshi i trëndafiltë i kokës iu mbush me bula djerse sikur mbi të të kishte rënë një vesë e hollë shiu. Edhe zonja Meri brofi në çast, vuri duart në bel dhe po e shikonte me një vështrim të thellë e përbuzës.

— Unë kam një baba që s'lejon të më prekë kush as fijen e flokut, — tha ajo.

— Ti ke një baba kopuk, — tha zoti Kristaq duke u afruar drejt saj me një pozë kërcënuese dhe duke shkopsitur me gishtërinjtë e hollë jekun e zi, sikur kështu t'i jepte më shumë egërsi dhe volum inatit të vet. Pas pak qëndroi në vend, turfulloi dhe ngriti lart me kërcënim grushtet e vogla. Befas trokiti me forcë dera e jashtme. Burrë e grua ngrinë në pozicione luftarake.

— Kolë, shiko kush është, — tha zonja Meri.

Dola jashtë me vrap. Hapa derën. Ishte një grua e thyer në moshë, e veshur mirë. Ajo më pa për disa çaste, diçka donte të më pyeste, po pastaj, si duket, u pendua, më shtyu me një gjest përbuzës dhe u fut brenda me shpejtësi. Unë renda pas saj.

— Ah, zonja Fildes, zonja Fildes!

— Jemi bërë merak sa s'thuhet, — tha zonja e porsaardhur duke marrë frymë me zor. — Kur më thanë se kishit Beniaminin sëmurë, sa s'u çmenda nga pikëllimi! Unë dhe im shoq prekemi shumë kur u ndodh gjë njerëzve tanë të dashur. Ne vuajmë njësoj sikur të na ketë ndodhur në shtëpinë tonë.

Ajo fliste dhe rrotullonte kokën në mënyrë

të guditshme dhe qesharake. Sikur të ishte në kushte të tjera, do të besoja se ajo e bënte një gjë të tillë për të zbavitur njerëzit përçark. Zonja Meri dhe zoti Kristaq e dëgjonin me admirim të thellë, aq sa dukej sikur nga prania e saj qenë bërë aq të lumtur dhe paqësorë, sa që kishin harruar dhe grindjet e tyre, edhe sëmunden e Beniaminit.

— O perëndi, o perëndi, pse s'na lë të qetë!
— klithi së fundi zonja Fildes duke u përkulur mbi Beniaminin e vogël. Zonja Meri dhe zoti Kristaq e ndoqën pas.

— Le djali, po unë kam hallin e tim shoqi, — tha zonja Meri gati duke qarë. — Më është tretur burri nga merak. Ah, e gjora unë! — Po shikoja i habitur zonjën Meri dhe zotin Kristaq, që uli kokën i mallëngjyer nga fjalët e së shoqes dhe nuk mund të besoja dot se pak më parë këta njerëz të pikëlluar e kokulur, ishin gati t'i ngulnin thonjtë në grykë njëri-tjetrit.

— Zoti Kristaq është njeri shumë i ndjeshëm, — tha zonja Fildes.

— Ah, po ky çmendet për këtë fëmijë, moj zonja Fildes. A nuk e shikon si është tretur?! As fle, as ha dhe as flet. Është e pamundur ta pyesësh për diçka, se s'të përgjigjet. Ka rënë në një përhumbje që të ngrin gjakun. E gjora unë!

Zonja Meri ia shkrepiti të qarit me të vërtetë.

— Po qetësohu, mor zoti Kristaq, — tha zonja Fildes. — Njerëzit durojnë gjëra më të mëdha, kurse kjo s'është asgjë.

— S'duroj dot, — tha zoti Kristaq, — s'kam forcë.

— Qyqja! — tha zonja Meri dhe u shemb mbi krevatin e madh të mbuluar me mëndafsh të kuq. Atëherë zonja Fildes u ngrit në këmbë, shpiu trupin me forcë sa i kërcitën kockat dhe lëshoi përçark një rrëke fjalësh të ëmbla për dashurinë dhe kujdesin që tregonin për njëri-tjetrin zonja Meri dhe zoti Kristaq. Së fundi ajo arriti në përfundimin se zoti Kristaq dhe zonja Meri e donin njëri-tjetrin si dy pëllumba. Pak më vonë njëri nga dy pëllumbat, zoti Kristaq, më tha të zbritja poshtë dhe t'i thosha shërbëtores plakë të bënte tri kafe e t'i sillte lart me pijet. Zbrita poshtë. Kur erdha përsëri, Beniamini filloi të qante me të madhe.

Unë u ula dhe fillova ta përkundja.

— Po këtë shërbëtor kur e keni marrë?
— pyeti zonja Fildes.

— Këtë javë, — tha e pakënaqur zonja Meri.

— Është keq për shërbëtorë. S'gjen njeri për të qenë. Sesi janë bërë të paturpshëm këta shërbëtorët sot. S'guxon t'u dalësh përpara se tmerrohesh nga fjalët e tyre të pagdhendura.

— Lëre, lëre, — tha zonja Meri, — batërdi.

Zoti Kristaq vazhdonte rolin e njeriut të mekur nga mallëngjimi.

— Unë e ndoqa shërbëtoren që kisha. Ishte bërë e padurueshme. Të ngrihen leshrat e kokës përpjetë. Ah, moj shpirtë, — i tha ajo zonjës Meri me intimitet, — janë ca cipëplasura që të nxijnë jetën.

— Unë, siç e shikon, mora këtë çunak, — tha zonja Meri me nëntekst.

— Është kohë shumë e vështirë, — tha zonja Fildes dhe nxori nga çanta një erashkë të ver-

dhë që e hapi në çast dhe filloi t'i bënte fresk fytyrës së gjerë të mbushur me bula djerse. — S'mund të gjejë njeriu një shërbëtor për të qenë.

Ato flisnin dhe shikonin nga unë sikur unë të kisha mbledhur tërë paudhësitë e shërbëtorëve që kishin njohur. Beniamini qante. Zoti Kristaq vështronte i alarmuar krevatin që lëkundej pa pushim dhe rënkonte i mbytur.

— Mbaje veten, zoti Kristaq!

— S'mundem, s'mundem. Mezi e kemi prurë gjer këtu këtë djalë.

— Ti mund të bësh dhe dhjetë djem të tjerë, — tha zonja Fildes dhe e pa me dinakëri. Zonja Meri qeshi nën buzë.

Zonja Fildes ndenji afërsisht një orë duke tundur në mënyrë qesharake kokën e madhe dhe duke shtrydhur sytë bojë hiri të shpëlarë për të nxjerrë ca lot pikëllimi në shenjë dhembjeje për Beniaminin. Më në fund ajo i nxori lotët që i duheshin dhe zonja Meri me zotin Kristaq kërcyen përpjetë, iu afruan në të gjitha pozicionet dhe harxhuan shumë energji gjersa e qetësuan. Pas kësaj zonjës Fildes iu desh të pikëllohej dhe një herë për të thënë se të shoqit, nënprefektit të qytetit tonë, i kishte ardhur shumë keq që s'kishte mundur të vinte. Atë e kishin thirrur me urgjencë në Tiranë. Po ndodhnin ngatërresa të mëdha. Varfanjakët po bënin greva gjithandej. Ishte e tmerrshme të mendoje, por ata kishin arritur gjer atje, saqë të shanin edhe Italinë.

— Italinë! — klithi zoti Kristaq, sikur të ishte zgjuar nga një ëndërr e frikshme. — Gjithë shpresat janë tek Italia, zonja Fildes. Kur do ta kuptojmë ne një gjë të tillë?

— O zot, Italia, — tha në ekstazë zonja Meri. — Mos i lini, zonja Fildes, mos lejoni asnjë fjalë kundër saj.

— Nuk do t'i lëmë, moj shpirtë, — tha zonja Fildes me ton autoritar, duke hedhur mbi vete pushtetin e gjithë grave të nënprefektëve të vendit. Zonja Meri u qetësua. Pastaj zonja Fildes kujtoi një ballo të madhe më 1935, në Korçë, dhe fytyra e saj e fryrë si brumë u përsquq nga lumturia. Zonja Fildes me të shoqin kishin vajtur me një «Ford» luksoz. Ç'elegancë! Zonja dhe zotërinj të edukuar mbushnin trapezat e mëdha të mbushura me vermut, shampanjë e verëra të mrekullueshme. Kishte qenë dhe konsulli italian me të shoqen. Mahnitje e vërtetë! Kurse në këtë qytet të vogël jeta ishte e mjerë. S'kishte as dëfrime, as ballo. Dhe sikur të mos kishte ca familje të këndshme, si ajo e zotit Kristaq, do të ishte për të vrarë veten. Zoti Kristaq e ngushëlloi duke i thënë se dikush duhej të sakrifikohej për atdheun. Sot atdheu po vinte në provë atë, zonjën Fildes. Pas këtyre fjalëve zonja Fildes piu një gotë liker dhe tha e martirizuar se nuk i vinte aspak keq që po ia kushtonte jetën e saj atdheut.

— Megjithatë, ju jeni ende e re dhe e freskët, — tha zonja Meri. Zonja Fildes qeshi e lajkatuar.

Unë shikoja i habitur herë nga zonja Meri, herë nga zonja Fildes dhe mundohesha të kuptoja se ç'kishte të re në atë trup të madh sa një katanë dhe në atë fytyrën e gjerë të zonjës Fildes, me mishra të varura si të demave pleq. Pas kësaj zonja Fildes u ngrit, shikoi edhe një herë e pikë-

lluar Beniaminin dhe zotin Kristaq, e porositi zonjën Meri që ta lajmëronte herë pas here për shëndetin e të voglit dhe u largua. Një minutë pas ikjes së saj zoti Kristaq u ngrit më këmbë, mori pozicionin e një luftëtari të egër dhe bërtiti me zë të ngjirur:

— Domethënë unë jam plesht!

Zonja Meri, që ishte përgatitur për një sulm të tillë, i kujtoi edhe një herë zotit Kristaq se ishte vajza e një babai që s'lejonte t'i prekeshin as qimet e flokut.

— Domethënë unë për ty s'jam veçse një plesht! — tha përsëri zoti Kristaq.

— Në rast se unë jam lopë, — tha zonja Meri, — edhe ti mund të jesh plesht.

— Kola, dil jashtë, — tha zoti Kristaq.

Unë u ngrita në këmbë duke u dridhur.

— Dëgjo këtu, — tha ai dhe më mbërtheu fort në supe, — në rast se do të dëgjosh ulërimat e zonjës, nuk do t'i kërkosh askujt ndihmë.

Nga buzët e holla të zotit Kristaq dilnin flluska të vogla pështyme që më binin në fytyrë.

— Dëgjon, Kola!

— Si urdhëron, — thashë unë dhe vështrova i tmerruar zonjën Meri me mendimin se po e shikoja për herë të fundit. Ajo kishte vënë duart në bel dhe e shikonte të shoqin me përbuzje. Dola jashtë.

— Domethënë unë...

Prisja nga çasti në çast të ndodhte tmerri i madh që premtoi zoti Kristaq. Pritja të dëgjoja klithma, ulërima, lutje plot përgjërim, por nga të gjitha këto s'dëgjova veçse ca përplasje të shurdhëta sendesh në mur, një qeshje plot duf nga

zonja Meri, pastaj ca mjaullima të shkëputura të zotit Kristaq dhe vetëm kaq.

Unë nuk mund ta kuptoja kurrësi atë që ndodhte në këtë shtëpi. Zonja Meri ishte një mister i vërtetë. Isha tepër i vogël për të kuptuar tërë karakterin e saj. Por edhe kur të rritesha e të ndeshesha me lloj-lloj njerëzish, zonja Meri do të zinte vend të parë në radhën e çudirave djallëzore. Zoti Kristaq ishte një copë baltë që shkelej prej saj pa mëshirë, megjithatë mua s'më erdhi keq kurrë për atë njeri dhe vazhdimisht mendoja se në atë trup të vogël e të pa-fuqishëm ziente një inat i hidhur si farmak, që mund të shpërthente e të helmonte gjithçka. Në poshtërimin e tij, në mënyrën si heshte dhe nënshtrohej, në buzët e holla që i lëpinte me gjuhë sa herë ndihej ngushtë, në grushtet e vogla plot damarë të kaltër, që s'u vunë kurrë në përdorim, kishte diçka të pështirë e të llahtarshme. Qysh nga çasti kur hyra brenda në këtë shtëpi, ai s'më pa kurrë me sy dhe s'm'u afrua asnjëherë, megjithatë unë e ndieja se pak nga pak isha bërë një pjesë e urrejtjes së tij të ndrydhur.

Kur më thirrën lart për Beniaminin, lufta kishte mbaruar. Ishte shumë vështirë të merrej vesh kush ishte fitimtari. Beniamini qante, kurse ata të dy rrinin në këmbë, larg njëri-tjetrit, të menduar e të lodhur. Unë tundja fëmijën. Ata ndenjën për një kohë të gjatë në përgjim të njëri-tjetrit. Më në fund zoti Kristaq u largua. Dukej kërcënues si një predhë. Kohët e fundit, siç kisha marrë vesh turbull, ishte përzier me një shoqëri italiane për shfrytëzimin e pyjeve dhe ëndë-

rronte të fitonte para me grusht. Por, sa nuk i kishte fituar këto para, ai ende i ruhej së shoqes, veçanërisht babait të saj, që, siç thuhej, njihej me personalitete të pallatit.

Kur iku i shoqi, zonja Meri u lëshua mbi kolltuk e lodhur. E veshur me një robëdëshambër të kuq, tepër e gjatë, dukej sikur ishte zhytur në një pellg gjaku. Përballë saj, në mur, krifa e luanit u drodh sikur kafsha e përbindëshme do të lëshohej nëpër dhomë duke ulërirë. Po shikoja në drejtim të tij i alarmuar. Pas pak luani filloi të ulërinte me të vërtetë, u lëshua nëpër mure me një kërcim të shpejtë, tundi krifën që kishte marrë zjarr dhe po afrohej drejt meje me sy të llahtarshëm e të egër. Unë klitha dhe mbulova fytyrën me duar.

— Ç'patë? — tha zonja Meri dhe erdhi me vrull drejt krevatit të fëmijës.

— Asgjë.

— Si asgjë?

— Asgjë, — thashë unë duke marrë frymë me zor.

Ajo më pa për një kohë të gjatë, diçka belbëzoi me pakënaqësi dhe më urdhëroi të dilja jashtë.

*

*

*

Më në fund më dhanë leje për të shkuar në shtëpi. Ndjeva një gëzim të jashtëzakonshëm, që më shkundi të tërin. Gjithë natën pothuajse s'fjeta. Zgjohesha, shikoja në dritare dhe prisja

me padurim që të gdhihej. Viktori i hallë Kristinës erdhi e më mori që në mëngjes herët. Rrugën e bëra si i magjepsur. Vrapoja, këndoja me zë të lartë, merrja frymë me vrull sa më kërçiste gjoksi, shtrihesha mbi pllakat e mëdha të gurëve dhe prisja Viktorin, që ecte i ngarkuar me dy trasta të mëdha, rrihja ajrin me krahë, dëgjoja i mrekulluar këngën e zogjve, vështroja mjegullat e kaltra që vishnin shpatet e malit. Pastaj pylli. Dëgjoja gjëmimin e tij të mbytur e të thellë si det, dallgët e zërave misteriozë që buçitnin me një kumbim simfonik, ndiqja si i shtangur një furtunë të trembur zogjsh që humbisnin e treteshin si mjegull në horizont. Mbështetesha nëpër drurët e mëdhenj, i pushtoja me krahë, ndieja në gjoks lagështinë drithëruese të myshkut, mbyllja sytë dhe atëherë më dilte përballë fytyra e ëmbël e nënës, e gjyshes me sytë plot mall dhe e hallë Kristinës që vraponte poshtë monopatit me fustanin e bardhë dhe me flokët e shpupuritur. Pastaj përsëri e përsëri vrapoja e thërritja me emër njerëzit e dashur. Ky pyll ishte imi dhe unë, duke vrapuar nëpër të si i çmendur, derdhja ngado ngazëllimin tim trimëror prej fëmije....

Në fshat arritëm para darkës. Nëna, gjyshja dhe hallë Kristina më prisnin te porta. Gjyshja hapi krahët dhe më doli përpara. Ishte si e mekur. Kurse nëna më shikonte e çuditur, sikur të mos më kishte parë kurrë. Kur më përqafoi, dridhej e tëra. Ajo s'ngopej duke më parë. Dhe kur u futëm brenda, edhe kur unë bisedoja me të tjerët, kur hëngrëm bukë, ajo s'm'i shqiste sytë për asnjë çast. Nuk më pyeste për asgjë. Më du-

kej se edhe fjalët e të tjerëve nuk i dëgjonte. Vetëm më shikonte me ngulm, e përqendruar, pa m'i hequr sytë për asnjë çast, sikur të kishte frikë mos më grabitnin. Pas pak erdhi plaku Babo. Ai tani jetonte vetëm me ëndrra. Natën që kaloi, përsëri i ishte shfaqur në gjumë i panjohuri. «Ti je plaku Babo», e kishte pyetur. «Unë», i ishte përgjigjur plaku. «Ti ke qenë gjithë jetën tënde njeri i ndershëm, prandaj kjo do të të shpërblehet», i kishte thënë i panjohuri. «Me se do të më shpërblehet», kishte pyetur plaku Babo. «Me ç'të të dojë e bardha zemër.» Në mëngjes plaku Babo kishte thënë se do të vija unë. Pas tij erdhi dhe Cule Vakoja i gjatë.

— Papapa, more! Si i dalin ëndrrat këtij plakut Babo! — Megjithatë Cule Vakoja ishte i ngrysur dhe i revoltuar. Dikush foli prapa derës.

— Gjyshe Lena, gjyshe Lena!

Ishte Koto Plepi. Hyri brenda, pa përqark me hutimin e vet anormal, pastaj kërkoi të qeshte një çikë. Gjyshja e lejoi dhe ai, pasi lëshoi hihirat e tij gërryese, u largua duke kërcyer pupthi në majë të gishtërinjve. Unë isha i lodhur. Nuk më vinte të qeshja me Koto Plepin. Nga plaku Babo s'kisha më frikë. Lili m'u afrua i habitur. Hallë Kristina më shikonte me sy të përlotur. Për të unë ngjaja shumë me babanë. Kurse nëna ndiqte me kujdes të gjitha lëvizjet e mia dhe mbushej përherë e më tepër me çudi. Plaku Babo përsëriti për të disatën herë ëndrrën me të panjohurin, kurse Cule Vakoja po për të disatën herë u habit që ëndrrat e plakut Babo dilnin një për një. Nuk e di se ç'kisha një hutim gërryese. Shihja nga muri, nga ajo anë ku do të dukej

krifa e zjarrtë e luanit jeshil, po të isha ulur pranë Beniaminit. S'kisha frikë, vetëm se shihja nga ajo anë dhe ndihesha i rraskapitur. Ishte shtatori i vitit 1937.

Cule Vakoja ngrihet befas në këmbë dhe shan mbretin. Të gjithë shikojnë nga ai të habitur. Të gjithë. Unë mbështet kokën me kujdes në mur. Të gjithë shikojnë nga Cule Vakoja. Vetëm nëna. Për të aty s'ka njeri tjetër veç meje. Ndesh vështrimin e saj dhe i buzëqesh. Tani hetimi i saj alarmohet. Ku kisha mësuar unë të buzëqeshja ashtu! Pastaj në shtëpi erdhi Todi, shoku im i fëmijërisë. Ai është zënë me Konin dhe nuk flet. Konit s'duhet t'i flas as unë. Por unë jam i lodhur. Sikur plaku Babo te ishte në shtëpinë e zotit Kristaq dhe të ishte ulur ku po rri tani te ne, me siguri që mbi kokën e tij do të ulërinte luani jeshil. Cule Vakoja tregoi për një grevë që ishte bërë në Berat. Në të patjetër do të kishte qenë dhe Iloja i tij. Cule Vakoja ishte i pikëlluar dhe fliste në mënyrë shumë të çuditshme. Trupi i hollë e i gjatë, që ngrihej mbi të tjerët, i dridhej sikur t'i kishte marrë zjarr.

— Ti do të shpërblehesh, se tërë jetën ke qenë njeri i mirë. — thotë plaku Babo.

— Gënjen, — thotë Cule Vakoja. — Ai që sheh në ëndërr ti, plaku Babo, gënjen si djalli kur flet për mua.

Plaku Babo shqeu sytë nga tmerri. Fytyra ngjyrë bakri, e tharë nga vitet e shumta, iu err në çast si korja e një plage të vjetër.

— Uuu! — Plaku Babo rënkoj si bishë e plagosur.

— Ty të tall pleqëria me ca ëndrra të çmendura, more plaku Babo, — tha Cule Vakoja, i pamëshirshëm. — Unë s'dua përralla. Mua m'u thanë fëmija si rigoni nga uria. Ç'më tregon ëndrra!

Viktori i hallë Kristinës shkoi pranë Cule Vakos.

— Ti, Cule Vako, nuk duhet të flasësh kështu me plakun Babo.

Cule Vakoja u pre sikur ta kishin qëlluar me thikë prapa shpine. Ndenji disa çaste pa lëvizur, pastaj harkoi trupin e gjatë e të hollë përpara, zgjati duart e mëdha, e mbështolli plakun Babo me to si fëmijë dhe rënkoi me zë të mbytur.

— Ç'faj më ke ti, mor plaku Babo, ç'faj më ke?

Plaku Babo rrinte i shtangur, shikonte përçark i habitur që s'po përmysej dynjaja nga fjalët e Cule Vakos dhe bënte uuu me zë të këputur e të ngashëryer.

Nëna nuk dëgjonte asgjë. Në fytyrën e saj të bardhë e të mpirë nga dhembja s'lëvizte asnjë muskul. Ajo shikonte nga unë me një kujdes të përhershëm, plot frikë e pasiguri, sikur do të më rrëmbenin. Dikush erdhi prapë, më përqafoi, më tha se isha rritur e kisha ndryshuar. Pastaj më pyeti se ç'punë bëja. Thashë se isha shërbëtor te një tregtar. Vështrova nga nëna. Mermeri i ftohtë i fytyrës së saj u drodh i tëri sikur të kishte ndodhur një gremisje e madhe, pastaj dalëngadalë një purpur i lehtë filloi t'i ndizte gjithë pamjen. Ajo shpejtoi të fshinte dy pika loti që iu rrokullisën me vrap si dy zare

të ndritshmë nga gropat e syve. Të nesërmen ajo s'shkoi në mal me usta Pilon për të nxjerrë gurë mulliri. Vinte rrotull nëpër shtëpi e hutuar, më shikonte pa pushim, vinte re sendet që prekja, dëgjonte si flisja, shkonte të merrte diçka në dollap dhe befas harronte se ç'donte të merrte, skuqej, shikonte prapë nga unë, buzëqeshte me druajtje, më afrohej pranë, më shikonte me dyshim sikur të ishte në ëndërr, më pyeste për zotin Kristaq, për zonjën Meri, pastaj përsëri mbulohej me heshtje si me një mister të padepërtueshëm, shkonte rrinte diku në qoshe, shtrëngonte me dhëmbë gërshetin e gjatë dhe më shikonte tinëzisht me mall përvëlues.

Kur mbetëm për një çast vetëm, ajo më mori pranë.

— Mos u thuaj njerëzve që je shërbëtor.

Unë nuk fola.

— Mos u thuaj, po deshe, Kolë!

— Nuk do t'u them më, — thashë.

— Po si do t'u thuash, po të të pyesin?

— Nuk e di.

Ajo heshti gjatë, duke më parë e mallëngjyer.

— Ne i morëm lekët që ke fituar ti.

Unë buzëqesha.

— Po të ishte bërë Cule Vakoja kryeplak, do të të merrnim këtu. Të mos ishe shërbëtor. Cule Vakoja do të vinte drejtësi në fshat. Po ku i dihet, Kolë, ku i dihet...

Aty nga pasditja erdhi Viktori i hallë Kristinës. Kur hyri ai brenda, unë vura re nënën që e pa me një vështrim disi armiqësor. Viktori i hallë Kristinës uli kokën. Ai kishte ardhur të më merrte....

U largova me ndjenjën e një boshllëku të thellë. Era e ftohtë e vjeshtës së parë më ndiqte gjatë tërë rrugës si një kuisje qeni. Cule Vakoja na përcolli deri në fund të fshatit. Ecte me hapa të hovshëm, aq sa mezi e ndiqnim, fliste me adhurim, gati duke bërtitur, për të birin që punonte në Berat dhe herë pas here më përkëdhelte me dorën e madhe si panxhë. Pastaj befas ndali përballë meje dhe fytyra e gjerë iu vrenjt.

— A të mendojnë ata? — më pyeti duke zgjatur dorën tej, nga mund të ishte qyteti.

— Jo, — thashë.

Cule Yakoja më ngriti në duar me rrëmbim dhe mua m'u duk në çast se mund të më vërtiste mes qiellit të vjeshtës si një shpend fluturues. Më shihte me një pamje të ngrysur e të pikëlluar.

— Unë vij, — tha, — në rast se të prekin qoftë edhe një fije floku, vij dhe bëj gjëmën.

Qëndroja mbi supet e tij të larta si mbi një kreshtë mali. I shikoja fytyrën e gjerë të mbushur me mirësi dhe e ndieja se ai ishte i gatshëm të më mbronte me çdo mënyrë.

— Unë vij!

E kisha aq të pamundur t'i ankohesha atij këto gaste, sa ç'e kisha të pamundur të përballoja dallgët e gëzimit që ma rrihnin gjoksin me furi.

— Ti vjen, — thashë duke u dridhur në krahet e tij të gjatë e të fuqishëm, — vjen! — klitha në ekstazë dhe qesha me ngazëllim për një kohë të gjatë, kurse nga sytë më rrokulliseshin lot të mëdhenj e të nxehtë. Viktori i hallë Kristinës shikonte si i magjepsur.

— Vij, Kolë. Për atë bukë që vij!

Unë u ngjeshja në gjoksin e tij të gjerë dhe thosha: ti vjen, vjen, vjen!

*

*

*

Zoti Kristaq rrinte deri në mesnatë duke thurur plane për fabrikat e tij të ardhshme. Zonja Meri qepi një fustan jeshil si lëkurë bretkose, të gjatë deri te kyçet e këmbëve. Rrinte tërë kohës përpara pasqyrës, lëvizte si balerinë, shkëndijonte sytë dhe rënkonte nga një lumturi e paduruar. I panjohuri i çuditshëm filloi të vinte kaq shpesh, saqë mua tani më ishte fiksuar në mënyrë krejt të qartë pamja e tij.

Një ditë erdhi për vizitë një grua e re dhe e bukur që u prit në mënyrë shumë të bujshme. Zonja Meri urdhëroi të blinin liker. Zonja e porsaardhur i tha se ajo sot dukej e mahnitshme, si gratë e salloneve të Parisit. Kishte qenë zonja Meri në Paris? Jo, s'kishte qenë. Sa keq. Ky qytet s'e kishte hak një bukuri të tillë. Zoti Kristaq... Ah, po burrat nuk duhet të jenë të bukur, moj e dashur. As të rinj. Gruaja ka nevojë për xhelozë si lulja për ujë. Pak. Sa bukur kur burri të do me frikë, kur të bie në gjunjë si skllav, kur dridhet nga dantella e bardhë e këmishës si nga një tërmet. Zonja Meri nxirrte tymin e duhanit me vrull dhe dëgjonte si e shtangur. Bukuria të bën të guximshme dhe misterioze si zjarr parajse. Zonja Meri kërkoi përsëri liker. Pastaj ato u ngritën dhe shkuan te pasqyra e tualetit. Folën për furçat, pincat, për të kuqtë

e buzëve, për pomadat, kremrat. Ca gra s'dinë të bëjnë tualet. O perëndi! Duken si shtriga të llahtarshme. Pastaj eleganca. Trupi i hollë, i hollë si nëpërkë. Ca gra hanë brumëra dhe lëvizin nëpër rrugë si dollap kuzhine. Pastaj të sjellurit. Ah, si sillen italianet, parizianet, londinezet. Edhe zonja Persefoni (kështu e quanin të porsaardhurën) s'kishte qenë ndonjëherë në kryeqytetet e mëdha të botës, po ç'rëndësi kishte kjo. Ajo mund të fliste për gratë e salloneve të këtyre vendeve më mirë se për veten. Finesa e tyre, të ecurit, naiviteti fëmijëror, që i trullos burrat, fjalët që u gurgullojnë nga goja si rrëke tingujsh fantastikë. I ndihmon dhe gjuha, moj e ëmbla ime. O perëndi, ç'gjuhë, si ligjërim violine. Kurse kjo gjuha jonë është e ashpër, kërcet sikur thyen lajthi me dhëmbë. Zonja Meri, sidoqoftë, ishte ndryshe, ajo i përballonte si luaneshë gjithë vështirësitë që i dilnin përpara një gruaje për të qenë e bukur.

Pastaj sallonet e tyre! Gruaja e ndien veten si një flutur mbi pasqyrë. Ah, ç'kulturë, zonja Meri, ç'edukatë! Te ne ca burra mendjetrashë mund t'i thonë gruas pa pikën e turpit *buallicë* në sy të të gjithëve, kurse andej, edhe kur burrat janë të detyruar të të fyejnë, e bëjnë një gjë të tillë me aq takt dhe aq bukur, saqë të vjen qejf t'i dëgjosh. Ja, italianët e këtushëm, për shembull.

Gruaja që fliste kështu, kishte një fytyrë të bardhë, me sy të mëdhenj mjegullorë, sikur jentonte në një botë fantastike. Ajo fliste me ngadalë, me kujdes, me një akcent melodioz e me një përveuajtje femërore që i jepte tërë pamjes

së saj një trishtim elegant. Zonja Meri rrinte përpara saj e pafuqishme dhe e bindur si një skllave. Ajo i tha zonjës Persefoni se praninë e saj nuk ia zëvendësonte askush, se zëri i saj dukej sikur vinte nga një botë tjetër.

Zonja Meri dridhej kur fliste kështu dhe unë mendoja se sikur këto çaste të hynte këtu zoti Kristaq dhe t'i thoshte asaj *lopë*, ajo në çast do të vriste atë ose veten. Pastaj bisedat e tyre u bënë më intime, me pëshpërimita si pëshpëritja e ujit mbi zaje. Zonja Meri tha se, të ishte e bukur, ishte shumë e vështirë. Ajo do ta kishte më të lehtë të përballonte një skuadër pushkatimi, sesa ca situata që u vinte jeta përballë grave të bukura. «Besoj se më kupton se ç'dua të them, e dashur?»

Atë ditë zonja Persefoni ndenji gjatë te ne. Kur u largua, i kërkoi leje zonjës Meri të vinte sërish. Mua më la në dorë dy monedha metalike.

Zonja Meri e përcolli shumë e prekur shoqen e vet. Kur iku ajo, zonja Meri mbylli derën e jashtme, ndenji disa çaste duke përgjuar e menduar hapat e shoqes së shtrenjtë, që humbën në kalldrëmin e rrugës dhe u fut brenda duke psherëtirë. Vajti me vrap te pasqyra, e pa fytyrën me dashuri dhe mallëngjim sikur ta shikonte për herë të parë dhe fshiu me një pece të bardhë të kuqtë e buzëve.

— Kola, unë jam e lodhur, po shkoj të shtrihem pak. Kujdes Beniaminin! Mos u shkëput asnjë çast prej tij!

— Po, zonjë!

Ajo shkoi ngadalë, mbylli derën me kujdes dhe në korridor u dëgjuan hapat e saj të nxi-

tuar që u ndërpre në nga gërvishtjet e një çelësi dhe pastaj nga përplasja e një dere.

Beniamini nuk po qante dhe unë vajta në dritare. Isha shumë i lodhur. Të hollat që më dha zonja Persefoni, më përvëlonin dorën si thëngjij të ndezur. Ishte mesditë, me një qiell të rëndë bojë plumbi. Në rrugë kalonte një djalë i vogël, në moshën time. Kishte veshur një xhakëtë të madhe burrash, me mëngë të shkurtra, që s'merrej vesh se ç'ngjyrë mund të kishte pasur kur kishte qenë e re. Ai fishkëllente i çinteresuar dhe i lëvizte duart sa andej-këtej si një dirigjent. Pantallonat gjithashtu i kishte të mëdha, të gjera, të shkurtra e të grisura. Dukej si një burrë i shkurtër. Ëkte dhe shikonte për-qark më nge. Atë çast ai m'u duk fëmija më i lumtur në botë. Ishte i lirë, mund të bënte ç'të donte, mund të shkonte kudo, pa pasur frikë se mund t'i fliste kush. Hapa dritaren. Ai ngriti kokën dhe më pa për një kohë të gjatë pa folur. Pastaj qeshi me shpoti, vuri gishtin tregues në hundë dhe nxori gjuhën.

— Pip, pip. Ej, kush je ti?

Unë buzëqesha lehtë. Nuk mund t'i flisja. Buzëqeshja ime atij iu duk si tallje. Hapi xhakëtën, i dha fytyrës një pamje të egër prej luftëtari, ngriti grushtet lart, i vërtiti me kërcënim nëpër ajër dhe më tha se do të m'i bënte hundët përshesh me grushte.

— Pse s'flet?

Unë buzëqesha përsëri.

— Memec, shurdh, bllum, bllum!

Nxora nga xhepi njëren prej monedhave që më dha zonja Persefoni dhe ia hodha. Ai më pa i

habitur. Pa monedhën, vështroi përçark i trullo-
llor, pastaj u ul, e mori monedhën dhe e rro-
tulloi disa çaste nëpër duar pa u besuar syve.
Unë qëndroja në dritare dhe buzëqeshja. Dja-
loshi i panjohur më shikonte i ngurosur. Belbëzoi
diçka që nuk e mora vesh, pa përsëri përçark me
dyschim dhe në çast iku me vrap. Herë pas here
kthente kokën nga pas i trembur. Kur ai u zhduk,
unë shkova dhe u ula përballë Beniaminit. Po e
shikoja si flinte, si i pluskonte një nerv në
qoshe të buzëve dhe në çast më erdhi në kokë
mendimi se unë nuk e urreja këtë fëmijë që
qante vazhdimisht dhe që më mbante të lidhur
si skllav pranë vetes. Herë pas here unë kisha
vënë re që Beniamini më shikonte me kureshtje
dhe më buzëqeshte duke u hedhur në krevat.
Edhe kur e mbante në duar zonja Meri, ai shi-
konte nga unë, qeshte dhe zgjaste duart ta merr-
ja. Ç'faj më ke ti, more Beniamini i vogël... Pas-
taj hodha sytë nga muri. Luani jeshil u trondit.
Krifa e kuqe u shkund në çast nga një vrundull
zjarri dhe përçark filluan të binin copa flakësh.
Goja e madhe e shtazës u hap dhe prej saj doli
një ulërimë e llahtarshme që më ngriu gjakun.
Luani filloi të lëvizte. Hidhej përpjetë, dridhej,
ulërinte, por s'mund të dilte dot nga katërkëndë-
shi i bezes. Isha bërë qull në djersë. U shtriva
në tokë duke rënkuar, mbulova fytyrën me duar,
u mblodha kruspull dhe prisja nga çasti në çast
që luani të më ngulte në kurriz thonjtë e putrave
të tmerrshme. Në gojë kisha një shije të athët
sikur të kisha ngrënë kumbulla të tharta. Nuk e di
sa ndenja ashtu. Befas dëgjova ca fishkëllima të
mprehta dhe një zë fëmije që fliste jashtë dritares.

— Ej, ti, ej, ti!

Ngrita kokën dhe pashë nga muri. Luani qe qetësuar. Atëherë u ngrita i tëri dhe, duke parë vazhdimisht nga luani, shkova në dritare. Ishte ai djali me xhaketë dhe pantallona prej burri. Në dorë mbante një copë të madhe bukë dhe e hante me oreks. Xhepat e xhaketës dhe të pantallonave i kishte të fryrë. Porsa më pa, buzëqeshi i lumtur. Nxori nga xhepi një mollë të madhe, e fërkoi te gjunjët dhe filloi ta hante me bukë.

— Ej, kush je ti?

Unë nuk i fola. Kisha frikë mos zgjoja Beniaminin, mos shqetësoja zonjën që qe s'di se ku e lodhur.

— Djali i zotit Kristaq je ti?

Unë tunda kokën në shenjë mohimi.

— Kushëriri?

Unë tunda kokën përsëri në shenjë mohimi.

— Po ç'je ti? — tha djali me zë të lartë e disi të inatosur.

Unë heshtja.

— Të vij aty brenda? — tha dhe iu afrova murit të shtëpisë.

— Jo, — belbëzova unë dhe lëvizja duart i trembur.

— E mirë, mirë, nuk vij.

Djali shkoi dhe u ul në qoshe të rrugës. Hante dhe shikonte nga unë i habitur.

— Nuk del asnjëherë nga shtëpia ti?

Unë pohova me kokë.

— Shërbëtor te zoti Kristaq je?

Unë pohova përsëri me kokë.

Djali i panjohur më pa me keqardhje. Buka për një çast i mbeti në dorë.

— Ej, shiko, mua më quajnë Gani. Po ty si të quajnë?

— Kola! — thashë me zë të ulët.

— Si?

— Kola!

— Nuk të dëgjoj fare. Po pse s'flet me zë të lartë?

Unë bëra disa shenja. Doja t'i thosha se zgjoja Benjaminin.

— Si?

Përsëri bëra shenja.

— Ej, ti, shiko, nuk të lënë të flasësh me zë të lartë?

Unë pohova me kokë.

— Po pse s'të lënë?

Unë buzëqesha.

— Ej, katundar je ti?

Unë pohova.

— Mirë, — tha Ganiu dhe filloi të hante si i babëzitur, duke e mbajtur bukën me të dyja duart.

— Ej, ti! Ha bukë ditë për ditë?

Unë pohova me kokë.

— Ha?! — pyeti ai përsëri i habitur.

Unë përsëri pohova me kokë.

— Do një kokërr mollë!

— Jo, jo, — belbëzova dhe tunda kokën.

— Pse s'do? Po mollë ha sa të duash?

Unë tunda kokën në shenjë mohimi.

Djaloshi i panjohur e la befas bukën përgjysmë sikur të kujtohej për diçka, hapi palat e xhakëtës dhe e mbështolli pjesën që i kishte mbetur

në një xhep të brendshëm të madh si qeskë.

— Do ta çoj në shtëpi, — tha dhe buzëqeshi.

Dhe unë i buzëqesha nga larg.

— Ej, ti, shiko, po të duash, unë shkoj dhe e shaj zotin Kristaq. Të shkoj?

Unë tunda kokën në shenjë mohimi.

— Pse të mos shkoj? Ke frikë?

— Po, — thashë duke tundur kokën.

— Të rreh zoti Kristaq?

Unë heshta:

— Të rreh?

— Jo!

— Ej, po mua më njeh ti?

— Jo.

Djali pa përqark, u ngrit më këmbë, shtyu trupin disi prapa, sikur në këtë mënyrë mund të ishte më pranë meje, vuri duart në gojë në formë hinke dhe foli duke rrotulluar sytë me dinakëri:

— Ej, po pse m'i dhe ato, kur s'më njeh?

Unë tunda kokën si për të thënë «ja ashtu kot».

— Të erdhi keq?

— Po!

— Mirë. Shiko, të iki unë tani?

— Po?

— Do të vij prapë.

Unë tunda kokën dhe qesha.

— Ej, shiko. Nuk vij për ashtu, — tha dhe fërkoj gishtin e madh me gishtin tregues. Unë qesha.

— Mirupafshim!

Filloi të ecte ngadalë, me kokën nga unë, i mbushur përplot me mirënjohje.

— Mirupafshim!....

Zonja Persefoni erdhi një të diel për të më marrë në shtëpinë e vet. Zonja Meri e priti kërkesën e saj me shumë bujari. U kujdes vetë, që unë të lahesha, të rregullohesha dhe të vishja rrobat më të pastra e më të mira. Në çastin e fundit më hoqi mënjanë dhe më këshilloi ta mbyllja gojën përpara çdo pyetjeje që mund të më bëhej atje për të dhe për gjithçka që kishte të bënte me shtëpinë ku shërbeja, ndryshe ajo do ta merrte vesh me siguri, për këtë të mos më gënjente mendja, dhe atëherë do ta paguaja aq shtrenjtë atë ditë, saqë s'kisha për ta harruar kurrë. U betova se s'kisha për t'iu përgjigjur asnjë pyetjeje të tillë. Pastaj shkuam te dhoma ku na prishte zonja Persefoni, u përshëndetëm me zonjën Meri, që na përcolli deri jashtë dhe u nisëm. Qielli ishte i veshur me re të bardha e të lehta. Mes tyre çante një vezullim i zbehtë diellor që e kridhte tërë qytetin në një dritë të butë e të kaltër. Ecnim nëpër rrugicat e ngushta-me kalldrëm të kapur dorë për dore. Shihja anës rrugës sofatë e lyera me gëlqere të bardhë, portat e drunjtat të shtëpive që hapeshin e mbylleshin nga njerëz që na përshëndetnin, fëmijë të zbathur që luanin në vijën e ujit me anije të vogla prej letre dhe më dukej sikur ky mëngjes ishte kurdisur dhe punonte si sahat nga gëzimi im. Nëpër gurët e kalldrëmit kërcitnin këpucët me taka të larta të zonjës Persefoni, dhe mua çdo goditje më dukej si një kambanë lumturie. Ecja si i dehur, sikur të kisha braktisur një herë e përgjithmonë të gjitha brengat.

Diku, në krye të rrugës pamë të vinin drejt nesh një grup me plaka. Ato rrinin të ngjeshura

me njëra-tjetrën dhe lëviznin ngadalë si një tym i zi.

— Janë qirickat e qytetit, — tha zonja Foni, — shkojnë në kishë.

Kur plakati erdhën pranë, zonja Persefoni përkuli trupin, vuri dorën në kraharor dhe ndenji kështu për një kohë të gjatë, derisa plakati e heshtura kaluan.

— Në shtëpi do të takojmë Qiramanën (kështu i fliste ajo vjehrrës). — Ti duhet të përkulesh dhe t'i puthësh dorën. Dhe dëgjo. Kola, nuk duhet ta shohësh gjatë në fytyrë. Ajo ka një lungë të madhe në sy dhe merr inat këdo që mund t'ia shohë. Ti duhet të sillesh sikur s'të bën përshtypje asgjë e keqe në pamjen e saj.

Unë pohoja i bindur.

Shtëpia kishte një oborr të madh, të shtruar me pllaka guri dhe të rrethuar me mure të larta. Hymë në të, pastaj trokitëm në derën e mbyllur dhe pritëm për disa çaste. Zonja Foni më shtrëngonte pranë vetes dhe më shikonte me adhurim. Mua më dukej vetja më i vogël nga ç'isha dhe ndoshta për herë të parë në jetë pata dëshirë të llastohesha.

— Qiramana!

Plaka doli në prag të derës me një trup të madh si shkëmb. Dhe ajo ishte veshur krejt në të zeza si qirickat që porsa kishim takuar. Unë kapa dorën e saj të trashë, e afrova pranë vetes dhe e putha. Plaka u largua një hap dhe po më shikonte e heshtur. Ngrita kokën dhe e pashë me një buzagaz të nënshtruar, që e kisha përgatitur për të gjatë rrugës. E pashë vetëm një çast dhe vura re se lunga i mbulonnte si një

perde e kuqe mishi gati krejt syrin e djathtë. Megjilhatë m'u duk se në pamjen e saj nuk kishte asgjë të tmerrshme dhe të frikshme.

— Djalë i shkretë, — tha pas pak plaka me zë të trashë e të dhembshur. — Do t'i lutem Shën Marisë për ty. Do t'i lutem që të të falë zoti dhembshurinë e tij. — Pastaj këputi një tufë të madhe borziloku nga trina dhe ma dha në dorë. Zonja Persefoni buzëqeshi e kënaqur. Qiramana më kishte marrë me sy të mirë. Pas pak porta u hap me vrull dhe brenda hynë dy fëmijë të vegjël, me një zhurmë të tmerrshme si një tufë elefantësh. Ishin dy djem 7-8-vjeçarë me fytyra të lodhura e të qeshura.

— Janë nipërit e Qiramanës, — tha zonja Persefoni, — EĴani këtu, — i urdhëroi pastaj ajo të vegjlit. Ata u afruan buzagaz.

— Takohuni me Kolën. Ky është Janaqi, kurse ky është Sotiri, — m'u drejtua mua. — Kolën sot e kemi mik shtëpie, ndaj gjithë ditën do të luani me të. T'i jepni gjithë lodrat që keni. Dëgjuat?

Qiramana, gjithashtu, ua përsëriti një gjë të tillë me zërin e saj të trashë. Fëmijët dolën sërisht me bujë nga shtëpia dhe erdhën pas pak me duart të mbushura me lodrat e tyre. Ata m'i vunë të gjitha përpara; një top të madh llastiku, një bori vezulluese me fiongo, fizarmonikë goje e plot të tjera. Ndenjën tërë ditën me mua, qeshnin, më vinin rrotull të dy dhe më shikonin të habitur sikur të vija nga një planet tjetër. Plaka dilte herë pas here nga shtëpia dhe na jepte arra, fiq të thatë a ndonjë kokërr mollë. Sjellja ime e druajtur asaj i bënte përshtypje. Zonja

Persefoni, gjithashtu, më vinte pranë dhe më pyeste e shqetësuar mos isha mërzhitur apo mos doja gjësendi. Pastaj rrinin të dyja në një kënd të oborrit dhe diç pëshpëritnin duke parë nga unë me fytyra të prekura e të trishtuara....

Burri i zonjës Persefoni erdhi në drekë. Por-sa e pashë, ngriva në vend. S'kisha asnjë dyshim se ai ishte njeriu që kapërcente murin dhe hyn-te në shtëpinë e zonjës Meri. Zonja Foni më çoi tek i shoqi duke më hedhur herë pas here vështrime të vëmendshme. Dora që më mbante, i dridhej. Burri më buzëqeshi me dashamirësi, më kapë për faqesh, i tha së shoqes «mirë bërë që e more» dhe u fut në njërën nga dhomat. Pas tij hyri brenda dhe plaka.

— Kola, ç'pate ashtu? — më pyeti tërë ankth zonja Persefoni.

— Asgjë, — belbëzova, — asgjë.

— Si asgjë? Pa shih, ti je bërë si meit.

Fytyra e saj fërgëllonte e tëra, dridhej dhe ishte e mbushur me aq dëshpërim e pritje, sa unë në çast desh i tregova gjithçka. Po befas më doli përballë pamja kërcënuese e zonjës Meri dhe heshta.

— Po ti tregomë, Kola, çfarë ke? — ajo lutej duke parë me frikë mos vinte njeri nga dera.

— Nuk kam asgjë, — ngula këmbë më në fund, — asgjë.

— Si të duash, Kola, — ajo largohej pa ma hequr vështrimin e dëshpëruar, — si të duash.

Mua nuk më luhej më. Rrija si i ngurosur në mes të oborrit. Fëmijët zgjatnin drejt meje fytyrat e habitura dhe vinin rrotull të heshtur.

Unë e ndieja veten si të rrethuar mes flakësh dhe tani nuk kisha veçse dëshirën për t'u larguar sa më parë. Në trup kisha boshllëkun torturues që kanë njerëzit që parandiejnë një fatkeqësi. Fëmijët më në fund u mërzitën nga kjo heshtje, e humbën kërshërinë për të më parë të habitur, hapën portat dhe u larguan duke qeshur nëpër rrugë.

Drekën e hëngrëm të katër bashkë. Burri i zonjës Persefoni hante i uritur dhe mes pauzave tregonte për përgatitjet që po bëheshin në nënprefekturë për një pritje të madhe, ku mendohej se do të që dhe ai. Qiramana përvëlohej nga kureshtja për të dëgjuar gjithçka deri në hollësitë dhe s'reshtte së pyeturi të birin. Ajo as që e kishte prekur pjatën e vet. Donte të sigurohej veçanërisht nëse i biri do të merrte pjesë në atë pritje të madhe. Kjo ishte më se e vërtetë. Nënprefekti ia kishte thënë disa herë me gojën e vet, dhe s'mjaftonte kjo, por e kishte quajtur bile edhe si njeriun më të përshtatshëm. Këtu Qiramana u mallëngjye krejt dhe, teksa lavdëronte mençurinë, zotësinë dhe bujarinë e pashembullt të nënprefektit, shtrëngonte buzët që të mos shpërthente në lot. Zonja Persefoni ndiqte, gjithashtu, fjalët e të shoqit, por dukej që ishte krejt e pavëmendshme dhe e hutuar. Vështronte herë pas here nga unë, më nxiste të haja, pyeste nëse doja këtë apo atë gjë dhe prapë nuk që më e kujdesshme si më parë. Edhe burri shikonte ndonjëherë nga unë, por kishte një vështrim aq ironik dhe provokues, sa që unë ulja kokën mbi tavolinë dhe ndieja që buka më mbetej në grykë.

Kur mbaroi dreka, burri u ngrit nga tavolina i vrenjtur, e pa të shoqen për një kohë të gjatë me një pamje prej sfinksi, më përshëndeti dhe mua me një vështrim po aq të pakuptueshëm, tha «besoj se do të na vish edhe herë tjetër» dhe u largua. Edhe unë dola pas tij dhe shkova në oborr. Pasditja ishte e ftohtë. Hija e rëndë që mbulonte oborrin e madh e të shkretë, më rëndonte si një peshë e mundimshme. Pas pak erdhi dhe zonja Persefoni. Më tha se ishte ende herët për të shkuar dhe më ngjiti lart në njërën nga dhomat e shtëpisë. Ajo ishte një kthinë e rrethuar me minderë, me pak orendi dhe me një tavolinë të vogël në mes, ku ishte vendosur një gramafon i kuq.

— A do të dëgjosh këngë? — më pyeti.

— Po, — shqiptova me zor.

— Çfarë kënge do të dëgjosh?

Unë ngrita supet. Ajo hapi gramafonin dhe filloi të shikonte pllakat me kujdes. Pastaj befas u ndal, erdhi tek unë dhe më vuri duart në supe. Ishim aq pranë, sa që ndieja dihatjet e saj ngashëruese.

— Kola, a ma do të keqen ti mua? — S'ki-sha parë ndonjëherë fytyrë me pamje aq të mjerë.

— Jo! — thashë.

— Edhe unë ashtu mendoj. Ti je kaq i mirë! Kola, pse u trembe ti nga im shoq?

— Nuk u tremba.

— Si nuk u trembe?! — ajo kafshoi buzët fort dhe m'i qepi sytë për një kohë të gjatë me dëshpërim. — Për herë të parë e shikon ti atë?

— Po.

— Nuk e ke parë te Meri?

— Nuk e kam parë.

— Po ai vjen atje kur s'është zoti Kristaq. Kola, tregomë, në rast se nuk do që unë të vdes nga dëshpërimi. E ke parë?

— Jo, — belbëzova.

Ajo u ngrit dhe shkoi në dritare. Ndenji aty aq kohë e përkulur, saqë mua m'u duk një jetë e tërë.

— Kola, me të vërtetë nuk do të më tregosh?
— ajo lutej dhe kishte një pamje të druajtur sikur kërkonte lëmoshë. — Tregomë, Kola!

— Po unë s'kam ç'të të tregoj!

Ajo erdhi për një kohë të gjatë rrotull dhomës së vogël. Supet i dridheshin nga një rënkim i mbytur. Unë isha gati të ngrihesha, t'i bija në gjunjë dhe t'i tregoja gjithçka, po në çast më kujtohej pamja kërcënuese e zonjës Meri dhe heshtja. Befas zonja Persefoni erdhi me vrull drejt meje. Sytë iu zmadhuan dhe iu mbufatën sikur do t'i pëlcitnin. Fytyra i kishte marrë një ngjyrë balte të pajetë.

— Ti di, — klithi dhe më kapi me forcë nga flokët, — ti di, o përbindësh, di gjithçka. Mos thuaj që s'e ke parë tim shoq që vjen tek ajo bushtër. Unë e di ku i merr ai ata lekë të fëlliqur.

Vështroja i mekur. Koka më përvëlonte nga dhembja sikur të më rripnin lëkurën. Ajo ishte shëmtuar nga zemërimi. Kishte një vështtrim si prej të marre. Nuk qaja, nuk kundërshtoja dhe as që kërkvoja ndihmë. Vetëm mendoja se sa e rëndë ishte kjo rrokullisje në dëshpërim. Më në fund ajo u lodh dhe qau me ngashërim

sikur të ishte përpara trupit të një të vdekuri. E shikoja ashtu të palëvizur, të mbytur në një dritë të mugët që sa vinte e rëndohej dhe mundohesha të lëvizja, të thosha diçka. Ajo vazhonte të rrinte e dëshpëruar, me vështrim të tendosur, armiqtësor dhe dukej aq e braktisur dhe fatkeqe, sa që më vinte keq. Mundchesha të flisja, bile më dukej sikur po klithja, por s'munda të thosha asnjë fjalë. Veç u ngrita nga minderi, qëndrova përpara saj dhe i thashë se doja të ikja.

— Shko, — tha ajo, — shko, — dhe më hapi derën ngadalë pa më parë në sy.

Zbrita shkallët, kalova nëpër oborrin e qetë dhe dola me vrap në rrugën me kalldrëm. Errësira i fshikte rrugët me një erë që rënkonte e të priste si brishtë. Nuk dija ç'të bëja. Ktheva sytë nga dera gjysmë e hapur dhe pashë zonjën Persefoni të vinte drejt meje. Aty mes muzgut të dendur dukej e tretur, e zvogëluar dhe e kërrusur si një plakë. Bile edhe flokët e verdhë i dukeshin si të thinjur. Më vinte të bërtitja sa të shurdhoja natën: Po ku janë njerëzit?

— Prit, Kola, duhet të të çoj unë në shtëpi.

Erdhi pranë meje me hapa të lodhur. Ecnim ngadalë, të heshtur, si dy të dëshpëruar të barbartë. Ashtu kokulur, në rrugët e ngushta të ndriçuara zbehtë nga fenerët e porsandezur, ngjanim si dy të mjerë që shoqërojnë një funeral të padukshëm. Pranë shtëpisë ajo më ndali dhe më pyeti e qetë:

— Kola, do t'i tregosh zonjës Meri për mua?

— Jo, — thashë.

— Unë të besoj, — pëshpëriti, — edhe sikur

ti të më kishe thënë se e ke parë tim shoq që vjen te Meri, prapë nuk ndreqej gjë. Unë e di që ai për pará mund të bëjë çdo gjë, mund të sakrifikojë edhe syrin tjetër të së ëmës. Lum ti që s'kupton asgjë, Kola! Tani ik, — tha duke më shtrënguar kokën me dhëmbshuri, — nuk mund ta shikoj atë grua të poshtër. Ik, as ty nuk dua të të shikoj...

* * *

Kohët e fundit zoti Kristaq rrinte në shtëpi shumë pak. Ishte dhënë i tëri pas ëndrrës për të ngritur fabrika të mëdha. Ënergjitë e tij të përgjumura në trupin e vogël e të rrëgjuar befas ishin zgjuar, e kishin tronditur të tërin dhe ai po u epej tani atyre me një dëshirë të flaktë, të papërmbajtur e të egër që e bënin zonzjën Meri të trembej dhe ta fshihte sa të mundte lumturinë e vet misterioze. Ai rrinte vazhdimisht me pronarët e një shoqërie të sapokrijuar. Me zonzjën Meri fliste rrallë për një gjë të tillë, por, kur fliste, unë shikoja që ai ndryshonte krejt, dridhej si epileptik, merrte flakë, dhe flokët e rrallë i ngriheshin përpjetë nga tronditja si krifa e luanit në mur.

Pas kësaj në shtëpinë e zotit Kristaq u bënë disa ndryshime. U rregulluan dy dhoma të reja. Me një makinë erdhën kolltukë të rëndë e të shtrenjtë. Dy hamej sollën qilima të mëdhenj me ngjyra vezulluese që i shtruan në çast në sallonin e pritjes. Zonja Meri ishte bërë e heshtur

dhe vinte vërdallë nëpër shtëpi si somnambul. Rrinte shpesh pranë Beniaminit dhe e shikonte si e magjepsur, me një vështrim të paralizuar. Edhe zoti Kristaq kishte ndryshuar. Tani ai rrinte më të shumtën e kohës në shtëpi. Shpesh vinin për vizitë ca burra të rëndë e të ngrysur që i puthnin dorën zonjës Meri duke përkulur kokën deri në gjoks dhe që mbylleshin brenda e bisedonin për orë të tëra me zotin Kristaq. Për t'u shërbyer atyre, zoti Kristaq dërgonte s'di se ku kuzhinieren plakë dhe thërriste një vajzë të re që vishej bukur dhe që ecte tërë dinjitet, sikur të ishte princeshë përralle. Kur largohej, ajo merrte të hollat që i jepte zonja Meri. E quanin Mukades. Në fillim ajo mua s'më fliste fare, bile më kishte dhe inat. Nuk e di pse kishte krijuar mendimin se mua më kishte caktuar zoti Kristaq ta ruaja!

— Pse më gjurmon? — më tha një mbrëmje në mes të korridorit. Në duar mbante një servis të madh farfurie të mbushur me gota e pije të ndryshme.

— Nuk të spiunoj, — thashë i prekur.

— Po pse më ndjek ngado që vete? — tha ajo me ton disi më të zbutur.

— Të shikoj, — thashë unë me naivitet.

Ajo më pa për një kohë të gjatë me vëmendje, pastaj tundi kokën, qeshi dhe më pyeti me ton krejt miqësor:

— Përse më shikon?

— Kot, — thashë unë, — kot fare.

— Mirë, — tha ajo duke më vështruar përsëri me vëmendje, — më prit këtu.

Shkoi në dhomën ku rrintin zoti Kristaq me

mysafirët. Atje që dhe zonja Meri. Pas pak doli, më afroji pranë vetes dhe shkua në ballkonin e shtëpisë.

— Unë kujtoja se ti më spiunoje, — tha.

— Kurrë, — i thashë, — sikur të më bëjnë copa-copa nuk do të them asnjë fjalë për ty.

U betova me zjarr, megjithëse nuk e dija se për se mund ta spiunoja. Mukadesi më tha se edhe ajo ishte si unë, shërbëtore, se ishte fillikat. Gjithashtu më tha se zoti Kristaq do të krijonte me gjithë këta njerëz që vinin këtu një shoqëri të madhe, që, së bashku me ca italianë të pasur, do të ndërtonin në qytetin tonë dhe në të tjerë fabrika të mëdha.

Njëherë erdhi te zoti Kristaq një inxhinier italian me të shoqen. Ardhja e tij e tronditi gjen-djen. Vetë zonja Meri, pasi i priti, doli jashtë dhe i dha Mukadesit këshilla të panumërta për pijet që do t'u serviroshin dhe për mënyrën si do t'u serviroshin. Aty, në korridor, Mukadesi u urdhërua të bënte disa prova, të cilat nuk e kënaqën sa duhej zonjën Meri. Mukadesi duhej të ishte e qeshur. Ah, po nuk duhet të qeshësh si budallaqe, moj shtrigë! Fytyra duhet të të ndrijë nga kënaqësia që shërben në shtëpinë e zotit Kristaq dhe vetëm kaq. Duhet të vish me hapa të vegjël, të qetë. Në fillim duhet të shkosh te zonja. Kujdes mos i shkelësh fustanin. Pas pak erdhi zoti Kristaq. Ai ishte tërbuar nga njëfarë Qeramudini, që, gjithashtu, ishte në sallon dhe i fshinte hundët me kurrizin e dorës pa pikë turpi mu përpara fytyrës së inxhinierit italian. Qeramudini, sipas inatit të zotit Kristaq, ishte hajvani më i madh i dynjasë, ishte një derr i fëlliqur që

të nxinte jetën po ta kishe në sallon kur të vinte për vizitë inxhinieri italian me të shoqen. Zoti Kristaq ishte aq i revoltuar prej këtij Qeramudinit, saqë i tha zonjës Meri se do të jepte tërë pasurinë e tij sikur këto çaste të kishte mundësi ta nxirrte atë jashtë me shkelma, ta rrokulliste nëpër shkallë dhe ta qëllonte me pëllëmbë në atë fytyrën e trashë si dhogë e kalbur. Ta qëllonte sa të ngopej. «O zot, sikur të kisha mundësi», shkrofëtinte zoti Kristaq.

Zonja Meri u mundua ta qetësonte dhe për mundimin që bëri, u shpërblye me një «lopë» të zakonshme. Ajo e gëlltiti inatin duke u dridhur, siç bënte vazhdimisht kohët e fundit. Zoti Kristaq shkoi para derës së sallonit, ndali disa çaste, provoi disa herë të buzëqeshte dhe, më në fund, kur iu duk se kishte një pamje të denjë, u fut brenda. Zonja Meri shkoi pas tij. Mukadesi shpërtheu në një të qeshur të papërmbajtur dhe vra-poi të merrte servisin me pije.

— Ej, ti, ej, ti! — fliste Ganiu. Kishte ardhur dhe një herë tjetër për të më parë. Fliste vetëm ai, kurse unë përgjigjesha me lëviziet e kokës e të duarve si një shurdhmemec. Ishte shumë e mundimshme ta kompensoja memecërinë. Dialogu ynë ishte njëkohësisht i dhimbshëm e qesharak. Dola në dritare.

— Si je?

Unë tundja kokën majtas e djathtas, që do të thoshte se isha mirë.

— Ej, shiko! Ai zoti Kristaq është shumë i poshtër.

— Ç'thua kështu? — iu drejtova unë i trem-

bur dhe u mundova me të gjitha gjestet t'i komunikojë alarmin tim.

— Kot e mbron. Ti s'e njeh, ndaj bën kësh-tu. Sikur të mos të njihja ty, do ta shaja sa të ngopesha.

— Mos fol me zë të lartë, — thashë, — zoti Kristaq është këtu.

— Çfarë thua?

— Zoti Kristaq është brenda, — thashë duke bërë me shenjë.

— Nuk të marr vesh. Ej, Kola, (ai më në fund e kishte mësuar emrin tim). Kola, pse s'zbret poshtë?

— Kam punë, — thashë.

— S'të lënë të zbresësh?

Në atë kohë pranë meje erdhi Mukadesi. Ajo, si duket, e kishte dëgjuar gjithë bisedën tonë. Ganiu u tremb dhe shkoi në qoshe të rrugës. Kujtoi mos ishte gruaja e zotit Kristaq.

— Ke qejf të shkosh poshtë të takohesh me atë djalin? — pyeti Mukadesi.

— Po!

— Shko! Kur të të kërkojnë, dal unë e të flas.

Zbrita poshtë me vrap. Hapa derën dhe renda për te Ganiu. Ndenjëm për një kohë të gjatë pa folur. S'dinim ç'të thoshim. Veç kësaj, ishim mësuar të flisnim nga larg dhe na dukej disi e çuditshme që ndodheshim përballë njëri-tjetrit.

Rrënim, shiheshim dhe qeshnim si budallenj.

— Gruaja e zotit Kristaq të la të vije?

— Jo, — thashë. — Ajo është shërbëtore Mukadesi.

— Ke frikë nga ajo?

— Jo! Ajo është si unë.

— Po ajo e do zotin Kristaq?

— Jo!

— Po ti pse s'më lë pastaj ta shaj zotin Kristaq?

— Shaje, — thashë. — Ç'ke që më kërkon leje mua?

— Zoti Kristaq e pushoi babanë nga puna, ndaj dua ta shaj.

— Shaje, — thashë për së dyti, — vetëm emrin tim mos e zër në gojë.

— Pse, kush do të më pyesë mua për ty? Unë qesha.

— Po të duash ti, unë nis e shaj që tani.

— Jo, thashë i trembur, — këtu mos e shaj. Ndryshe, zoti Kristaq do të kujtojë se të kam mësuar unë.

— Mirë, — tha Ganiu, që nuk më kundërshtonte për asnjë gjë dhe që mendohej vazhdimisht të më bënte qejfin. Unë e shikoja se i dhimbsesha edhe Ganiut, dhe më vinte rëndë. Biseduam disa minuta. Ai më premtoi se do të vinte vazhdimisht. Pas pak Mukadesi më thirri të veja brenda. Kur u ngjita lart, dy nga miqtë e zotit Kristaq po dilnin nga salloni.

— Qeramudini, — tha për njërin Mukadesi, duke mbajtur me zor të qeshurën. Qeramudini ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, me një trashësi dhe shkurtësi të jashtëzakonshme. Fytyra i buçiste nga një shëndet ngjyrë trëndafili, kurse gusha i varej palë-

-palë nga dhjami. Në kokë kishte vënë kapelë republikë me strehë tepër të gjerë si sombrero meksikane. Hunda e shtypur dhe e gjerë duhej të ishte shqetësimi i tij i përhershëm, sepse, vetëm me ato pak minuta që ndenji në korridor, e shtrëngoi atë disa herë me kurrizin e dorës. Zoti Kristaq i ndiqte lëvizjet e dorës me një vështrim prej njeriu të mjerë dhe fatkeq. Zoti Qeramudin fliste dhe qeshte pa pushim, duke lëvizur me energji dhe në mënyrë komike të gjitha gjymtyrët.

— Këta italianët janë shejtanë të mëdhenj, — tha zoti Qeramudin dhe qeshi me gjithë shpirt, sa u tund korridori.

— E po, lamtumirë, Qeramudin bej, — tha zoti Kristaq me një buzëqeshje të shtirë, që i ngjante më tepër se çdo gjëje tjetër një ngërdheshjeje. Dora e zotit Kristaq mbeti pezull. Qeramudin beu e çoi me vrull dcrën e vet të shkurtër të trashë në hundën poroze, që u shtyp dhe vajti përsëri në vend sikur të qe një copë llastiku. Zoti Kristaq e shpuri dorën në vend duke u dridhur nga inati. Qeramudin beu filloi të tregonte më nge një histori që i kishte ndodhur dikur me këta «shejtanë italianë». Mysafiri tjetër, një burrë i hollë si fije kashte, shikonte, me një pamje të thartuar, shëndetin e vrullshëm të Qeramudin beut dhe tundte herë pas here kokën në she një miratimi.

— E po, lamtumirë, Qeramudin bej, — tha për së dyti zoti Kristaq me pamjen e një njeriu të persekutuar mizorisht. Por edhe kjo lamtumirë pati fatin e së parës. Qeramudin

beu i hodhi zotit Kristaq një vështrim prej babaxhani dhe vazhdoi me qetësi të plotë tregimin e vet.

— Lamtumirë, Qeramudin bej, — tha për herë të tretë gati duke klithur zoti Kristaq. Këtë radhë ai e kishte bërë llogarinë mirë. E mbërtheu dorën e trashë e të shkurtër të Qeramudin beut në çastin kur ajo ishte drejtuar për tek hunda, e afroi pranë vetes me një ndjenjë neverie dhe zemërimi të papërmbajtur dhe u largua disa hapa për t'ia lënë radhën zonjës Meri. Qeramudin beun e hutoi disi gjesti i rrëmbyer i zotit Kristaq, por shpejt e mblodhi veten, qeshi me buçimë dhe ia zgjati dorën e vet zonjës Meri me një shprehje bujarie të madhe, sikur po i jepte bakhshish. Pastaj ai e goditi fort me bel burrin e hollë, që shtrembëroi fytyrën nga dhembja dhe të dy bashkë zbritën shkalët. Kur ata s'dukeshin më, zoti Kristaq u afrua në krye të shkallëve dhe, i mbledhur kruspull nga inati, filloi të shfrynte me zemërim, duke parë andej nga iku Qeramudin beu.

— Derr i ndyrë, kacak i qelbur...

Ishte bërë si i çmendur nga zemërimi. Zonja Meri rrinte disa hapa larg tij dhe s'guxonte ta qetësonte. Zoti Kristaq po rrëgohej e tkuurrej gjithmonë e më tepër, sikur ato fjalë që lëshonte kundër Qeramudinit të ishin copa mishi që shkuleshin nga trupi i tij i tharë e i vogël. Më në fund, pasi tha se këta qenër, si Qeramudin beu, nuk e linin vendin të ikte përpara, u fut brenda te miqtë me një buzëqeshje që iu ngjit në çast në fytyrë, sikur të

priste aty, në prag të derës. Zonja Meri u fut brenda pas tij me një buzëqeshje po aq të shtirë dhe të ngjashme si e të shoqit.

*

*

*

Zoti Kristaq u sëmur në kulmin e pushtetit të vet. Për dy ditë me radhë u përpëliti në agoni. Kishte temperaturë të lartë dhe një kollë të tmerrshme që ia shkallmonte gjoksin. Mjekun e morën ditën e dytë, kur zoti Kristaq filloi të fliste përçart. Ai e vizitoi për një kohë të gjatë, pastaj e mori zonjën Meri në këndin e dhomës dhe, me pamjen e një njeriu të dëshpëruar, filloi t'i fliste për gjendjen e tij. Zonja Meri gjithashtu u dëshpërua, nxori nga xhepi i robëdëshambrit një shami të bardhë dhe e dëgjonte duke fshirë lotët. Kur iku mjeku, zonja Meri dërgoi pas tij Mukadesin, që u kthye pas një ore me gjithfarësoj gjilpërash e tabletash. Kurat e bënë disi efektin dhe zoti Kristaq filloi çaste-çaste të përmendej. Megjithatë brenda dy ditëve që dobësuar mjaft. Porsa përmendej, kërkonte të shoqen. Zonja Meri shkonte buzagaz, rrinte në bisht të krevatit të tij dhe dëgjonte me ëndje të madhe për disa minuta fyerjet e vrazhda e të belbëta të zotit Kristaq. Fytyra e bardhë dhe e pastër si xham i ndriste nga kënaqësia. Zoti Kristaq lodhej shpejt, shqyente sytë nga marazi dhe në çast binte në kllapi. Atëherë zanja Meri ma bënte mua me shenjë të rrija pranë

të sëmurit, shpërndante në të gjithë pamjen e vet një dëshpërim të rëndë, të cilin e kontrollonte me një pasqyrë të rrumbullakët, hapte derën dhe shkonte në dhomën e madhe përballë, ku vazhdimisht rrinin ca gra, mikesha të saj apo të familjes, që mundoheshin ta qetësonin. Paraditeve unë isha urdhëruar të rrija pranë të sëmurit. Gjilpërat vinte ia bënte një murgeshë e tmerrshme, që ecte rëndë-rëndë si patë, pa folur asnjë fjalë. Ajo hynte brenda me një vështrim të akullt e të palëvizshëm që të shkaktonte rrëqethje e pasiguri. T'i flisje asaj, ishte njësoj sikur t'i flisje një statuje. Po kjo grua vinte dhe rrinte natën me të sëmurin. Më zëvendësonte mua. Ulej në një kolltuk pranë zotit Kristaq dhe ia ngulte sytë murit përballë krevatit. Kur vija në mëngjes për ta zëvendësuar, e gjeja përsëri në të njëjtin pozicion. Porsa kërciste dera, ajo ngrihej nga kolltuku pa m'i hedhur sytë dhe dilte qetë-qetë nga dhoma sikur porsa të kishte hyrë.

Për ta parë zotin Kristaq erdhi edhe nën-prefekti. I thanë të mos hynte tek i sëmuri, se, ku i dihej, zoti Kristaq (mos qoftë kurrë e vërtetë!) mund të kishte sëmundje ngjitëse dhe atëherë fatkeqësia do të dyfishohej, po nën-prefekti tregoi një kokëngjeshje prej martiri. Ai do të hynte ta shikonte mikun e tij, sikur kjo gjë t'i kushtonte edhe jetën. Dhe kur më në fund zonja e pangushëlluar Meri e la të hynte me një pozë prej gruaje fatkeqe e të mjerë, nën-prefekti shulak përveshi mëngët sikur do të hynte në një arenë luftimi

dhe hapi derën me një gjest madhështor. Zonja Meri hyri pas tij. Ato çaste zoti Kristaq po nxirrte nga goja ca fjalë të pakuptueshme, që e hutuan për disa çaste nënprefektin dhe i dhanë fytyrës së tij pamjen e njeriut që s'di nga t'ia mbajë. Në çast zonja Meri rënkoj dhe u mbështet e tëra pas shpatullave të tij. Ky gjest e bëri nënprefektin përsëri burrëror e solemn. Ai i tha zonjës Meri të qetësohej dhe, pasi i mati mirë forcat, bëri dy hapa në drejtim të zotit Kristaq. Pamja e të sëmurit ia shtangu përsëri energjitë e vrullshme. Ndenji disa sekonda ashtu, pastaj u drejtua nga zonja Meri, e vështroi me lakmi dhe, duke u kthyer nga shtrati ku dergjej zoti Kristaq, foli me zë të lartë, aq sa mund të dëgjohej edhe në korridor:

— Ti do të shërohesh patjetër, zoti Kristaq. Burrat si ti nuk kanë lindur të vdesin në shtrat. Për këtë jam i sigurt. Në shenjë miratimi, i sëmuri u mbërthye nga spazma e fuqishme, filloi të lebetitej dhe të nxirrte shkumë nga goja. Pas kësaj nënprefekti e quajti të mbaruar detyrën e vet ndaj mikut të madh, nxori shaminë nga jeleku, e kapi nga krahët të pangushëlluarën, zonjën Meri, dhe doli jashtë. Pas tij hyri me vrap mjeku plak...

Po atë ditë erdhi nga Tirana i ati i zonjës Meri me të shoqen dhe vëllai i zotit Kristaq me gruan e me një vajzë të rritur. Të gjithë dukeshin të ngutur e të vrenjtur. Pa pyetur për njëri-tjetrin, ata e mbytën me pyetje zonjën Meri, e cila nga ana e saj qe mjaft e dëshpëruar dhe e mjerë. Përgjigjej ngadalë, e

alarmuar dhe e trembur sikur dikush ta shtrëngonte me duar për gryke. Grupi i të ardhurve u fut në të njëjtën kohë në dhomën ku dergjej zoti Kristaq, dhe zoti Vasil, i pari, gati me vrap, shkoi e ra në gjunjë përballë fytyrës si të tejdukshme të të sëmurit.

— Vëlla Kristaq, si qenke katandisur kë-shtu?

Zonja Meri me të atin, Marko Lanin, shkëmbyen me njëri-tjetrin vështrime të shpejta luftarake. E shoqja e zotit Vasil s'donte të dinte për asgjë. Ajo ndihej shumë e lodhur dhe u shtri në kolltuk pa asnjë kujdesje, kurse e bija, Ana, e veshur në mënyrë elegante, me një fustan ngjyrë qumështi dhe me një pellush të madh të shtrenjtë, ruante me vigjilencë marrëdhëniet e fshehta të zonjës Meri me të atin. E shoqja e Marko Lanit vështronte me indiferentizëm përçark.

— Kur është sëmurur im vëlla? — pyeti vasisili me nervozizëm

— Ka ca ditë, — tha zonja Meri.

— Duhej të më kishe lajmëruar më herët, — tha ai dhe unë vura re në fytyrën e tij me rrudha të imta e të holla reflekset e zemërimit të zotit Kristaq.

— E po, e gjora Meri, është hutuar krejt, baba, — tha Ana, mbesa e zotit Kristaq.

Nuk merrej vesh nëse ajo e kishte seriozisht atë që thoshte apo jo, sidoqoftë zonja Meri i shtoi edhe më dozat e dhembjes.

— Ç'thonë doktorët? — pyeti Marko Lani në rolin e njeriut paqësor. Nuk iu përgjigj njeri. Vështrimet e të porsaardhurve ranë mbi

fytyrën e zonjës Meri. Ajo rrinte kokulur, sikur të mos kishte dëgjuar asgjë, dhe Marko Lani u detyrua ta përsëriste pyetjen:

— Ç'thonë doktorët, Meri?

— Çfarë? — tha zonja Meri dhe shkundi kokën si për ta hequr nga vetja hutimin që e kishte mbërthyer.

— Sa e tronditur që është! — tha Ana.

— Ç'thonë doktorët? — pyeti së treti Marko Lani.

— I ftohtë i vjetër, — tha zonja Meri duke lakuar trupin dhe duke parë me pikëllim të shoqin, — një i ftohtë i rëndë.

Pa i mbaruar mirë fjalët, ajo u shkreh në një të qarë ngashëryese, që e bëri zotin Vasil të kthente kokën me vrull në drejtim të saj dhe ta shikonte për një kohë të gjatë me mosbesim. Ana iu afrua zonjës Meri dhe filloi të qetësohej. Në fytyrën e saj të hequr endej një buzëqeshje e hollë ironie që ia bënte pamjen të pamëshirshme. Marko Lani, që ndiqte gjithçka me sytë djallëzorë, vari kokën në gjoks.

— Duhet marrë patjetër doktorë nga Tirana, — tha zonja Poli, kunata e zotit Kristaq. Ajo kishte një zë të hollë, si mjaullimë.

— E tmerrshme! — tha e shoqja e Marko Lanit pa iu drejtuar askujt.

Pas pak erdhi gruaja që bënte gjilpërat. Të ardhurit asaj nuk i bënë asnjë përshtypje. Hyri brenda, bëri gjilpërën dhe doli pa parë njeri.

— Ç'është kjo fantazmë? — pyeti zoti Vasil i skandalizuar.

— E ka prurë doktori, — tha zonja Meri.
— Nuk mund të gjendej një njeri tjetër për tim vëlla?

Zoti Vasil po e shprehte pakënaqësinë ndaj zonjës Meri në mënyrë të rreptë. Marko Lani po e vuante gjendjen me durim titanik. Ai fërkonte duart me forcë sikur do t'u zhvishte lëkurën, psherëtinte, rrudhte ballin me dëshpërim dhe shikonte nga e bija, zonja Meri, sikur priste prej saj sinjalin e alarmit të luftës.

Në atë çast zoti Kristaq hapi sytë dhe pshe-rëtiu.

— Kristaq, vëlla, si je? — pyeti zoti Vasil, duke i vënë dorën në kokë.

— Mirë, — belbëzoi i sëmuri.

— Mbaje veten. Ja, unë, Poli dhe Ana kemi ardhur. Na shikon?

I sëmuri shikonte i heshtur. Marko Lani turfulloi në kolltuk.

— Xhaxhi Taqi, si je? Jam Ana!

— Mirë.

— Bëhu i fortë. Meri është pikëlluar shumë.

— Ujë!...

Vrapova poshtë dhe mbusha një gotë me ujë. Zoti Kristaq piu vetëm një gllënjë.

— Do të të shpie në Tiranë, — tha zoti Vasil. — Të shërojmë shpejt e shpejt, rrimë dhe ca ditë bashkë se na ka marrë malli, pastaj kthehemi. Apo jo?

— Posi, posi, — mjauilliu njëra nga gratë.

I sëmuri tundi kokën.

— Doktori tha se s'duhet të lëvizë hëpër-hë, — tha zonja Meri.

— Cili doktor?

— Doktor i qytetit.

— Pse, ka doktor këtu? — pyeti Ana me qesëndi.

— Ka, moj shpirte, si s'ka, — u përgjigj zonja Meri.

— Çudi!

Fjalët dhe vështrimet e të dy palëve vetëtinin nga urrejtja. Zotin Kristaq e mbërtheu një kollë torturuese. Ai u ngrit përgjysmë mbi shtrat, vështroi i tmerruar përçark dhe në çast u mek. Sytë i kërcyen përpjetë sikur donin t'i dilnin nga zgavrat. Të gjithë u ngritën njëherësh dhe vrapuan pranë tij. Marko Lani, në vrull e sipër, u përplas me zonjën Poli dhe ajo ra përdhe.

— Ah, zonja Poli, u vrave, — tha zonja Meri dhe e ngriti duke e kapur nga supet. Zonja Poli turfulloi duke parë me inat Marko Lanin. Zoti Vasil kërkonte mjekun.

— Shpejt, shpejt!

Ana vinte vërdallë me duart në kokë. Unë dola jashtë dhe i fola mjekut, që rrinte në ballkon duke pirë cigare. Ai hyri në dhomë qetë-qetë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Mos u shqetësoni, — tha, — do t'i kalojë.

Të gjithë shkuan dhe u ulën nëpër vendet e veta. Ana mbuloi fytyrën me duar dhe filloi të qante, kurse zonja Poli shikonte me zemërim Marko Lanin dhe diçka pëshpëriste me vete. Zoti Vasil thithte me vrull cigaren dhe shikonte i habitur Merin, që kishte marrë pamjen e gruas më fatkeqe në botë. Pas pak i sëmuri u qetësua, hapi sytë me plo-

gështi dhe filloi t'i shikonte të gjithë me radhë. Marko Lani u ngrit nga kolltuku, shkoi pranë tij me hapa të qetë, u përkul dhe e puthi me dashamirësi.

— Hë, Taçi, si je tani?

— Mirë, — tha zoti Kristaq, pastaj ia nguli sytë e gjelbër e të lëngët Marko Lanit dhe befas ktheu kokën nga ana tjetër me një gjest neverie e zemërimi të vrullshëm, që u bëri përshtypje të gjithëve.

— Si katandiset njeriu i gjorë nga sëmundja! — tha Marko Lani i mallëngjyer, — kushedi për cilin më pandeh.

Zoti Vasil u ngrit në këmbë.

— Jo, — tha, — s'e besoj të të ngatërrojë.

Marko Lani brofi sikur t'i kishin hedhur në fytyrë një kovë me ujë të përvëlur.

— Zoti Vasil, me ç'kuptim i thatë këto fjalë?

— Me asnjë kuptim, — tha vëllai i zotit Kristaq, me pamjen e një njeriu krejt të pafajshëm. — Thashë se ai s'të ngatërroi me njeri. Ç'ka këtu për t'u keqkuptuar?

— Kurse unë them se më ngatërroi, — tha Marko Lani i fyer.

— Mundet, mundet.

— Ai të ka dashur gjithmonë, baba, — tha zonja Meri e ngashëryer. Shkoi pranë të shoqit, ra në gjunjë, i mblodhi me një dorë krahët e tij të tharë e të hollë dhe filloi t'i puthte me pasion.

— Lëre, Meri! Ai ka nevojë për qetësi, — tha Marko Lani dhe, pasi i futi krahun së bijës, shkoi me të në një kolltuk të madh ngjy-

rë mjalti në qoshe të dhomës. Në qoshen tjetër të dhomës, shpërndarë nëpër kolltukë po aq të mëdhenj, qëndronte pala tjetër e të dëmtuarve nga sëmundja e zotit Kristaq. Fytyrat e të gjithëve ishin të ngrysura e përbuzëse. Unë nuk arrija të merrja vesh asgjë nga ato që po ndodhnin. Megjithëse jashtë ishte ftohtë dhe frynte thëllimi i muajve të parë të dimrit, ndieja që trupi më qe qullur i tëri nga djersët. Këto njerëz që ishin mbushur me një urrejtje të vrazhdë për njëri-tjetrin, më tmerronin dhe më bënin të më ngriheshin leshrat përpjetë nga frika. Tek asnjëri prej tyre nuk ishte vërtet meraku për sëmundjen e zotit Kristaq. Bile, më tepër se kaq, të gjithë e shikonin me neveri të fshehtë atë masë mishi të verdhë si dhjamë pule që po trettej e po venitej në mënyrë të pandreqshme. Ata të gjithë thoshin se zoti Kristaq do të shërohej, por një gjë të tillë s'ia besonin as vetes, as të tjerëve. Doja të dilja jashtë. M'u zu fryma. Më dukej sikur ca duar të fuqishme më shtrëngonin fort në grykë dhe po më merrnin shpirtin. Ç'kishin që më kishin harruar kështu? Ajri përçark u trash e u zverdh si fytyra e zotit Kristaq. Mbi të, si mbi një gjol me ujë të ndenjor, lëviznin kokat e Marko Lanit, të zotit Vasil, të zonjës Meri, të zonjës Poli, të të gjithëve. Lëviznin, afroheshin, vërtiteshin rreth meje duke lehur në ngërdheshje si një lukuni qensh. U mbështeta fort pas një mbajtëseje duhani që të mos bija. Atë çast u hap dera dhe brenda hyri Mukadesi, që mbante në dorë një pjatë të madhe me filxhanë kafeje: Po e shikoja me lutje, me përgjërim. Unë nuk mund t'i rezistoja më kësaj

batërdie me ngërdheshje, nuk mund ta përballoja dot atë atmosferë të ngjeshur me urrejtje, nuk mund të duroja dot ato fytyra të tendosura njerëzish që ndiqnin lëvizjet e njëri-tjetrit me një vigjilencë prej kriminelësh. Po të mbyllja pak sytë, atëhere ata do të zinin të ulërinin, do t'i suleshin njëri-tjetrit dhe do të goditeshin me thika në fytyrë, në gjoks, në shpinë, ku të mundnin. Mukadesi priste kokulur të piheshin kafet. Unë gati po klithja. Ata rrufitnin filxhanët e bardhë prej porcelani dhe shikonin fytyrën e verdhë të zotit Kristaq, sikur aty të gjenin forca për urrejtje të re. Befas Mukadesi i hodhi sytë nga unë. Pamja ime e trembi.

— Kola, shko pak poshtë!

Kurrë në jetën time s'kisha dëgjuar fjalë më të shtrenjta se ato. U nisa me mundim në drejtim të derës. Trupi më rëndonte. Më dukej sikur dëshemeja në vend të qilimit ishte shtruar me gojë përbindëshash dhe unë mezi i shkulja këmbët prej dhëmbëve të tyre. Dola jashtë dhe u mbështeta në parmakët e shkallëve. Atë çast m'u kujtuan nëna, gjyshja, hallë Kristina, shtëpia jonë e varfër dhe e vjetër dhe u mbyta nga malli. Doja të isha pranë të gjithëve. Edhe pranë plakut Babo, që ma kishte trembur aq shumë fëmijërinë, edhe pranë Koto Plepit me çmendurinë e tij paqësore, pranë Cule Vakos së gjatë, që në fillim mahnitej pas ëndrrave të plakut Babo, pastaj i urreu ato, pranë të gjithëve.

Mukadesi erdhi e tronditur.

— Kola, shpirt, ç'ke kështu?

Fytyra e saj shprehte një dëshpërim të thellë e të sinqertë që më ktheu në jetë. E shikoja si i mahnitur. Ishte e vetmja fytyrë njerëzore në atë batërdisë me urrejtje. Çfarë mirësie kishte në pamjen e saj, çfarë dhimbjeje dhe kujdesi, ç'përgjërime prej motre dhe nëne njëkohësisht! Në atë fytyrë rrëzëllonte dashuria e gjithë atyre njerëzve që më mungonin.

— Ç'ke kështu? Ç'të bënë ata?

— Asgjë, — thashë. — Kam frikë!

— Nga kush ke frikë?

— Nga të gjithë, — thashë.

— Po ti trembesh kot, mor Kola. Ata grin-den për pasurinë e zotit Kristaq që po vdes, dhe as që u shkon mendja te ti.

Psherëtiva i lehtësuar disi.

Pas pak u hap dera e dhomës së zotit Kristaq dhe dolën të gjithë ata që ndodheshin brenda. Zonja Meri, e gjatë, e pikëlluar dhe e lodhur, i përcolli në dhomën e pritjes, ma bëri me shenjë mua të futesha tek i sëmuri dhe zbriti në kuzhinë. Unë hyra brenda me ndjenjën e përhershme të frikës e pasigurisë. Zoti Kristaq rënkonte mbytur. Zonja Meri u ngjiti përsëri lart.

— Meri, eja të çlodhesh pak, — dëgjova nga dera gjysmë e hapur zërin e Marko Lanit.

— Jo, baba. S'mund ta lë vetëm. Do të më ketë pranë vazhdimisht.

— Mirë, moj bijë.

Zonja Meri hyri brenda dhe në çast pikëllimi i saj u tret si një copë akulli në ujë të valuar. Pamja e saj u bë krenare dhe përbu-

zëse. Zoti Kristaq diçka pëshpëriti mbytur.

— Hum, hum! — lehu zonja Meri duke parë në drejtim të tij. I sëmuri s'reagoi. Zonja Meri shkoi në dritare, mënjanoi perdet e trasha dhe ndenji për një kohë të gjatë pa lëvizur. Pastaj u shpi, u erdhi rrotull kolltukëve të rëndë me një vështrim ëndërrimtar dhe ndali përballë të sëmurit.

— Plesht! — tha zonja Meri me cinizëm dhe shkoi e ra mbi një kolltuk duke psherëtitë. Mblodhi këmbët, kryqëzoi duart mbi to, mbështeti kokën me flokë të dendur dhe ia qepi sytë qilimit me vëmendje e kureshtje të ndezur, sikur mbi të të lexonte të fshehtat e ditëve që do të vinin.

Krisi dera dhe brenda u fut i ati i zonjës Meri, Marko Lani. Ecte në majë të këmbëve, me gishtin tregues mes buzëve. Në sy i digjej një vështrim djallëzor. Zonja Meri buzëqeshi e çliruar. Marko Lani erdhi në mes të dhomës dhe, gjithnjë me atë ngërdheshje prej banditi në fytyrë më kapi nga krahët, më ngriti përpyetë si ashkël dhe më lëshoi në buzë të shka llëve duke më kërcënuar nuk di përse. Pastaj pa përçark me vështrim përgjues e më kërcënoi edhe një herë me ca fjalë të mbytura.

Rrija në vend pa pasur forca as të mendoja dhe as të lëvizja. Më dukej sikur gjithë ai tërbim i mbytur dhe i rëndë, që kishte kapur njerëzit e kësaj shtëpie, do të mblidhej dhe do të binte i tëri mbi mua. Ishte një buzëmbremje e ftohtë, me një ajër të ngjeshur si akull. Mezi merrja frymë. Dera krah meje u hap dhe në prag të saj doli Marko Lani i trembur. Ai rro-

tulloi vështrimin përçark dhe më urdhëroi të futesha brenda. Pas tij, po kaq e trembur dhe e vëmendshme doli dhe zonja Meri. Ishin të tronditur. U ngrita në këmbë.

— Hajde, — tha Marko Lani me zë të ulët, — hyr brenda dhe mos ki frikë. — Unë bëra një hap përpara, pastaj befaz u ktheva dhe fillova të zbritja shkallët me vrull.

— Ku shkon? — klithi Marko Lani. Nga pas ndjeva hapat e tij të rëndë.

— Mos e lër, baba! — ishte zëri i alarmuar i zonjës Meri.

Dera e jashtme ishte e hapur. Shkova si vetëtimë nëpër oborr. Nga pas dëgjova zhurmën e rëndë të një trupi që ra dhe pastaj klithmën e egër të Marko Lanit që më urdhëronte të kthehesha. Dola në rrugë dhe ende vazhdoja të rendja si i çmendur. Këmbët më përpiqeshin në kalldrëmin e ngushtë dhe më përvëlonin nga dhembja. Në fund të rrugicës dëgjova për të fundit herë zërin e alarmuar të zonjës Meri që më bënte thirrje të kthehesha. Pastaj ajo kërkoi ndihmë. Unë vrapoja. Muzgu gjithnjë e më tepër rëndohej nga një errësirë ngjyrë plumbi. Unë ecja mes tij si predhë. Njerëzit e rrallë që hasja në rrugë, ndalonin të më shikonin dhe diç pëshpëritnin të pakënaqur. Unë vetëm vrapoja, pa ditur ku, me mendimin për të mos u kthyer kurrë pas. Në sheshin e madh të qytetit shtanga. Në fillim pashë të vinte drejt meje një lumë i trazuar njerëzish, pastaj dëgjova zërat e tyre që buçitnin, gjëmonin dhe e mbushnin hapësirën përreth me një tallaz tron-

ditës. U struka pas një shtylle telefoni dhe po pritja i trembur. Turma kaloi para meje pa më vënë re, heshti një çast, pastaj shpërtheu në një kor të stuhishëm: «Së mjaft në robëri /o e mjera Shqipëri»... Më në fund u qetësova. Shikoja si i magjepsur atë turmë të madhe njerëzish që çanin përpara me një zemërim të rëndë dhe bënë që toka të lëkundej në këmbët e tyre si tërmet. U afrova pranë. Dikush më hodhi dorën në sup dhe më futi në vërshimin e turmës. Ikja me hapa të shpejtë dhe këndoja me zë të lartë. Isha si i magjepsur. Qëndroja në mes të një zemërimi vigan, më i madhi që kisha parë ndonjëherë dhe i vetmi që s'ishte kundër meje. Ecja dhe ndieja se në gjoksin tim prej fëmije përvëlonte si zjarr dëshira për të kërkuar një jetë tjetër. Dhe unë e kuptova më në fund se kjo dëshirë s'kishte të ngjarë me asnjë nga ato çaste të zeza që kisha jetuar deri tani. Ajo ishte tjetër. Krejt tjetër....

PËRMBAJTJA

Përballë vetes	3
Si ndodh nganjëherë	11
Ca ditë nga pushimet	21
Mirëmëngjesi... i dashur!	35
Ç'të bëja?!	55
Jetë	65
Unaza	72
Diçka nga e pamundura	92
Në jetën e një vajze	103
Dhembje	111
Ku ishin njerëzit?!	122